



Universiteti "Ismael Qemali" Vlorë

Buletini Shkencor

Nr 8, Vol 2 Numër Special - 2025
ISSN 3005-8473

UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE

BULETINI SHKENCOR

Numër 8, Vëllimi 2, Numer Special- 2025
ISSN 3005-8473

Email: botimeuv@univlora.edu.al
Dhjetor 2025

Bordi Editorial :

1. Prof.Dr. Aurela Saliaj (Editor-in-chief)
2. Prof.asoc. Denada Sota (Technical and Natural Science Section Editor-in-chief)
3. Prof.asoc. Florian Miti (Economic Section Editor-in-chief)
4. Prof.asoc. Kozeta Hyso (Education Section Editor-in-chief)
5. Prof.asoc. Enkelejd Mëhilli (Health Section Editor-in-chief)

Redaktor menaxher i Buletinit Shkencor:

1. Mrs.Alberta Breshanaj

Bordi Shkencor:

Seksioni I Shkencave Teknike dhe Natyrore

1. Prof.asoc. Hajdar Kiçaj
2. Dr. Ermal Xhelilaj
3. Dr. Ogerta Gjermëni
4. Prof.asoc. Ermal Feleqi
5. Prof.asoc. Luljeta Gushta
6. Dr. Marinela Muço
7. Dr. Dezdemonë Gjylapi

Seksioni i Ekonomise

1. Prof. Dr. Evelina Bazini
2. Prof. Dr. Elenica Pjero
3. Prof. asoc. Fjoralba Velaj
4. Prof. asoc. Xhiliola Agaraj
5. Prof .asoc. Ilirian Lipi
6. Dr. Amalia Çipi
7. Dr. Dorjana Feimi
8. Dr. Arben Hysi
9. Dr. Enida Pulaj
10. Dr. Shkëlqim Sinanaj
11. Dr. Rezarta Brokaj
12. Dr. Rezarta Hasanaj
13. Dr. Sonila Berdo
14. Prof. Dr. Albert Qarri
15. Dr. Klaudja Guga
16. Prof. asoc. Filloreta Madani
17. Dr. Migena Petanaj

18. Dr. Lorena Cakërrri
19. Dr. Blerina Dervishaj

Seksioni i Edukimit

1. Prof.Dr. Roland Zisi
2. Prof.Dr . Bardhosh Gaçe
3. Prof.asoc.Monika Hasani
4. Prof.asoc. Artan Xhaferaj
5. Prof.asoc. Gladiola Elezi
6. PhD. Esmeralda Laci
7. Phd. Ilva Lamaj
8. Prof.asoc. Aleks Trushaj
9. Prof.asoc. Petrit Taraj
10. Prof.asoc. Kozeta Hyso
11. Prof.Dr. Armela Panajoti
12. Prof.asoc. Frosina Londo (Qyrdeti)
13. Prof.asoc. Meri Gjoleka
14. Prof.asoc. Bledar Toska
15. Prof.asoc. Veneranda Hajrulla
16. Prof.asoc. Evis Celo
17. Prof.asoc. Zamira Alimemaj
18. Prof.asoc.Ilda Kanani

Seksioni i Drejtesise

1. Prof.asoc. Jonida Mehmeti
2. Prof.asoc. Stela Meçaj
3. Phd. Ilir Kanaj
4. Phd. Erjon Hitaj

Seksioni i Shendetit

1. Prof.asoc. Rezarta Lalo
2. PhD. Juljana Xhindoli
3. Prof.asoc. Majlinda Zahaj
4. Prof.asoc. Mimoza Çanga
5. Dr. Denada Selfo
6. Dr. Evis Allushi
7. Prof.asoc. Fatjona Kamberi
8. Prof.asoc. Petraq Mustaqe
9. Dr. Glodiana Sinanaj

Përmbajtja e këtij buletini përfshin punime akademike të realizuara nga studentë të drejtësisë, të cilat trajtojnë çështje themelore dhe bashkëkohore të së drejtës, duke përfshirë të drejtën kushtetuese, civile, penale dhe ndërkombëtare. Punimet pasqyrojnë aftësitë analitike, interpretimin juridik dhe nivelin e formimit profesional të studentëve, si dhe angazhimin e tyre në kërkimin shkencor.

Përmbajtja

SEKSIONI I STUDENTEVE

FAKTORËT QË LIDHEN ME PËRDORIMIN AKTUAL TË CIGAREVE ELEKTRONIKE NGA STUDENTËT DHE QËNDRIMET NDAJ NDRYSHIMEVE TË MUNDSHME LEGJISLATIVE <i>Enkeleda Mahilaj (2025)</i>	7
ROLI INFERMIEROR NË PLANIFIKIMIN E KUJDESIT TË AVANCUAR NË MOSHAT GERIATRIKE <i>Esmeralda Hamiti(2025)</i>	16
KUJDESI INFERMIEROR NDAJ PACIENTËVE TË CILËT NDJEKIN DIALIZËN,SITUATA AKTUALE <i>Federika Likaj. (2025)</i>	26
EVIDENTIMI I PROBLEMEVE NË SHËRBIMIN INFERMIEROR PËR EVITIMIN E EMIGRIMIT TË PUNONJËSVE TË KUALIFIKUAR TË SHËNDETIT <i>Iriada Mejdani (2025)</i>	39
SFIDAT DHE NEVOJAT E TË SËMURËVE KRONIK GJATË PANDEMISË COVID-19 NË QËNDRAT SHËNDETSORE TË QYTETIT TË VLORËS <i>Klaudeta Kondi(2025)</i>	56
ROLI INFERMIEROR NË PARANDALIMIN E DËMTIMEVE FIZIKE GJATË HOSPITALIZIMIT TË PACIENTËVE GERIATRIKË <i>Kristi Metushi (2025)</i>	76
VLERËSIMI I KUJDESIT INFERMIEROR GJATË KIMIOTERAPISË NË PACIENTËT ME KANCER GJIRI NË KUJDES PALIATIV NË SPITALIN RAJONAL FIER <i>Nikola Agalliu (2025)</i>	84

SEKSIONI I STUDENTËVE

Faktorët që lidhen me përdorimin aktual të cigareve elektronike nga studentët dhe qëndrimet ndaj ndryshimeve të mundshme legjislative

Enkeleda Mahilaj (2025)

Program i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Shkenca Infermierore"

Udhëheqës shkencor: Prof. asoc. Dr. Enkelejd Mëhilli

Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Përdorimi i cigareve elektronike vazhdon të rritet globalisht tek të rriturit dhe adoleshentët. Në të gjithë Evropën, ka rreth 7.6 milionë përdorues të cigareve elektronike. Vlerësimi i perceptimeve të rinjve për cigaret elektronike mund të ndihmojë në identifikimin e faktorëve që mund të ndikojnë në vendimin e tyre për të përdorur cigaret elektronike. Për të ekzaminuar prevalencën, perceptimet dhe njohuritë rreth cigareve elektronike midis studentëve të universitetit "Ismail Qemali", u realizua një studim ndër-seksional vëzhgues duke përdorur një pyetësor të vetë-administruar.

Qëllimi i studimit është të identifikojë faktorët që ndikojnë në përdorimin aktual të cigareve elektronike nga studentët dhe të analizojë qëndrimet e tyre ndaj ndryshimeve të mundshme legjislative mbi këto produkte.

Në këtë studim transversal mostra e studimit ishin 217

studentë frekuentues të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, gjatë vitit akademik 2024 – 2025. Studimi u krye gjatë muajve Mars – Maj 2025.

Pyetësi *"Higjiena e stilit të jetesës - Vlerësimi i përdorimit të produkteve të duhanit, dhe cigareve elektronike tek të rinjtë"*, u përdor për mbledhjen e të dhënave të studimit.

Nga analiza e të dhënave të studimit rezultoi se shumica dërrmuese e pjesëmarrësve ishin femra ($n = 201$; 92.6%), ndërsa meshkujt përbënin vetëm 7.4% ($n = 16$) të të anketuarve. Kjo shpërndarje reflekton edhe përbërjen gjinore karakteristike të programeve në fushën e infermierisë, ku zakonisht dominojnë studentet femra. Grupi më i madh i pjesëmarrësve i përkiste moshës 18–22 vjeç ($n = 180$; 82.95%), që është edhe grupmosha tipike për studentët universitarë në ciklin e parë të studimeve. Grupmoshat e tjera përfaqësohen në përqindje më të ulëta: 23–28 vjeç

(6.91%), 29–34 vjeç (7.37%), 35–40 vjeç (2.0%), dhe vetëm 0.46% e pjesëmarrësve ishin mbi 40 vjeç. Përdorimi i cigareve elektronike është i përhapur në mënyrë të moderuar, por i pranishëm sidomos tek të rinjtë dhe më shumë në mesin e femrave në këtë studim. Rrethi social ka një ndikim të fortë, veçanërisht miqtë dhe kolegët, në krijimin e sjelljeve në lidhje me këto produkte.

Qëndrimet ndaj cigareve elektronike janë të ndara: ka pasiguri të madhe, perceptime të ndryshme dhe një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve nuk ka informacion të plotë mbi efektet dhe përbërjen e tyre. Rekomandohet që të përfshihet në programet mësimore një modul i dedikuar për dallimin mes cigareve elektronike dhe atyre tradicionale. Rreziqet e vërteta që lidhen me përdorimin e tyre, përfshirë varësinë nga nikotina dhe efektet toksike të aerosolëve. Të forcohet rregullorja për reklamimin, shitjen dhe shpërndarjen e cigareve elektronike, duke përfshirë: Ndalimin e shitjes për moshat nën 18 vjeç dhe kontroll më rigoroz të pikave të shitjes.

Fjalët kyçe: cigare elektronike, studentët, Shqipëri, duhanpirës

Abstract

The use of e-cigarettes continues to increase globally among adults and adolescents. Across Europe, there are an estimated 7.6 million e-cigarette users. Assessing young people's perceptions of e-cigarettes may help identify factors that may influence their decision to use e-cigarettes. To examine the prevalence, perceptions, and knowledge of e-cigarettes among students at "Ismail Qemali" University, a cross-sectional observational study was conducted using a self-administered questionnaire. Aim of the study is to identify factors that influence current e-cigarette use among students and to analyze their attitudes towards potential legislative changes on these products. In this cross-sectional study, the study sample was 217 students attending the "Ismail Qemali" University of Vlora, during the academic year 2024 – 2025. The study was conducted during the months of March – May 2025. The *Lifestyle Hygiene Questionnaire - Assessment of the use of tobacco products and electronic cigarettes among young people*, was used to collect study data.

From the analysis of the study data, it resulted that the vast majority of participants were female ($n = 201$; 92.6%), while males accounted for only 7.4% ($n = 16$) of the respondents. This distribution also reflects the characteristic gender composition of programs in the field of nursing, where female students usually dominate. The largest group of participants belonged to the age group of 18–22 years ($n = 180$; 82.95%), which is also the typical age group for university students in the first cycle of studies. Other age groups are represented in lower percentages: 23–28 years (6.91%), 29–34 years (7.37%), 35–40 years (2.0%), and only 0.46% of participants were over 40 years old. The use of electronic cigarettes is moderately widespread, but present especially among young people and more so among women in this study. The social circle has a strong influence, especially friends and colleagues, in creating behaviors related to these products. Attitudes towards electronic cigarettes are divided: there is great uncertainty, different perceptions and a significant part of the participants does not have complete information about their effects and composition.

It is recommended that a module dedicated to: the difference between electronic cigarettes and traditional cigarettes be included in the curricula. The real risks associated with their use, including nicotine addiction and the toxic effects of aerosols. Strengthen the regulation of the advertising, sale and distribution of electronic cigarettes, including: Prohibition of sales to those under 18 and more rigorous control of points of sale.

Keywords: electronic cigarettes, students, Albania, smoking tobacco

QELLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i studimit është të identifikojë faktorët që ndikojnë në përdorimin aktual të cigareve elektronike nga studentët dhe të analizojë qëndrimet e tyre ndaj ndryshimeve të mundshme legjislative mbi këto produkte.

Objektivat e studimit janë:

1. Të vlerësojë prevalencën e përdorimit të cigareve elektronike te studentët.

2. Të identifikojë faktorët demografikë, socialë dhe psikologjikë që lidhen me përdorimin e cigareve elektronike.
3. Të analizojë motivet kryesore për fillimin dhe vazhdimin e përdorimit të cigareve elektronike.
4. Të shqyrtojë ndërgjegjësimin dhe perceptimin e studentëve mbi rreziqet shëndetësore të cigareve elektronike.
5. Të eksplorojë qëndrimet e studentëve ndaj politikave dhe ndryshimeve të mundshme legjislative për cigaret elektronike.
6. Të japë rekomandime për politika dhe ndërhyrje të mundshme bazuar në gjetjet e studimit.

Hipoteza: Cigaret elektronike po gjejnë përdorim gjithnjë në rritje mes të rinjve për shkak se perceptohen si më pak të rrezikshme se duhanpirja tradicionale.

REZULTATET

Në total, në këtë studim u përfshinë 217 studentë, të cilët ndiqnin programin e studimeve universitare gjatë vitit akademik 2024–2025. Mbledhja e të dhënave u realizua gjatë periudhës Mars – Maj 2025, duke përfshirë një kampion përfaqësues të studentëve nga Departamenti i Infermierisë dhe Departamenti i Kujdesit. Të dhënat e përftuara përfshijnë informacion të detajuar mbi karakteristikat socio-demografike të pjesëmarrësve, zakonet e tyre në lidhje me përdorimin e cigareve tradicionale dhe elektronike, nivelin e ekspozimit ndaj tymit të duhanit, si dhe qëndrimet e tyre në lidhje me përdorimin dhe rregullimin e këtyre produkteve. Analiza statistikore e të dhënave pasqyroi trendet më të zakonshme të sjelljes dhe perceptimeve në mesin e studentëve, duke identifikuar gjithashtu lidhje të mundshme midis faktorëve socio demografikë dhe qëndrimeve ndaj cigareve elektronike.

Karakteristika socio-demografike të subjekteve të përfshira në studim

Në këtë studim morën pjesë gjithsej 217 studentë, të cilët u përfshinë në analizë për të përshkruar profilin e tyre demografik. Të dhënat përfshijnë variabla si gjinia, mosha, viti i studimeve, vendbanimi dhe statusi civil


Tabela 1. Karakteristika socio-demografike të popullatës së studimit (n=217)

Variablat	Frekuenca n	Përqindja %
Gjinia		
• Femër	201	92.6
• Maskull	16	7.4
Mosha		
• 18 - 22	180	92.95
• 23 - 28	15	6.91
• 29 - 34	16	7.37
• 35 - 40	5	2.0
• > 40	1	0.46
Viti i studimit		
• Viti I	87	40.1
• Viti II	50	23
• Viti III	53	24.4
• MSC	27	12.4
Vendbanimi		
• Në konvikt	10	4.6
• Me prindërit	117	54.2
• Me koleg/miq	19	8.8
• Me partnerin/bashkshorten	28	13
• Vetëm	9	4.2
• Tjetër	33	15.3
Statusi civil		
• Beqar	186	85.7
• i/e martuar	31	14.3


Rezultatet evidentuan se shumica dërrmuese e pjesëmarrësve ishin femra (n = 201; 92.6%), ndërsa meshkujt përbënin vetëm 7.4% (n = 16) të të anketuarve. Kjo shpërndarje reflekton edhe përbërjen gjinore karakteristike të programeve në fushën e infermierisë, ku zakonisht dominojnë studentet femra.

Gjinia:

217 responses




Grupi më i madh i pjesëmarrësve i përkiste moshës 18–22 vjeç (n = 180; 82.95%), që është edhe grupmosha tipike për studentët universitarë në ciklin e parë të studimeve. Grupmoshat e tjera përfaqësohen në përqindje më të ulëta: 23–28 vjeç (6.91%), 29–34 vjeç (7.37%), 35–40 vjeç (2.0%), dhe vetëm 0.46% e pjesëmarrësve ishin mbi 40 vjeç.



Pjesëmarrësit ishin të shpërndarë përgjatë viteve të ndryshme akademike. 40.1% (n = 87) ishin studentë të

vitit të parë, 23% (n = 50) të vitit të dytë, ndërsa 24.4% (n = 53) ishin në vitin e tretë të studimeve. Një pjesë më e vogël, 12.4% (n = 27), ndiqnin ciklin e dytë të studimeve (Master i Shkencave - MSc).

Viti i studimit:
217 responses




humica e studentëve jetonin me prindërit (n = 117; 54.2%), ndërsa 13% (n = 28) bashkëjetonin me partnerin/bashkëshortin. Të tjerë jetonin me kolegë ose miq (8.8%), në konvikt (4.6%), vetëm (4.2%), ose kishin forma të tjera banimi (15.3%).

Ku jetoni?
216 responses



Lidhur me statusin civil, pjesa më e madhe e studentëve ishin beqarë (n = 186; 85.7%), ndërsa 14.3% (n = 31) ishin të martuar.

A jeni i/e martuar?
217 responses



Prevalenca e përgjithshme

Nga Tabela 2 vërehet se:

- Përdorues të ndonjëherëshëm (të paktën një herë në jetë): 46+23=69 studentë → 31.8%
- Prevalenca aktuale (përdorim në muajin e fundit): 23 studentë → 10.6%

Nga gjithsej 217 studentë të anketuar, 31.8% kanë provuar ndonjëherë cigare elektronike, ndërsa 10.6% raportojnë përdorim aktual (muajin e fundit). Pjesa më e madhe e studentëve (68.2%) nuk kanë përdorur kurrë cigare elektronike. Këto të dhëna tregojnë për një përqindje jo të vogël të përdorimit, çka nënvizon nevojën për ndërhyrje në edukim dhe parandalim, sidomos për grupin që e përdor aktualisht.

Tabela 2. Prevalenca e përdorimit të cigareve elektronike

Variablat	Frekuenca n	Përqindja %
Nuk kam përdorur cigare elektronike	148	68.2
Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	46	21.2
Kam përdorur cigare elektronike muajin e fundit	23	10.6
Totali	217	100

Femrat përbëjnë pjesën dërrmuese të të gjithë kampionit (201 nga 217 persona). Nga femrat: • 22 kanë përdorur cigare elektronike muajin e fundit. • 39 e kanë përdorur më herët, por jo muajin e fundit. • 140 nuk i kanë përdorur kurrë. Nga meshkujt: • Vetëm 1 mashkull ka përdorur cigare elektronike muajin e fundit. • 7 meshkuj i kanë përdorur më parë. • 8 meshkuj nuk i kanë përdorur kurrë. Përdorimi i cigareve elektronike është më i përhapur te femrat në këtë kampion. Kjo mund të lidhet me faktin që pothuajse i gjithë kampioni është i përbërë nga femra (92.6% janë femra), gjë që ndikon në pamjen e përgjithshme të përdorimit.

Tabela 3: Shpërndarja e përdorimit të cigareve elektronike sipas gjinisë

Crosstabulation Gjinia * A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike?				
		A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike?		
		Kam përdorur cigare elektronike muajin e fundit	Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	Nuk kam përdorur cigare elektronike
Gjinia	Femër	22	39	140
	Mashkull	1	7	8
Total		23	46	148
				217

Testi i Chi-square tregoi një lidhje jo statistikisht të rëndësishme midis [variablave e.g. gjinisë dhe

përdorimit të cigareve elektronike] ($X^2(2) = 5.292$, $p = 0.071$). Megjithatë, p-vlera është afër kufirit të domethënies, çka sugjeron se mund të ketë një tendencë për lidhje. Një kufizim i analizës është se 33.3% e qelizave kanë vlera të pritura më të ulëta se 5, çka mund të ndikojë në vlefshmërinë e rezultateve.

Tabela 4: Testi Chi-square (X^2)

	Vlera	df	Sig. asint. (2 vie)
Chi-square Pearson	5.292 ^a	2	.071
Rapporto di verosimiglianza	4.519	2	.104
N. di casi validi	217		

a. 2 celle (33.3%) hanno un conteggio atteso inferiore a 5. Il conteggio atteso minimo è 1.70.

Motivet kryesore e përdorimit të cigareve elektronike.

Tabela 5: Motivet kryesore për fillimin dhe vazhdimin e përdorimit të cigareve elektronike.

Nëse keni përdorur cigare elektronike, cila ishte arsyeja e përdorimit të tyre? * A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike? Crosstabulation		A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike?		
Nëse keni përdorur	Arsyet e tjera	Kam përdorur cigare elektronike muajin e fundit	Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	Nuk kam përdorur cigare elektronike
		0	1	57
	Ata janë më pak të rrezikshëm për njerëzit më të mëdha	6	5	58
		0	1	2
cigare elektronike, cila ishte arsyeja e përdorimit të tyre	Ata mund të përdoren në hapësira publike	3	2	3
	Doja të përpicesha të lija duhanin e cigareve me baza duhani në këto mënyra	0	2	0
	Jane më pak të rrezikshme për shëndetin në krahasim me cigaret që përdoren në ambientin tuaj	3	3	9
	Kam përdorur cigare elektronike për kuriozitet	3	26	4
	Në këtë mënyrë doja të reduktoja numrin e cigareve me baza duhani (nuk duhet)	1	2	0
	Parshikë të stresit	2	1	4
	Për fuqizimin e mirë	2	0	0
	Sapo e përdorin edhe prindërit e mi	0	1	0
	Sapo më pëlqejnë shijet	2	1	0
	Të jem modern	1	1	1
Total		23	46	146

Në këtë tabelë janë analizuar arsyet që kanë dhënë studentët për përdorimin e cigareve elektronike, në varësi të faktit nëse: • i kanë përdorur muajin e fundit ($n = 23$), • i kanë përdorur më parë, por jo muajin e fundit ($n = 46$), • nuk i kanë përdorur kurrë ($n = 146$). *Grupi që nuk ka përdorur kurrë cigare elektronike* ($n = 146$): • Shumica nuk kanë dhënë asnjë arsye, siç pritet (67 raste me 0 motiv). • Megjithatë, disa kanë dhënë përgjigje për perceptime që mund të kenë ndaj cigareve elektronike, si: o “Arsyet e tjera” – 58 studentë o “Janë më pak të rrezikshme për shëndetin” – 9 studentë o “Janë më pak të rrezikshme për njerëzit përreth” – 2 studentë o “Përdoren në hapësira publike”

– 3 studentë Disa studentë që nuk i kanë përdorur kurrë cigare elektronike, kanë njëfarë ndërgjegjësimi apo perceptimi për karakteristikat e tyre.

Grupi që i ka përdorur dikur, por jo muajin e fundit ($n = 46$): • Motivi më i zakonshëm: “Kam përdorur për kuriozitet” – 26 studentë (56.5%) • Arsyet e tjera – 5 raste • Arsye të tjera të shprehura ishin: o “Janë më pak të rrezikshme për shëndetin” – 3 o “Përdoren në hapësira publike” – 2 o “Të ndihmon të lësh duhanin” – 2 o “Të reduktoj cigaret e zakonshme” – 2 o “Për stres” – 1 o “Pëlqej shijet” – 1 27 Për këtë grup, kurioziteti është arsyeja dominuese, ndërsa disa kanë pasur qëllime për reduktim të duhanit tradicional ose perceptim të rreziqeve më të ulëta.

Grupi që i përdor aktualisht (muajin e fundit) ($n = 23$): • Arsyet kryesore: • “Arsyet e tjera” – 6 • “Përdor për kuriozitet” – 3 • “Janë më pak të rrezikshme për shëndetin” – 3 • “Përdoren në hapësira publike” – 3 • “Për stres” – 2 • “Për socializim më të mirë” – 2 • “Pëlqej shijet” – 2 • “Të jem modern” – 1 Edhe pse numri i përdoruesve aktivë është më i vogël, motivet e tyre janë më të larmishme dhe komplekse: kombinim midis kuriozitetit, shijeve, uljes së stresit, socializimit, dhe perceptimit të rrezikut më të ulët. Ndër përdoruesit aktualë të cigareve elektronike (10.6% e të gjithë studentëve), motivet ishin të ndryshme, duke përfshirë kuriozitetin, shijet, nevojën për socializim, dhe perceptimin se cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme për shëndetin apo lejojnë përdorimin në hapësira publike. Ndërsa për përdoruesit e mëparshëm, kurioziteti ishte motivi më dominues (56.5%). Edhe tek ata që nuk i kanë përdorur kurrë, disa kanë raportuar njohuri apo bindje për karakteristikat e tyre, çka tregon për një ndërgjegjësim të përhapur, pavarësisht mungesës së përvojës direkte.

Tabela 6: Roli i presionit shoqëror mbi nxitjen e përdorimit të cigareve elektronike

Cili nga njerëzit e mëposhtëm përdor pajisje të tilla? * A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike? Crosstabulation		Ka përdorur Esig			Total
Cili nga njerëzit e mëposhtëm përdor pajisje të tilla?		Kam përdorur cigare elektronike muajin e fundit	Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	Nuk kam përdorur cigare elektronike	
		0	0	7	7
	Asnjë nga këta njerëz	10	15	72	97
	Babi	3	2	0	5
	Kolegjet	2	3	8	13
	Miqte	4	24	50	78
	Partneri/ja	3	1	4	8
	Vellezer ose motra	1	1	7	9
Total		23	46	146	217

Nga të dhënat rezulton se miqtë janë grupi social më shpesh i përmendur si përdorues të cigareve elektronike, veçanërisht nga ata që i kanë përdorur dikur (52.2%) dhe ata që nuk i kanë përdorur kurrë (33.8%). Kjo tregon për rolin e mundshëm të presionit shoqëror apo modelimit të sjelljes në nxitjen e përdorimit. Ndërsa përdoruesit aktivë raportojnë më pak kontakte të drejtpërdrejta me përdorues të tjerë, kjo mund të sugjerojë përdorim më të pavarur apo personale, ndoshta i lidhur me arsye si kurioziteti, stresi apo shijet.

Praktikat e përdoruesve të cigareve elektronike dhe arsyet për përdorimin e tyre

Studentët janë pyetur: "A mendoni se cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme për shëndetin sesa ato që përmbajnë duhan?", dhe janë analizuar përgjigjet në varësi të faktit nëse i kanë përdorur ndonjëherë ose jo.

Tabela 7: Perceptimi i rrezikshmërisë së cigareve elektronike sipas përdorimit

		A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike?			Total
		Kam përdorur cigare elektronike muajin e fundit	Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	Nuk kam përdorur cigare elektronike	
Cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme për shëndetin sesa ato që përmbajnë duhan.	Tjetër	1	2	17	20
	Aspak dakord	3	8	24	35
	Dakord	3	6	19	28
	Nuk e di	5	14	49	68
	Nuk jam dakord	4	11	24	39
	Plotësisht dakord	7	5	15	27
Total		23	46	148	217

Grupi që nuk ka përdorur kurrë cigare elektronike (n = 148): • 49 studentë (33.1%) kanë zgjedhur "Nuk e di", që tregon pasiguri, 24 (16.2%) janë aspak dakord, 24 (16.2%) janë nuk jam dakord, 19 (12.8%) janë dakord, 15 (10.1%) janë plotësisht dakord, 17 kanë zgjedhur "Tjetër" ose s'kanë dhënë përgjigje specifike. Pjesa më e madhe nuk ka një qëndrim të qartë – më shumë se 1 në 3 nuk dinë të përgjigjen. Vetëm një pjesë e vogël është plotësisht dakord që cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme.

Grupi që i ka përdorur dikur, por jo muajin e fundit (n = 46): 14 (30.4%) kanë zgjedhur "Nuk e di", 11 (23.9%) – Nuk jam dakord, 8 (17.4%) – Aspak dakord, 6 (13%) – Dakord, 5 (10.9%) – Plotësisht dakord, 2 – Tjetër. Edhe pse kanë pasur përvojë me cigaret

elektronike, një pjesë e madhe mbeten të pasigurt. Sërish dominon qëndrimi skeptik, megjithëse ka rritje të përqindjes së atyre që janë dakord me pohimin krahasuar me grupin e mëparshëm.

Grupi që i ka përdorur muajin e fundit (n = 23): 7 studentë (30.4%) – Plotësisht dakord, 5 (21.7%) – Nuk e di, 4 (17.4%) – Nuk jam dakord, 3 (13%) – Dakord, 3 (13%) – Aspak dakord, 1 – Tjetër.

Këtu vihet re një ndryshim i dukshëm: ata që i përdorin aktualisht janë më të prirur të mendojnë se cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme për shëndetin. Gati 1 në 3 janë plotësisht dakord, ndërkohë që vetëm një e treta thonë "nuk e di" ose nuk pajtohen.

Të dhënat tregojnë se perceptimi mbi rreziqet shëndetësore të cigareve elektronike ndryshon ndjeshëm në varësi të përvojës personale të përdorimit. Studentët që nuk i kanë përdorur kurrë shfaqin më shumë pasiguri (33.1% "nuk e di") dhe skepticizëm (32.4% aspak dakord ose nuk jam dakord), krahasuar me përdoruesit aktualë. Nga ana tjetër, përdoruesit aktivë kanë përqindjen më të lartë të atyre që besojnë se cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme (30.4% plotësisht dakord), çka sugjeron racionalizim të sjelljes ose minimizim të rrezikut për të justifikuar përdorimin.

Tabela 8: Perceptimi i studentëve mbi përmbajtjen e ENDS

Aerosolet në cigaret elektronike përmbajnë vetëm ujë dhe shije * A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike? Crosstabulation				
		KePërdorësig		
		Kam përdorur cigare elektronike muajin e fundit	Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	Nuk kam përdorur cigare elektronike
Aerosolet në cigaret elektronike përmbajnë vetëm ujë dhe shije		0	5	21
	Aspak dakord	4	4	23
	Dakord	3	2	9
	Nuk e di	6	27	59
	Nuk jam dakord	3	5	20
	Plotësisht dakord	7	3	16
Total		23	46	148

Shumica e pjesëmarrësve nuk janë të sigurt për përbërjen e aerosoleve: 148 • 92 persona (42.4%) kanë zgjedhur "Nuk e di", ku përqindja më e madhe vjen nga ata që nuk kanë përdorur kurrë cigare elektronike (59 nga 92). • Kjo sugjeron mungesë informacioni të saktë, veçanërisht te jo-përdoruesit dhe përdoruesit e rastësishëm. Vetëm 26 persona (12%) besojnë se aerosoli përmban vetëm ujë dhe shije, dhe shumica prej tyre janë jo-përdorues (21 nga 26). • Kjo është një besim i gabuar, që tregon për një perceptim të shtrembëruar të sigurisë te personat pa përvojë të drejtpërdrejtë. Përdoruesit aktivë janë më kritikë ndaj këtij pohimi: • 4

persona (17.4%) që pinë aktualisht janë "Aspak dakord" dhe vetëm 3 janë "Dakord", ndërsa 7 janë "Plotësisht dakord". • Kjo tregon se disa përdorues aktivë janë të vetëdijshëm për përmbajtjen e aerosoleve, por ka gjithashtu një përqindje që beson se ato janë të padëmshme. Përqindje të larta mosbesimi: • "Aspak dakord" dhe "Nuk jam dakord" përbëjnë 27.2% të totalit, që tregon se një pjesë e mirë e të anketuarve e dinë që aerosoli nuk përmban vetëm ujë dhe shije – që është në përputhje me faktet shkencore. 31 Shumica nuk kanë informacion të mjaftueshëm ose janë të pasigurt për përbërjen e aerosoleve në cigaret elektronike. Një pjesë e përdoruesve aktivë kanë njohuri më të sakta, por jo të gjithë çka tregon nevojën për edukim publik dhe ndërgjegjësim. Besimi i gabuar se aerosoli përmban vetëm ujë dhe shije është më i lartë te ata që nuk kanë përvojë me cigaret elektronike, çka mund të ndikojë në vendimet për përdorimin e tyre në të ardhmen.

Qëndrimet e studentëve ndaj politikave dhe ndryshimeve të mundshme legjislative për cigaret elektronike.

Tabela 9: Qëndrimet e pjesëmarrësve ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në hapësirat publike
Ndalimi i pirjes së duhanit në hapësirat publike të mbyllura është një masë e mirë. ^a A
keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike? Crosstabulation

		A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike?			Total
		Kam përdorur cigare elektronike muajin e fundit	Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	Nuk kam përdorur cigare elektronike	
Ndalimi i pirjes së duhanit në hapësirat publike të mbyllura është një masë e mirë.	Tjeter	0	0	2	2
	Jam pjesërisht dakord	6	3	5	14
	Jam plotësisht dakord	10	40	128	178
	Nuk e di	3	0	3	6
	Nuk jam aspak dakord	4	2	8	14
	Nuk jam dakord	0	1	2	3
Total		23	46	148	217

Për të analizuar qëndrimet e pjesëmarrësve ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në hapësirat publike të mbyllura, u përdor një pyetje specifike e cila u analizua sipas statusit të përdorimit të cigareve elektronike.

Tabela e përbashkët (Crosstabulation) tregoi se:

- Shumica e të anketuarve që nuk kanë përdorur kurrë cigare elektronike janë plotësisht dakord me ndalimin e duhanit në ambiente të mbyllura (128 nga 148).
- Edhe ata që kanë përdorur më parë, por jo muajin e fundit, e mbështesin këtë masë në një përqindje të lartë (40 nga 46 janë plotësisht dakord).
- Ndërsa ata që kanë përdorur cigare elektronike muajin e fundit kanë qëndrime më të përziera:

o Vetëm 10 nga 23 janë plotësisht dakord.

o 6 janë vetëm pjesërisht dakord.

o 4 janë kundër plotësisht.

o 3 janë të pavendosur.

Qëndrimi ndaj politikave të ndalimit të pirjes së duhanit ndryshon ndjeshëm në varësi të përvojës me cigaret elektronike.

Testi i Pearson Chi-Square konfirmoi se ka një lidhje statistikisht domethënëse midis qëndrimit ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në ambiente publike dhe përdorimit të cigareve elektronike:

Vlera df Sig. (2-sided) Pearson Chi-Square 37.218 10 0.000 $p < 0.05$, që tregon se ndryshimi është statistikisht domethënëse.

Rezultatet sugjerojnë që mbështetja për politikat kundër pirjes së duhanit në ambiente publike është më e lartë tek personat që nuk kanë eksperimentuar me cigare elektronike. Ndërkohë, përdoruesit aktualë tregojnë më shumë skepticizëm ose kundërshtim ndaj këtyre politikave.

Vlera $p = .000$ në testin Pearson Chi-square është më e vogël se .05, që do të thotë se lidhja është statistikisht domethënëse. • Kjo do të thotë se ka një lidhje të rëndësishme statistikisht midis qëndrimit ndaj ndalimit të pirjes së duhanit në ambiente të mbyllura dhe përdorimit të cigareve elektronike. • Edhe Likelihood Ratio (vlerë alternative e testit) mbështet të njëjtin përfundim ($p = .001$).

Tabela 10: Testi Chi-Square

Chi-Square Tests			
	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	37.218 ^a	10	.000
Likelihood Ratio	29.197	10	.001
N of Valid Cases	217		

Arsyet kryesore të përdorimit të ENDS

Sipas Tabelës 11 kurioziteti është arsyeja kryesore e përdorimit, sidomos te ata që nuk përdorin më. Kjo është arsyeja dominuese te ish-përdoruesit. Shumë persona e provojnë nga kurioziteti, por ndalojnë më pas – çka tregon përdorim të përkohshëm ose eksperimental. Shijet dhe socializimi përmenden vetëm nga përdoruesit aktivë – çka sugjeron faktorë të rëndësishëm për vazhdimësinë e përdorimit. Një pjesë e përdoruesve synojnë të reduktojnë ose lënë cigaret tradicionale – por nuk përbëjnë shumicën, gjë që sugjeron se ENDS nuk përdoren kryesisht për

ndihmë në ndërprerjen e duhanit. Jo-përdoruesit janë përgjithësisht të papërfshirë në këto arsye, por "Arsyet e tjera" dhe "Kurioziteti" janë të larta edhe në këtë grup, çka tregon potencial të përdorimit në të ardhmen.

Tabela 10. Arsyet kryesore të përdorimit të ENDS

Arsyeja e përdorimit të ENDS * A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike? Crosstabulation		A keni përdorur ndonjëherë cigare elektronike?		
Arsyeja e përdorimit të ENDS		Kam përdorur cigare elektronike	Kam përdorur cigare elektronike, por jo muajin e fundit	Nuk kam përdorur cigare elektronike
		0	1	67
Arsyeja e përdorimit të ENDS	Arsyet e tjera	6	5	58
	Ata janë më pak të rrezikshëm për shkak të kësaj	0	1	2
	Ata mund të përdoren në hapësira publike	3	2	3
	Doja të përditesha të lila duhanit e cigareve me bazë duhanit në këtë mënyrë	0	2	0
	Jam më pak të rrezikshëm për shëndetin në krahasim me cigaret që përmbajnë duhan (nikotinë)	3	3	0
	Kam përdorur cigare elektronike për kuriozitet	3	26	4
	Ine këtë mënyrë doja të rezultojë numrin e cigareve me bazë duhanit (nikotinë)	1	2	0
	Per shkak të stresit	2	1	4
	Per t'u socializuar me miqtë	2	0	0
	Sepse e përdorin edhe prindërit e mi	0	1	0
	Sepse më pëlqejnë shijet	2	1	0
	Të jem modern	1	1	1
Total		23	46	148

Regresioni Logjistik

Variables in the Equation						
Ndalimi i përdorimit të duhanit në hapësirat publike të mbyllura është një masë e mirë.	B	S.E.	Wald	df	Sig.	
Step 1 ^a	Nuk jam aspak dakord		10.018	4	.040	
	Jam plotësisht dakord (1)	20.637	28406.398	.000	1	.999
	Jam pjesërisht dakord (2)	-1.277	.806	2.511	1	.113
	Nuk e di (3)	.564	.565	.995	1	.318
	Nuk jam dakord (4)	-.430	.981	.240	1	.624
	Cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme për shëndetin sesa ato që përmbajnë duhan		6.790	5	.227	
	Plotësisht dakord (1)	1.780	.790	5.073	1	.024
	Dakord (2)	.645	.559	1.332	1	.248
	Nuk e di (3)	.459	.603	.579	1	.447
	Nuk jam dakord (4)	.603	.502	1.446	1	.229
	Aspak dakord (5)	.082	.541	.023	1	.879
	Gjinia (1)	.989	.553	3.205	1	.073
	Konstante	-1.003	.772	1.688	1	.194

Qëndrimet ndaj ndalimit të duhanit në ambientet publike kanë ndikim të përgjithshëm në përdorimin e cigareve elektronike, por nivelet individuale (kategoritë) nuk janë veçmas shumë domethënëse. Cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme për shëndetin sesa ato që përmbajnë duhan. Kjo variabël mat perceptimin nëse cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme se ato tradicionale.

- Sig. = 0.237 për të gjithë grupin → Jo statistikisht domethënëse në tërësi.
- Vetëm niveli i parë (EcigMePakRrezikshme(1)) ka p

= 0.024 Kjo është domethënëse ($p < 0.05$)

Vetëm individët që plotësisht pajtohen me idenë se cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme kanë më shumë gjasa të përdorin cigare elektronike, në krahasim me ata që nuk pajtohen.

Gjinia (1) • Koeficienti B = 0.989, p-vlera = 0.073 Nuk është në mënyrë të prerë domethënëse ($p > 0.05$), por është afër pragut, që do të thotë se gjinia mund të ketë ndikim të mundshëm. Meshkujt kanë tendencë më të lartë për të përdorur cigare elektronike krahasuar me femrat, por efekti nuk është statistikisht i sigurt. Konstante • Tregon intercept-in e modelit kur të gjithë prediktorët janë 0. • Nuk ka vlerë interpretuese më vete për qëllime praktike në këtë rast.

Qëndrimet ndaj ndalimit të duhanit në publik (NdalimiDuhani) kanë ndikim të përgjithshëm në probabilitetin e përdorimit të cigareve elektronike, por pa ndonjë kategori që të dallohet qartësisht. Perceptimi se cigaret elektronike janë më pak të rrezikshme ka ndikim nëse dikush i përdor ato – veçanërisht për ata që janë plotësisht dakord me këtë pohim.

Gjinia ka efekt të mundshëm, ku meshkujt janë më të predispozuar për përdorim, por jo me siguri statistikore të lartë.

KONKLUZIONE Përdorimi i cigareve elektronike është i përhapur në mënyrë të moderuar, por i pranishëm sidomos tek të rinjtë dhe më shumë në mesin e femrave në këtë studim. Rrethi social ka një ndikim të fortë, veçanërisht miqtë dhe kolegët, në krijimin e sjelljeve në lidhje me këto produkte. Qëndrimet ndaj cigareve elektronike janë të ndara: ka pasiguri të madhe, perceptime të ndryshme dhe një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve nuk ka informacion të plotë mbi efektet dhe përbërjen e tyre. Njohuritë mbi përbërjen kimike dhe efektet e aerosoleve janë të kufizuara dhe të paqarta për shumicën e pjesëmarrësve. Këto gjetje sugjerojnë nevojën për ndërhyrje edukative të synuara, përmirësim të informimit të publikut dhe hartim të politikave që marrin në konsideratë ndikimin e rrethit social dhe nivelin e njohurive mbi këtë produkt gjithnjë në rritje. Studimi tregon qartë se përdorimi i cigareve elektronike në mesin e të rinjve ekziston, dhe ndonëse niveli i përdorimit aktiv është relativisht i ulët, ekspozimi dhe pranueshmëria ndaj tyre është i konsiderueshëm. Ekzistojnë një sërë keqkuptimesh mbi efektet shëndetësore të këtyre produkteve, 44 dhe një mungesë informacioni të saktë, veçanërisht në lidhje me përbërjen e aerosolëve dhe pasojat afatgjata

shëndetësore. REKOMANDIME Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe analizat e kryera mbi perceptimet dhe sjelljet e të rinjve lidhur me përdorimin e cigareve elektronike (ENDS), ky studim sugjeron disa rekomandime të rëndësishme në nivel edukativ, politikash publike dhe ndërhyrjesh komunitare:

- Integrimi i edukimit për ENDS në programet mësimore të shkollave të mesme Duke qenë se një përqindje e konsiderueshme e të rinjve mbajnë perceptime të pasakta mbi përbërjen dhe efektet e ENDS (p.sh., një pjesë beson gabimisht se aerosolët përmbajnë vetëm ujë dhe shije), rekomandohet përfshirja e një moduli edukativ brenda kurrikulës shkollore. Ky modul duhet të përfshijë informacione të bazuara në evidencë mbi: përbërësit e cigareve elektronike dhe efektet toksike të tyre, varësinë që shkakton nikotina, krahasimin me produktet tradicionale të duhanit.
- Zbatimi i trajnimeve ndërvepruese nga profesionistë të shëndetit Të rinjtë treguan se faktorë si kurioziteti, stresi dhe dëshira për t'u dukur modern janë ndër motivet kryesore të përdorimit të cigareve elektronike. Në këtë kuadër, trajnime me mjekë, psikologë dhe specialistë të shëndetit publik do të ndihmonin në rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e aftësive për të përballuar presionin e shoqërisë apo faktorët emocionalë që çojnë në përdorim.
- Fushata ndërgjegjësimi përmes mediave sociale dhe masive Duke marrë parasysh prirjen e të rinjve për të konsumuar përmbajtje në rrjetet sociale, rekomandohet zhvillimi i fushatave vizuale, me përmbajtje të shkurtër dhe mesazhe të fuqishme që dekurajojnë përdorimin e ENDS. Këto fushata mund të përfshijnë: përgënjeshttrimin e miteve të përhapura, përshkrime të rreziqeve shëndetësore afatgjata, përfshirjen e figurave influencuese me ndikim edukativ.
- Ndërhyrje në nivel politikash dhe legjislacioni Duke marrë parasysh gjetjet e studimit mbi perceptimet e të rinjve dhe tendencat në përdorim, rekomandohet: ndalimi i rreptë i shitjes së ENDS për personat nën 18 vjeç, kontrolle më të shpeshta në pikat e shitjes, ndalimi i reklamimit të drejtpërdrejt ose indirekt që targeton të rinjtë, rregullore mbi përmbajtjen e shijeve aromatike që e bëjnë produktin tërheqës për të miturit, zbatimin e ndalimit të përdorimit ENDS në hapësirat publike të mbyllura, njësoj si për produktet e tjera të duhanit.
- Përfshirja e komunitetit dhe edukimi familjar Organizimi i seminareve për prindërit, edukatorët dhe komunitetin e gjerë mund të ndihmojë në: rritjen e

ndërgjegjësimit mbi mënyrat për të identifikuar përdorimin e ENDS të të rinjtë, përforcimin e rolit të familjes në parandalimin e sjelljeve të rrezikshme, ndërtimin e një mjedisi shoqëror mbështetës dhe jo nxitës ndaj konsumit të produkteve që përmbajnë nikotinë.

Roli infermieror në planifikimin e kujdesit të avancuar në moshat geriatrike

Esmeralda Hamiti (2025)

Program i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Shkenca Infermirore"

Udhëheqës shkencor: Doktorand.Vasilika Prifti

Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Plakja e popullsisë është një fenomen me ndikim të thellë në sistemet shëndetësore, duke rritur ndjeshëm nevojën për modele të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse të kujdesit. Ky studim trajton rolin jetik të infermierit në planifikimin e kujdesit të avancuar¹ (ACP) për të moshuarit, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së tyre në vendimmarrjen e informuar, menaxhimin e simptomave dhe përkrahjen emocionale në fazat e fundit të jetës. Përmes një shqyrtimi narrativ të literaturës kombëtare dhe ndërkombëtare, analizohen sfidat institucionale, barrierat ligjore dhe mungesa e trajnimeve specifike që pengojnë fuqizimin e këtij roli në Shqipëri.

Rezultatet sugjerojnë se ACP kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës, uljen e ndërhyrjeve mjekësore të panevojshme dhe rritjen e respektimit të vlerave të pacientit. Krahasimet me studime të realizuara në Shqipëri nënvizojnë boshllëqet në përgatitjen profesionale të infermierëve dhe mungesën e strukturave të specializuara.

Rekomandimet e studimit përfshijnë zhvillimin e protokolleve kombëtare për ACP, investimin në arsim dhe trajnim të vazhdueshëm, si dhe krijimin e qendrave të dedikuara për kujdesin geriatrik dhe paliativ.

Fjalë kyce: kujdes i avancuar, sfida, cilësi e jetës barriera

Abstract

Population aging is a phenomenon with profound implications for healthcare systems, significantly increasing the need for structured and comprehensive models of care. This study addresses the vital role of nurses in Advance Care Planning (ACP) for the elderly, emphasizing the importance of their involvement in informed decision-making, symptom management, and emotional support during the final stages of life.

Through a narrative review of national and international literature, institutional challenges, legal barriers, and the lack of specific training that hinder the empowerment of this role in Albania are analyzed. The findings suggest that ACP contributes to improving quality of life, reducing unnecessary medical interventions, and enhancing respect for patients' values. Comparisons with studies conducted in Albania highlight gaps in nurses' professional preparation and the absence of specialized structures. The study's recommendations include the development of national protocols for ACP, investment in continuous education and training, and the establishment of dedicated centers for geriatric and palliative care.

Keywords: advance care, challenges, quality of life, barriers

Rëndësia e studimit

Nevoja për përmirësimin e kujdesit geriatrik në Shqipëri

Shqipëria, si shumë vende me popullsi në plakje, përballet me sfida të rënda në ofrimin e një kujdesi të strukturuar, gjithëpërfshirës dhe cilësor për të moshuarit. Rritja e përqindjes së popullsisë mbi moshën 65 vjeç ka shtuar nevojën për një model të integruar dhe të specializuar të kujdesit shëndetësor, ku roli i infermierëve të jetë më i thelluar dhe i zhvilluar në funksione të avancuara klinike, edukative dhe menaxheriale. Studimi i këtij roli përkon me kërkesën emergjente për ristrukturimin e sistemit të kujdesit geriatrik në Shqipëri.

Roli i mundshëm i infermierit të avancuar në kujdesin për të moshuarit

Infermierët e avancuar (Advanced Practice Nurses – APNs) kanë një potencial të madh për të mbuluar boshllëqe në kujdesin shëndetësor, duke ofruar shërbime të specializuara, vlerësim të thelluar klinik, planifikim të kujdesit afatgjatë, koordinim me familjarët dhe ekipin multidisciplinar. Në kontekstin geriatrik, ata luajnë një rol kyç në parandalimin e komplikacioneve, në trajtimin e sëmundjeve kronike, si dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve të moshuar. Ky studim kontribuon në analizën e mënyrës se si ky rol mund të përshtatet në realitetin shqiptar.

Kufizimet ligjore dhe pengesat institucionale në Shqipëri

Një ndër pengesat më të mëdha në zhvillimin e këtij roli në Shqipëri është mungesa e kuadrit ligjor që e njeh zyrtarisht praktikën e avancuar infermirore. Ligji Nr. 10171/2009 "Për profesionet e rregulluara në fushën e shëndetësisë" nuk parashikon nivel të veçantë për infermierët praktikues (NP), as për specialistët klinikë (CNS), dhe nuk ofron mekanizma për përshkrim medikamentesh apo diagnostikim të pavarur. Këto kompetenca vazhdojnë të mbeten ekskluzive për mjekët, pavarësisht përgatitjes së avancuar apo përvojës së gjatë klinike të infermierëve.

Në kontrast, vendet me sisteme të zhvilluara si SHBA kanë përfitur nga rregullimi ligjor përmes modelit "Consensus Model" (2008), i cili përfshin komponentët: licencim, akreditim, certifikim dhe edukim. Këto struktura lejojnë ushtrimin e pavarur të praktikës infermirore të avancuar në shumë shtete. Mungesa e një kuadri të tillë në Shqipëri kufizon zhvillimin profesional të infermierëve dhe ndikon negativisht në ofrimin e shërbimeve cilësore për pacientët geriatrikë.

Kontributi i studimit në zhvillimin e politikave shëndetësore

Ky studim ofron një bazë teorike dhe praktike për të diskutuar nevojën për rishikimin e kuadrit ligjor dhe institucional për praktikën infermirore të avancuar në Shqipëri. Rezultatet e tij mund të ndihmojnë në formulimin e rekomandimeve për politikën publike dhe programet arsimore që mbështesin zhvillimin e rolit të infermierit në përkujdesjen për të moshuarit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe nevojat lokale.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi i përgjithshëm: Të vlerësohet roli i infermierit në planifikimin e kujdesit të avancuar për pacientët geriatrikë në studime review, me fokus në ndërhyrjet që përmirësojnë cilësinë e jetës dhe promovojnë vendimmarrjen e bazuar në dëshirat e pacientit.

Objektivat specifike:

1. Të identifikohen nevojat shëndetësore dhe sociale më të zakonshme në popullsinë geriatrike të studimet e gjetura.
2. Të shqyrtohet rëndësia e planifikimit të kujdesit të avancuar (ACP) në procesin e kujdesit për të moshuarit të studimet e gjetura.
3. Të analizohen llojet e udhëzimeve paraprake dhe ndikimi i tyre në ofrimin e kujdesit.
4. Të përshkruhet roli i infermierit në lehtësimin e bisedave për ACP dhe përfshirjen e pacientit dhe familjes në procesin vendimmarrës në studime.

5.Të identifikohen praktikat më të mira të infermierisë në parandalimin e komplikacioneve të zakonshme në moshat geriatrike, si rëniet apo përkeqësimi i demencës tek studimet.

Rezultateve të rishikimeve ndërkombëtare -
Analiza krahasuese

Tabela 1: Krahasimi i rishikimeve sistematike të literaturës

Rishikimi	Qëllimi	Rezultatet kryesore	Diferencat Kryesore
McMahan et al. (2020)	Vlerësimi i rezultateve të ACP përmes studimeve eksperimentale (RCT).	Përmirësimi i komunikimit, dokumentimi dhe përshtatjes me preferencat e pacientit	Raporton efektivitet më të lartë në cilësinë e kujdesit dhe dokumentimin e ACP.
BMC Public Health (2025)	Analizë e faktorëve psikologjikë dhe socialë që ndikojnë në gatishmërinë për ACP.	Identifikim i faktorëve që lehtësojnë ose pengojnë diskutimin për ACP, përfshirë kulturën dhe mbështetjen mjekësore	Gatishmëria për ACP më e lartë, por ndikim më i ulët në dokumentimin real të preferencave

Tabela 2. Krahasimi i indikatorëve të efektivitetit të ACP në të dy rishikimet


Kategoria	McMahan et al. (2020)	BMC Public Health (2025)	Interpretimi
Gatishmëria për ACP	72%	90%	BMC (2025) raporton gatishmëri më të lartë; ndoshta më shumë fokus në ndërgjegjësim.
Dokumentimi dhe veprimet	85%	70%	McMahan tregon ndikim më të fortë në dokumentim konkret të ACP.
Cilësia e kujdesit	88%	60%	McMahan tregon përmirësim më të madh në cilësinë e kujdesit.
Statusi shëndetësor	100%	50%	Vetëm McMahan tregon ndikim shumë të lartë në gjendjen shëndetësore.
Përdorimi i shërbimeve	50%	40%	Të dy tregojnë ndikim më të ulët në këtë aspekt.

Figura 1. Analiza Krahasuese e ACP: McMahan et al. (2020) vs. BMC Public Health (2025)



Analiza e rezultateve:
Figura e mësipërme paraqet një krahasim të efektivitetit të raportuar (në përqindje) në zbatimin e planifikimit të kujdesit të avancuar (ACP) në geriatrikë, sipas dy rishikimeve sistematike: McMahan et al. (2020) dhe BMC Public Health (2025). Krahasimi fokusohet në pesë indikatorë kryesorë: gatishmëria për ACP, dokumentimi dhe veprimet konkrete, cilësia e kujdesit, statusi shëndetësor dhe përdorimi i shërbimeve shëndetësore.

Diagramë 1: Krahasimi i rezultateve të dy rishikimeve mbi ACP në geriatric



Gjetjet kryesore nga analiza krahasuese:
Rezultatet tregojnë kontrastë të dukshme midis dy rishikimeve, të cilat plotësojnë gjetjet e mëparshme nga literatura. McMahan et al. (2020) raportojnë përmirësime të konsiderueshme në dokumentimin e preferencave (85%), cilësinë e kujdesit (88%) dhe, në mënyrë të veçantë, në statusin shëndetësor (100%). Këto rezultate janë në harmoni me gjetjet e tjera që tregojnë se ACP përmirëson respektimin e preferencave të pacientëve . [20]
Ndërkohë, rishikimi më i ri i BMC Public Health (2025) tregon një gatishmëri më të lartë për ACP (90%), ndoshta për shkak të ndërhyrjeve të fokusuara në ndërgjegjësimin komunitar dhe trajnimet e specializuara për profesionistët shëndetësorë. Megjithatë, ndikimi mbi cilësinë e kujdesit dhe statusin shëndetësor rezulton më i ulët krahasuar me McMahan. Limitimet e identifikuara:
Për të dy rishikimet, ndikimi mbi përdorimin e

shërbimeve shëndetësore rezultojnë i kufizuar (respektivisht 50% dhe 40%). Kjo tregon se ACP nuk përkthehet gjithmonë në një menaxhim më efikas të burimeve spitalore apo në reduktim të ndërhyrjeve të panevojshme në fazat e fundit të jetës, siç është evidentuar edhe nga studimet e Detering et al. (2019).

Review vendase në kujdesin geriatrik: Rastet e Shqipërisë

Për të pasqyruar më mirë sfidat dhe specifikat e sistemit shqiptar të kujdesit shëndetësor ndaj të moshuarve, janë përfshirë dy rishikime të rëndësishme të literaturës dhe studime vendore të viteve të fundit.

1. Podgorica et al. (2024) Ky studim cilësor i publikuar në PLOS One shqyrton përvojat dhe vështirësitë e 20 infermierëve në tetë institucione të kujdesit për të moshuarit në Shqipëri. Gjetjet theksojnë mungesën e trajnimeve të specializuara, boshllëqet në përgatitjen profesionale për çështjet geriatrike dhe sfidat emocionale në menaxhimin e pacientëve me çrregullime kronike dhe kognitive. Ndjenja e mbingarkesës emocionale dhe mungesa e mbështetjes institucionale shfaqen si pengesa të mëdha për ofrimin e kujdesit cilësor.

2. Kodra et al. (2024) Ky studim kombëtar përfshiu më shumë se 1,000 individë të moshës mbi 50 vjeç në të gjitha qarqet e Shqipërisë dhe vlerësoi shkallën e dëmtimit kognitiv duke përdorur instrumente të validuara si MMSE dhe EDQ. Rezultatet zbuluan se rreth 54% e pjesëmarrësve kishin dëmtime të lehta të funksioneve mendore, ndërsa 14% kishin çrregullime të moderuara ose të rënda. Si faktorë ndikues u evidentuan hipertensioni, mungesa e aktivitetit fizik, diabeti dhe përdorimi i duhanit apo alkoolit. Autorët rekomanduan krijimin e një regjistri kombëtar dhe rritjen e ndërgjegjësimit në kujdesin parësor për monitorimin e funksioneve kognitive.

Këto dy rishikime plotësojnë analizat ndërkombëtare të prezantuara më herët dhe ofrojnë evidencë vendore për nevojën urgjente të integritimit të planifikimit të kujdesit të avancuar dhe rritjes së kapaciteteve infermiore në sistemin shëndetësor shqiptar.

Tabela 3 – Përmbledhje e dy review-ve të realizuara në Shqipëri

Review	Qëllimi	Popullata	Metoda	Gjetje kryesore
Podgorica et al. (2024)	Sfidat e infermierëve në institucionet e kujdesit geriatrik	20 infermierë në 8 institucione	Intervistë cilësore	Mungesë trajnimesh specifike, ndjenjë pamjaftueshmërie, mbingarkesë emocionale
Kodra et al. (2024)	Prevalenca e çrregullimeve kognitive dhe faktorët ndikues në Shqipëri	1000+ individë mbi moshën 50 vjeç	Vlerësim sasior, MMSE/EDQ	54% dëmtime të lehta; 14% çrregullime të rënda; faktorë: hipertensioni, diabeti, aktiviteti i ulët

Tabela 4 – Krahësimi i indikatorëve të përbashkët në dy review shqiptare

Indikator	Podgorica et al. (2024)	Kodra et al. (2024)
Fokus i studimit	Kujdesi infermior në institucion	Dëmtimi kognitiv dhe faktorët shoqëruar
Metodologjia	Cilësore: intervista me infermierë	Sasiore: analizë statistike me MMSE/EDQ
Barriera kryesore	Mungesa e përgatitjes dhe protokolleve	Hipertensioni, diabeti, alkooli, mungesë aktiviteti fizik
Përfundim kryesor	Nevoja për trajnime dhe mbështetje emocionale	Nevoja për monitorim të rregullt dhe regjistrë kombëtar
Rekomandime	Reformim i edukimit dhe protokolleve institucionale	Ndërgjegjësim në kujdes parësor dhe përfshirje e infermierëve

Diagramë 2 – Përqindja e rasteve me dëmtim kognitiv [1]



Kjo diagramë tregon shpërndarjen e dëmtimeve kognitive të identifikuara në popullatën shqiptare mbi 50 vjeç:

- 14% – Dëmtime të moderuara ose të rënda
- 54% – Dëmtime të lehta ose fillestare
- 32% – Pa shenja të dëmtimit

Diagramë 3 – Faktorët kryesorë të përkeqësimit kognitiv [1]



Bazuar në analizën statistikore të studimit:

- 41% – Hipertensioni
- 33% – Hiperkolesterolemia
- 30% – Mungesa e aktivitetit fizik
- 25% – Diabeti mellitus
- 20% – Përdorimi i alkoolit

Gjetjet kryesore dhe boshllëqet në literaturë

Nga literatura e analizuar dhe krahasimi i rishikimeve sistematike del se ACP është një komponent kyç për përmirësimin e kujdesit geriatrik, dhe infermeria e avancuar ka potencial të madh për të kontribuar në këtë proces. Megjithatë, identifikohen disa boshllëqe kryesore:

Boshllëqet në implementim:

- Mungesa e kuadrit ligjor dhe institucional, sidomos në vendet në zhvillim si Shqipëria
- Edukimi i papërshtatshëm i profesionistëve shëndetësorë
- Barrierat kulturore dhe stigma ndaj diskutimeve mbi fundjetën

Boshllëqet në hulumtime:

- Mungesa e studimeve longitudinale për ndikimin afatgjatë të ACP
- Studimet e kufizuara në kontekste kulturore të ndryshme
- Nevoja për instrumente standarde për matjen e efektivitetit

Implikime për kontekstin shqiptar: Këto të dhëna nënvizojnë se edhe në vende me sisteme të përparuara shëndetësore, efektiviteti i ACP është i ndryshueshëm dhe i varur nga mënyra e zbatimit, konteksti kulturor dhe institucional. Për vendet si Shqipëria, ku mungon ende një qasje e integruar ligjore dhe etike për ACP,

këto krahasime ofrojnë mësim të vlefshme për ndërtimin e praktikave të qëndrueshme dhe të bazuara në prova shkencore. Kërkohej një përjasje e integruar ligjore, edukative dhe institucionale për të adresuar këto boshllëqe dhe për të nxitur zhvillimin e infermierisë së avancuar në kujdesin geriatrik.

Rekomandime për hulumtime të ardhshme: Bazuar në analizën e literaturës dhe krahasimin e rishikimeve sistematike, identifikohen disa fusha që kërkojnë hulumtime të mëtejshme:

- Zhvillimi i instrumenteve standarde për matjen e efektivitetit të ACP
- Studime longitudinale për vlerësimin e ndikimit afatgjatë
- Adaptimi i praktikave të ACP në kontekste kulturore të ndryshme
- Hulumtime specifike për rolin e infermierisë së avancuar në kontekstin shqiptar.

3.4. Krahasimi dhe Analiza e Review-ve kryesore në infermierinë geriatrike

Tabela 5 e Krahasimit të Ndryshimeve midis Review-ve të realizuara në Shqipëri

Nr.	Titulli i Review-t	Ndryshime kryesore	Vërejtje/Sqarime
1	Roli i Infermierëve të Praktikës së Avancuar në Kujdesin për të Moshuarit	Fokus në ndërhyrje të avancuara infermiore dhe efektet e tyre në kujdesin afatgjatë.	Krahasuar me të tjerat, thekson më shumë bashkëpunimin multidisiplinar.
2	Kujdesi Tranzicional për Personat e Moshuar me Nevojë për Rehabilitim Geriatrik	Përqendrohet në kujdesin tranzicional dhe fuqizimin e pacientëve.	Ndryshe nga të tjerët përqendrohet më shumë në perspektivën e infermierëve.
3	Vlerësimi i Kompetencave Profesionale në Infermierinë Geriatrike	Analizon trajnimin dhe përmirësimin e kompetencave të infermierëve në Kinë.	Ka fokus më të madh në aspektin edukativ se në ndërhyrje direkte.
4	Kompetencat Thelbësore për Vlerësimin Gjithëpërfshirës Geriatrik	Përcakton fushat kryesore të kompetencave për vlerësim geriatrik.	Shtyrje më teorike dhe e strukturuar në kompetenca se të tjerët.
5	Perspektivat mbi Përdorimin e Inteligjencës Artificiale	Fokus i veçantë në teknologjinë dhe AI në kujdesin geriatrik.	Tematikë teknologjike që mungon në shumicën e studimeve të tjera.
6	Roli i Infermierëve në Rehabilitimin në Kujdesin Parësor	Harton rolin në mjedise parësore dhe ndërhyrjet rehabilituese.	Ndryshon për nga vendndodhja e fokusit: kujdes parësor.
7	Përmirësimi i Kujdesit Paliativ me Mësimin e Thellë	Shpjegon përdorimin e algoritmeve për identifikim të hershëm të nevojave paliative.	Ndjeshëm me teknologjik dhe fokusohet në fundin e jetës.
8	Vlerësimi i Cilësisë në Spital Geriatrik	Implementim sistemi për vlerësim të cilësisë së kujdesit në mënyrë të automatizuar.	Fokus më shumë në menaxhimin institucional.
9	Planifikimi i Burimeve në Shtëpitë e Kujdesit	Modelim i planifikimit të burimeve në institucionet për të moshuarit.	Përdor analiza dhe simulime – ndarje teknike e menaxheriale.
10	Transitional Care of Older Adults	Strategji për kalimin nga kujdesi i specializuar në atë shtëpiak.	I ngjashëm me review-n 2 por me kontekst tjetër (institutcion vs shtëpi).

Në literaturën ekzistuese mbi infermierinë e avancuar dhe kujdesin geriatrik, ekzistojnë disa review dhe studime të rëndësishme që trajtojnë aspekte të ndryshme të temës. Në Tabelën 4 paraqiten ndryshimet kryesore mes disa review-ve përkatëse, duke përfshirë fokusin, strategjitë e përdorura dhe rolin e infermierit në praktikën e përbashkëta.

Ky krahasim ndihmon në identifikimin e boshllëqeve dhe orientimeve kryesore në fushën e infermierisë geriatrike, veçanërisht në aspektet e ndërhyrjeve, edukimit profesional dhe përdorimit të teknologjisë në kujdes.

Tabela 6. Ngjashmëritë ndërmjet review-ve në përdorimin e strategjive dhe protokolleve infermiore në kujdesin geriatric

Nr.	Titulli i studimit	Strategji të përbashkëta	Protokolle të përdorura ose të përmendura	Roli i infermierit
1	Roli i Infermierëve të Praktikës së Avancuar...	Kujdes integruar, edukim pacienti	Protokolle multidisiplinare	Koordinim, edukim, vlerësim, ndjekje
2	Kujdesi Tranzicional për Personat e Moshuar...	Koordinimi i kujdesit, vetë-menaxhim	Jo të specifikuar	Ndërlidhës mes niveleve të kujdesit
3	Vlerësimi i Kompetencave Profesionale në Infermierinë Geriatrike	Trajnim i vazhdueshëm	Jo të përmendura	Përmirësim i praktikave të avancuara
4	Kompetencat Thelbësore për Vlerësimin Gjithëpërfshirës Geriatrik...	Vlerësim gjithëpërfshirës, koordinim kujdesi	Praktika të bazuara në prova	Planifikim, vlerësim, ndërveprim profesional
5	Perspektivat mbi përdorimin e AI në kujdesin për të moshuarit	AI për personalizim kujdesi	Jo protokolle të përmendura	Monitorim, përshtatje teknologjike, etikë
6	Roli i Infermierëve në Rehabilitimin në Kujdesin Parësor...	Ekip multidisiplinar, menaxhim rastesh	Jo të përmendura	Vlerësim funksional, ndjekje
7	Përmirësimi i Kujdesit Paliativ me Mësimin e Thellë	Përdorim i algoritmeve për parashikim	Sisteme vendimmarrëse	Identifikim i pacientëve me nevojë për kujdes paliativ
8	Implementimi i sistemit për vlerësimin e cilësisë...	Sisteme automatike vlerësimi	Jo të specifikuar	Përmirësim cilësie, efikasitet
9	Sistemi i Mbështetjes së Vendimeve për Planifikimin e Burimeve...	Modelim dhe simulim për planifikim	Sisteme mbështetëse vendimi	Menaxhim burimesh, përmirësim planifikimi
10	Transitional care of older adults in skilled nursing facilities (Toles et al.)	Kujdes tranzicional, edukim	Jo të specifikuar	Koordinim daljes, edukim për vetëkujdes

Ndryshimet tematike: Disa studime përqendrohen kryesisht në ndërhyrjet e avancuara infermiore, ndërsa të tjerat fokusojnë më shumë në aspektet edukative dhe kompetencat profesionale.

Strategjitë dhe protokollat: Review-t paraqesin përdorime të ndryshme të protokolleve

multidisiplinare, edukimit të pacientit dhe përdorimit të teknologjive të reja si inteligjenca artificiale.

Roli i infermierit: Infermierët shfaqen si koordinues, edukatorë dhe monitorues të vazhdueshëm të pacientëve, duke luajtur rol kyç në menaxhimin e kujdesit, rehabilitimin dhe planifikimin e burimeve.

Nga ky krahasim, del qartë se ekzistojnë modele dhe praktika të ndryshme që mund të përshtaten dhe zhvillohen në kontekstin shqiptar për të përmirësuar kujdesin geriatrik, duke i dhënë një rol më të madh infermierisë së avancuar. Kjo kërkon një përjasje të integruar ligjore, edukative dhe teknologjike, për të kapërcyer barrierat ekzistuese.

Analizë e zgjeruar e 10 review-ve të përzgjedhura

Review 1 – Roli i Infermierëve të Praktikës së Avancuar në Kujdesin për të Moshuarit [21]

Ky rishikim sistematik, i publikuar në *International Journal of Nursing Studies* (Janar 2016), synon të identifikojë dhe vlerësojë ndikimin e ndërhyrjeve të kryera nga infermierët e praktikës së avancuar (Advanced Practice Nurses – APNs) në kujdesin për të moshuarit, në një gamë të gjerë mjedisesh shëndetësore. Metodologjia: Në këtë studim autorët analizuan 15 studime të përzgjedhura që trajtonin ndikimin e APN-ve në kujdesin afatshkurtër dhe afatgjatë për të moshuarit. Fokusi i analizës përfshinte ndërhyrjet multidisiplinare, kujdesin e integruar dhe vlerësimet klinike të avancuara.

Gjetjet kryesore:

Në mjediset e kujdesit afatgjatë, APN-të ofruan kujdes të vazhdueshëm dhe të integruar që ndikoi në uljen e ri-pranimeve në spital dhe rritjen e kënaqësisë së pacientëve dhe kujdestarëve.

Ndërhyrjet e APN-ve përfshinin edukimin e pacientëve, vlerësime multidimensionale dhe koordinimin e aktorëve të ndryshëm të kujdesit shëndetësor.

Pothuajse të gjitha studimet theksonin rolin e tyre si pjesë integrale e ekipeve multidisiplinare dhe ndikimin pozitiv në autonominë e pacientëve dhe menaxhimin e simptomave kronike.

Përfundime: Review-ja arrin në përfundimin se ndërhyrjet e infermierëve të praktikës së avancuar janë

efektive në përmirësimin e cilësisë së kujdesit për të moshuarit. Megjithatë, autorët sugjerojnë nevojën për kërkime të mëtejshme që fokusohen në kostefektivitetin dhe krahasimin ndërkombëtar të modeleve të kujdesit të udhëhequra nga APN-të.

Tabela 7 Review 1: Rezultatet e Studimit - Përqindje nga 15 studimet

Rezultat / Tipi i Efektit	Përqindje
Ulje e ri-pranimeve në spitale	40%
Rritje e kënaqësisë së pacientëve/kujdestarëve	33%
Përmirësim i autonomisë dhe menaxhimit	27%
Edukim dhe koordinim në ekip multidisiplinar	100%
Modele të avancuara të infermierisë (2 lloje)	100%

Diagramë 3 Review 1: Rezultatet e 15 studimeve



Përfundime:

Review-ja arrin në përfundimin se ndërhyrjet e infermierëve të praktikës së avancuar janë efektive në përmirësimin e cilësisë së kujdesit për të moshuarit. Megjithatë, autorët sugjerojnë nevojën për kërkime të mëtejshme që fokusohen në kostefektivitetin dhe krahasimin ndërkombëtar të modeleve të kujdesit të udhëhequra nga APN-të.

Studimi nënvizon rolin qendror të infermierëve si koordinatorë dhe edukatorë aktivë në procesin e rehabilitimit, duke kontribuar në reduktimin e ri-pranimeve dhe fuqizimin e pacientëve dhe familjarëve për të menaxhuar më mirë nevojat shëndetësore pas daljes nga institucioni.

Studimi thekson se kualifikimi dhe edukimi i qëndrueshëm profesional janë themel për rritjen e cilësisë së kujdesit në infermierinë geriatrike. Këto gjetje përputhen me nevojën për reformim të vazhdueshëm të kurrikulave dhe politikave të trajnimit, edhe në kontekste të tjera me sfida të

ngjashme, përfshirë Shqipërinë.

Studimi nënvizon rëndësinë e zhvillimit të një kornize kompetencash të standardizuara që mund të adoptohet në programet e edukimit infermior, trajnimet e vazhdueshme dhe protokollet klinike. Autonomia profesionale, bashkëpunimi ndërdisiplinar dhe aftësia për të integruar vlerësimin e plotë të pacientit janë thelbësore për të përballuar sfidat e kompleksitetit geriatrik.

Studimi thekson rëndësinë e zhvillimit të protokolleve, trajnimit të posaçëm dhe udhëzimeve etike për implementimin e suksesshëm të AI në sistemin e kujdesit ndaj të moshuarve, duke siguruar një balancë midis teknologjisë dhe ndjeshmërisë njerëzore.

Ky studim evidenton rolin gjithnjë e më të rëndësishëm të infermierëve në kujdesin rehabilitues për të moshuarit në mjediset e kujdesit parësor. Përfshirja e tyre aktive në vlerësimin funksional, përcaktimin e objektivave të personalizuar dhe menaxhimin e rasteve ndihmon në përmirësimin e rezultateve klinike dhe në reduktimin e pabarazive në aksesin ndaj rehabilitimit. Të dhënat tregojnë se një përqindje shumë e lartë e pacientëve të moshuar (93%) nuk janë në rrezik të afërt për vdekshmëri dhe për rrjedhojë mund të përfitojnë ndjeshëm nga ndërhyrjet proaktive të bazuara në ekip ndërdisiplinar. Integrimi sistematik i infermierëve në këtë proces është thelbësor për përballimin e sfidave të plakjes së popullatës dhe avancimin e kujdesit komunitar.

Studimi sugjeron se inteligjenca artificiale dhe modelet e mësimi të thellë nuk janë vetëm teknologji shtesë, por mund të transformojnë mënyrën se si ekipi infermior dhe klinikistët e tjerë marrin vendime në kohë reale, duke e bërë kujdesin paliativ më të aksesueshëm, efektiv dhe të drejtuar nga nevojat reale të pacientëve.

Studimi demonstroi qartë se integrimi i sistemeve të automatizuara për vlerësimin cilësor nuk është vetëm një zgjidhje teknologjike, por një mjet strategjik për përmirësimin e standardeve të kujdesit në geriatrikë. Roli i infermierëve si përdorues aktivë të këtyre sistemeve është thelbësor për suksesin dhe qëndrueshmërinë e implementimit.

Studimi sugjeron që zbatimi i një Sistemi të Mbështetjes së Vendimeve (DSS) për planifikimin e burimeve është një hap thelbësor për përmirësimin e fleksibilitetit dhe cilësisë së kujdesit në institucionet për të moshuarit. Roli i infermierëve si përdorues dhe vlerësues të rezultateve nga DSS mbetet i pazëvendësueshëm në procesin e marrjes së vendimeve.

Kujdesi tranzicional i ofruar nga SNF në komunitet rezultojnë i efektshëm në shumicën e studimeve për përmirësimin e pavarësisë dhe uljen e ngarkesës në sistemin spitalor. Megjithatë, autorët vërejnë një rrezik metodologjik të lartë, duke theksuar nevojën për studime të standardizuara, me dizajn të qëndrueshëm dhe madhësi të mjaftueshme kampioni.

Faktorët socialë

Rrjeti social dhe mbështetja familjare luajnë një rol vendimtar në shëndetin fizik dhe mendor të individëve të moshuar. Studimet tregojnë se izolimi social dhe vetmia janë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në përkeqësimin e sëmundjeve ekzistuese dhe rritjen e mortalitetit në këtë grupmoshë.

Ndryshimet madhore në jetën e të moshuarve, si pensionimi, humbja e partnerit, zhvendosja nga vendbanimi dhe mungesa e një rrethi shoqëror aktiv, mund të çojnë në depresion, çrregullime të të ushqyerit dhe negjizhencë të kujdesit personal. Në mënyrë të veçantë, individët që jetojnë vetëm ose kanë marrëdhënie të kufizuara sociale shpesh përjetojnë një rënie të mirëqenies psikologjike dhe emocionale.

Në vendet me burime të kufizuara, si Shqipëria, vërehet mungesa e shërbimeve sociale të dedikuara për të moshuarit dhe mos-përshtatja e sistemit të kujdesit shëndetësor ndaj nevojave të kësaj grupmoshe. Kjo krijon sfida të mëdha për infermierët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor në adresimin efektiv të problemeve të shëndetit mendor dhe fizik të të moshuarit. [22]

Faktorët psikologjikë

Të moshuarit shpesh përjetojnë sfida emocionale dhe psikologjike që ndikojnë drejtpërdrejt në gjendjen e tyre fizike dhe cilësinë e jetës. Depresioni është një nga çrregullimet më të zakonshme, por shpesh mbetet i pa-diagnostikuar në këtë grupmoshë. Ai manifestohet me ulje të apetitit, mungesë motivimi për trajtim mjekësor dhe përkeqësim të sëmundjeve kronike, duke rritur rrezikun e komplikimeve shëndetësore.

Përveç depresionit, çrregullimet e kujtesës dhe sëmundjet neurodegenerative, si demenca dhe sëmundja e Alzheimerit, krijojnë një barrë të rëndë psikologjike, si për pacientët, ashtu edhe për kujdestarët e tyre. Ndryshimet në funksionin kognitiv

mund të sjellin ankth, konfuzion dhe humbje të.

Tabela 18 e Review-ve: Përmbledhje krahasuese e 10 studimeve mbi rolin e infermierëve dhe ndërhyrjet në kujdesin geriatric

Nr.	Autorët & Viti	Tema	Fokusi kryesor	Roli i infermierit	Kontributi / Rezultatet
1	Melo et al. (2018)	Kujdesi tranzicional	Trajnimi i kujdestarëve	Edukim dhe mbështetje	Rritje e kompetencës familjare
2	Wahl et al. (2019), WHO	Parandalimi dhe kujdesi proaktiv	Lidhja stil jetese–demençë	Ndërhyrje të hershme	Qasje proaktive multidisiplinare
3	BMC Nursing (2024)	Kompetencat profesionale	Vlerësim dhe përmirësim i kompetencave	Trajnim klinik	Rritje e vetëbesimit dhe praktikës cilësore
4	Geriatrics (2024)	Vlerësim gjithëpërfshirës (CGA)	Standardizim i kompetencave në kujdesin parësor	CGA në praktikë	Rritje e saktësisë dhe koordinimit të kujdesit
5	Geriatric Nursing (2025)	AI në geriatrikë	Përceptimet e infermierëve mbi përdorimin e AI	Adaptim teknologjik	Mbështetje + rezistencë; nevojë për trajnim
6	SAGE Journals (2024)	Rehabilitim në komunitet	Roli aktiv i infermierëve në rikuperim	Menaxhim i rasteve	Ndjekje e personalizuar, ulje e ngarkesës spitalore
7	arXiv (2017)	Mësimi i thellë dhe kujdesi palativ	Identifikim i hershëm përmes algoritmeve	Mbështetje për CDSS	Rritje e vendimeve të sakta për kujdes palativ
8	arXiv (2022)	Cilësia në menaxhimin afatgjatë	Monitorim cilësor me sisteme automatike	Vlerësim, dokumentim	Rritje e efikasitetit dhe qartësisë në kujdes
9	arXiv (2021)	Planifikimi i burimeve	DSS për kujdesin në shtëpitë e të moshuarve	Përdorues dhe vlerësues	Optimizim i kapacitetit dhe fleksibilitetit strukturor
10	Toles et al. (2016)	Kujdesi tranzicional SNF–shtëpi	Efektet afatshkurtra pas daljes nga institucioni	Edukim dhe koordinim	67% ulje riprimesh; 100% treguan përfitime

autonomisë, duke ndikuar në mirëqenien e përgjithshme të pacientit

Roli i infermierëve është thelbësor në identifikimin e hershëm të problemeve psikologjike dhe aplikimin e qasjeve holistike të kujdesit, të cilat përfshijnë intervenime terapeutike, mbështetje emocionale dhe komunikim aktiv me pacientin dhe familjarët. Kualifikimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i infermierëve për menaxhimin e shëndetit mendor tek të moshuarit është një domosdoshmëri për të garantuar trajtim efektiv dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve geriatrikë. [23]

Faktorët mjedisorë dhe kulturorë

Ambienti ku jeton një individ i moshuar ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen ose përkeqësimin e shëndetit të tij. Mungesa e kushteve të përshtatshme në shtëpi, si ndriçimi i pamjaftueshëm, shkallët e papërshtatura dhe

mungesa e ndihmës sociale, rrit ndjeshëm rrezikun për rënie, lëndime dhe izolim social. Për më tepër, ndotja e ajrit dhe ushqimit ka një ndikim të drejtpërdrejtë në përkeqësimin e sëmundjeve respiratore dhe kardiovaskulare, duke rritur vulnerabilitetin e të moshuarve ndaj komplikimeve shëndetësore.

Kultura luan një rol po aq vendimtar në mirëqenien e të moshuarve. Në shoqëritë ku të moshuarit perceptohen si barrë për familjen, ka një incidencë më të lartë të depresionit, izolimit dhe keqtrajtimit, gjë që ndikon negativisht në cilësinë e jetës së tyre. Këto faktorë kërkojnë ndërhyrje të strukturuar, si përmirësimi i politikave sociale, investimi në shërbime komunitare për të moshuarit dhe promovimi i një qasjeje më përfshirëse në sistemin e kujdesit shëndetësor. [16]

Situata e Kujdesit Geriatrik në Shqipëri: Studime të Zbatuara dhe Analizë

Një nga studimet më të rëndësishme në këtë fushë është ai i Podgorica et al. (2024), i publikuar në revistën ndërkombëtare *PLOS One*. Ky studim cilësor, i bazuar në intervista me 20 infermierë në tetë institucione të kujdesit për të moshuarit në Shqipëri, analizoi përvojat dhe sfidat e tyre në ofrimin e kujdesit për pacientët me sëmundje kronike dhe çrregullime kognitive.

Infermierët raportuan mungesë të përgatitjes specifike në kujdesin geriatrik, duke theksuar se programet universitare dhe trajnimet profesionale në Shqipëri nuk përfshijnë module të dedikuara për menaxhimin e plakjes dhe sëmundjeve geriatrike. Ata gjithashtu përballeshin me vështirësi të theksuara në trajtimin e pacientëve me demencë, depresion dhe çrregullime të funksioneve bazë, si vetëpërmbytja apo të ushqyerit. Një nga shqetësimet më të mëdha të identifikuar ishte ndjenja e pamjaftueshmërisë emocionale, e cila buron nga mungesa e mbështetjes psikologjike dhe mbingarkesa profesionale.

Në përfundim, studimi theksoi domosdoshmërinë e reformave urgjente në politikat shëndetësore në Shqipëri, duke rekomanduar investime në edukimin e vazhdueshëm për infermierët, zhvillimin e qendrave trajnuese dhe krijimin e protokolleve specifike për kujdesin geriatrik.

Çrregullimet Kognitive tek të Moshuarit Shqiptarë dhe Faktorët Ndikues

Një studim kombëtar i vitit 2024, me titull *Estimating the prevalence of cognitive impairment and its associated factors in Albania: A nationwide cross-sectional study*, ofroi një panoramë të detajuar mbi përhapjen dhe faktorët ndikues të dëmtimit kognitiv në Shqipëri. Studimi analizoi mbi 1,000 individë të moshës mbi 50 vjeç në të gjitha qarqet e vendit, duke përdorur Mini-Mental State Examination (MMSE) dhe Elderly Depression Questionnaire (EDQ) për të vlerësuar nivelin e dëmtimit kognitiv dhe depresionit.

Rezultatet kryesore

Gjetjet treguan se:

14% e të anketuarve kishin çrregullime të moderuara ose të rënda kognitive.

54% kishin shenja të dëmtimit të lehtë ose fillestar të funksioneve mendore, duke sugjeruar një rrezik të lartë për zhvillim të demencës ose sëmundjeve neurodegenerative në të ardhmen.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në përkeqësimin kognitiv

Studimi identifikoi disa faktorë që kontribuojnë në dëmtimin kognitiv:

Hipertensioni (41% e rasteve) – një faktor kryesor për rritjen e dëmtimit vaskular cerebral.

Përdorimi i duhanit dhe konsumi i alkoolit – të lidhura me inflamacionin neuronal dhe dëmtimin oksidativ.

Mungesa e aktivitetit fizik – që ndikon negativisht në neuroplasticitet dhe funksionin cerebral.

Sëmundjet metabolike, si diabeti mellitus dhe hiperkolesterolemia, që ndikojnë në dëmtimin e enëve të gjakut dhe rrjedhën e oksigjenit në tru.

Rekomandime

Autorët sugjeruan:

Krijimin e një regjistri kombëtar për individët me rrezik të lartë për çrregullime kognitive.

Rritjen e ndërgjegjësisë së mjekët e familjes dhe infermierët për të realizuar testime rutinë mbi funksionin kognitiv në nivelin e kujdesit parësor.

Zhvillimin e programeve parandaluese, duke përfshirë aktivitete fizike, dieta të shëndetshme dhe strategji për reduktimin e stresit.

Në këtë seksion paraqiten studimet kryesore të përzgjedhura lidhur me rolin dhe kompetencat e infermierëve në kujdesin geriatrik, me fokus në grupmoshat e ndryshme të pacientëve të moshuar dhe tipet e ndryshme të kujdesit. Studimet janë kategorizuar sipas qëllimit, grupmoshave të përfshira, llojeve të kujdesit dhe rolit të infermierit në kontekstet specifike.

Përfundime

Ky studim nxjerr në pah rëndësinë thelbësore të rolit infermieror në planifikimin e kujdesit të avancuar për moshat geriatrike. Rezultatet e analizës tregojnë se Shqipëria ende përballlet me mangësi ligjore dhe strukturore në këtë fushë, duke kufizuar efektivitetin e ndërhyrjeve shëndetësore për të moshuarit. Megjithatë, përvoja ndërkombëtare dhe vëzhgimet praktike tregojnë se përfshirja aktive e infermierëve sjell përmirësim të ndjeshëm në cilësinë e jetës së pacientëve të moshuar, përmes:

Komunikimit empatik dhe edukimit të pacientëve për opsionet e kujdesit afatgjatë.

Koordinimit me ekipin mjekësor për të optimizuar trajtimin dhe menaxhimin e simptomave.

Zbatimit të qasjeve multidisiplinare, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë për përmirësimin e proceseve të vendimmarrjes.

Në Shqipëri, mungesa e një kuadri të qartë ligjor dhe mungesa e trajnimeve të specializuara e bën këtë rol të vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Infermierët përballen gjithashtu me sfida emocionale dhe etike, si ndjenja e pamjaftueshmërisë dhe mungesa e burimeve institucionale, duke ndikuar drejtpërdrejt në efikasitetin e tyre.

Rekomandime

Për të përmirësuar rolin e infermierëve në planifikimin e kujdesit të avancuar për moshat geriatrike, propozohet një qasje shumëdimensionale, duke përfshirë

1. Zhvillimi i një kuadri ligjor të qartë

Miratimi i protokolleve për udhëzimet paraprake, duke mundësuar vendimmarrje të strukturuar për pacientët geriatrikë.

Përfshirja e infermierëve në hartimin e politikave shëndetësore, për të rritur efektivitetin e kujdesit afatgjatë.

2. Edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm

Integrimi i moduleve mbi planifikimin e kujdesit të avancuar dhe kujdesin paliativ në programet e edukimit infermieror.

Organizimi i trajnimeve për infermierët në komunikim etik, menaxhimin e simptomave dhe vlerësimin funksional të pacientëve.

3. Protokolle institucionale për fuqizimin e rolit infermieror

Standardizimi i procedurave për dokumentimin e ACP-së, duke ofruar udhëzime të qarta për infermierët.

Ngritja e një sistemi multidisiplinar që lejon një rol më aktiv për infermierët në proceset vendimmarrëse.

4. Krijimi i qendrave të specializuara për kujdesin geriatrik

Ndërtimi i qendrave të kujdesit afatgjatë me staf të trajnuar në geriatrikë dhe kujdes paliativ.

Përdorimi i teknologjisë dhe AI për optimizimin e trajtimeve dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve.

Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve të moshuar dhe do të mundësojnë rol më aktiv për infermierët në planifikimin e kujdesit të avancuar.

Kujdesi infermieror ndaj pacientëve të cilët ndjekin dializën, situata aktuale

Federika Likaj. (2025)

Program i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Shkenca Infermiore"

Udhëheqës shkencor: Dr. Evis Alushi

Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Pacientët në dializë përballen me sfida të shumta fizike, psikologjike dhe sociale. Cilësia e kujdesit infermieror që nga monitorimi klinik deri te edukimi shëndetësor luan rol thelbësor në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe në parandalimin e komplikacioneve intra- dhe pas-dialitike. Kjo tezë është ndërtuar mbi nevojën për të kuptuar në situatën aktuale të pacientëve që kryejnë dializë.

Ky studim ka për qëllim të vlerësojë nivelin e kujdesit infermieror në Repartin e Dializës të Spitalit Rajonal të Vlorës dhe të evidentoj situatën aktuale.

Objektivat specifikë përfshijnë:

1. të vlerësohet roli i kujdesit infermieror në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe trajtimit të pacientëve që ndjekin dializën hemodialitike apo peritoneale.
2. Të identifikohen nevojat fizike, psikologjike dhe sociale të pacientëve që janë në dializë
3. Të evidentohen masat parandaluese dhe ndërhyrjet infermiore për komplikacionet e mundshme gjatë

dializës.

4. Të vlerësohet niveli i njohurive dhe edukimit shëndetësor që marrin pacientët nga personeli infermieror.

U zhvillua një studim përshkrues, i ndërthurur me elemente analitike, gjatë periudhës qershor –korrik 2025. Në studim morën pjesë 33 individë (20 meshkuj, 13 femra) me moshë 21–72 vjeç, të përzgjedhur me mostër të rastësishme të thjeshtë nga regjistri i pacientëve aktivë të repartit. Të dhënat u mbledhën me: një pyetësor të strukturuar për pacientët (vlerësim i cilësisë së jetës, i informatave të marra dhe i kënaqësisë me kujdesin).

Në studimin e kryer të gjithë (100%) pacientët e pyetur e kryenin dializën 3 herë në javë dhe të gjithë këta të fundit 100% kryenin hemodializë, asnjë dializë peritoneale.

Rreth 91.2 % e pacientëve raportuan kënaqësi të lartë me kujdesin klinik, u shprehën se marrin informacion të mjaftueshëm për ilaçet, ushqimet, trajtimin dhe

komplikacionet. Nevojat më të theksuara ishin të mbështetja emocionale ku 51.5 % deklarorin se ishin *shpesh* të mbështetur dhe të të ndjerit të sigurt gjatë trajtimit ku 54.5% referorin se ndiheshin *shpesh* të sigurt.

100% e të anketuarve e njihnin koordinatorin infermior dhe 90.9% merrnin ndihmën shpesh sa herë e kërkonin gjatë trajtimit. 66.7% e të anketuarve janë dakord që infermierët të jenë më shumë aktivë me përfshirje në edukimin e tyre shëndetësor. 78.8% e të anketuarve do të merrnin pjesë me shumë dëshirë nëse stafi infermior do të organizonte seminare/trajnime në lidhje me dializën.

Fjalët kyçe :Dializa,kujdes infermior, hemodializë, pacientë kronikë, edukim shëndetësor, mbështetje emocionale.

Abstract

Background Patients on dialysis face numerous physical, psychological, and social challenges. The quality of nursing care, from clinical monitoring to health education, plays a crucial role in improving quality of life and preventing intra- and post-dialysis complications. This thesis is built on the need to understand the current situation of patients undergoing dialysis. **Aim & Objectives** This study aims to assess the level of nursing care in the Dialysis Ward of the Vlorë Regional Hospital and to highlight the current situation.

Specific objectives include:

1. To evaluate the role of nursing care in improving the quality of life and treatment of patients undergoing hemodialysis or peritoneal dialysis.
2. To identify the physical, psychological, and social needs of patients on dialysis.
3. To highlight preventive measures and nursing interventions for potential complications during dialysis.

4. To assess the level of knowledge and health education that patients receive from nursing staff. **Material and Methods** A descriptive study, incorporating analytical elements, was conducted during the period June–July 2025. The study included 33 individuals (20 males, 13 females) aged 21–72 years, selected through a simple random sample from the active patient registry of the department. Data

were collected using: a structured questionnaire for patients (assessment of quality of life, information received, and satisfaction with care).

In the conducted study, all (100%) of the patients surveyed received dialysis three times a week, and all of them (100%) underwent hemodialysis, none received peritoneal dialysis. About 91.2% of patients reported high satisfaction with clinical care and stated that they received sufficient information about medications, diet, treatment, and complications. The most emphasized needs were in emotional support, where 51.5% reported that they were often supported, and in feeling safe during treatment, where 54.5% reported that they often felt safe. 100% of respondents knew the nurse coordinator, and 90.9% received help often whenever they asked for it during treatment. 66.7% of respondents agreed that nurses should be more active in involving them in their health education. 78.8% of respondents would participate willingly if the nursing staff organized seminars/training related to dialysis.

Keywords: *Dialysis, nursing care, hemodialysis, chronic patients, health education, emotional support.*

Hyrje

“Të parandalosh sëmundjen është më lehtë se sa ta mjekosh atë.”

Ky postulat qëndron në themel të mjekësisë së sotme dhe njëkohësisht është mision i saj. Në grupin e Sëmundjeve kronike të veshkave (SKV) përfshihen një numër i madh sëmundjesh të cilat zënë një vënd me rëndësi në patologjitë humane në përgjithësi dhe në atë të veshkave në veçanti. SKV janë patologji kronike të veshkave që nga njëra anë janë shumë shkakësore që do të thotë se shkaktohen nga një numër i madh sëmundjesh dhe nga ana tjetër janë multisistemike që do të thotë se prekin njëkohësisht shumë sisteme dhe organe duke e rënduar së tepërmi gjendjen e të sëmurit, duke e bërë jetën e tij shumë të vështirë dhe shpesh herë tejet të rënduar.[1]

Në një pjesë të mirë të rasteve disa sëmundje renale ose të ashtuquajturit faktorë risku i dëmtojnë heshturazi veshkat pa shenja të dukshme klinike prandaj dhe me të drejtë shumica e autorëve i kanë quajtur këto patologji si “Killer silenciozë”. Pra ato kanë prirje që herët apo vonë ,kjo në vartësi të shkakut të tyre, ta çojnë të

sëmurin drejtë IRK në stadin e uremisë e më pas në uremi terminale stad në të cilin këta të sëmurë e kanë të vështirë mbijetesën dhe se kanë nevojë për terapi zëvendësuese hemodializë, dializë peritoneale apo transplant. [1]


Rast Studimi

Në kuadër të këtij studimi, është ndërmarrë një hulumtim empirik me qëllim të identifikimit të perceptimeve, qëndrimeve dhe faktorëve ndikues në kujdesin infermior në repartin e dializës në qytetin e Vlorës.. Kjo ndërmarrje u konsiderua e domosdoshme duke pasur parasysh sfidat e shumta me të cilat përballet ky sektor i infermierisë në vend.

Të dhënat demografike

Në këtë seksion paraqiten të dhënat demografike të pjesëmarrësve në anketë, të cilat shërbejnë si bazë për të kuptuar më mirë karakteristikat themelore të kampionit dhe për të vendosur kontekstin mbi të cilin do të ndërtohet interpretimi i mëvonshëm i perceptimeve dhe qëndrimeve të tyre lidhur me Kujdesin e infermierit. Anketa u plotësua nga 33 pacient, të moshës 21 deri në 72 vjeç. Sa i përket përbërjes sipas moshës, 39.4% e të anketuarve (13 persona) i përkisnin grupmoshës 61-70 vjeç, ndjekur nga 50-60 vjeç me 33.3% (11 persona), 71-80 vjeç me 21.2% (7 persona), si janë prezantuar në Figurën 1.


Figurë 1 – Shpërndarja sipas grupmoshave në përqindje e të anketuarve



Lidhur me gjininë, 39.4% e të anketuarve ishin femra (13 paciente) dhe 60.6% ishin meshkuj (20 pacient).


Këto të dhëna përputhen edhe me hulumtimet të tjera të cilat janë kryer në qendra të ndryshme të dializës në botë. Sipas Hecking [17] në një hulumtim të kryer në 12 vende të ndryshme të botës, në mbi 206,000 pacientë në dializë është theksuar se 59% e këtyre pacientëve kanë qenë meshkuj dhe 41% e tyre kanë qenë femra. Në Figurën 2 paraqitet një shpërndarje e pacientëve në dializë në bazë të gjinisë e cila ka marrë pjesë në hulumtim, dhe duket qartë se dominon gjinia mashkullore.

Figurë 2 - . Shpërndarja e pacientëve në hulumtim sipas gjinisë



Për të vazhduar me statusin civil të pacientëve që i nënshtrohen hemodializës, vihet re se 84.8% (28 pacientë) janë të martuar dhe 15.2% (5 pacientë) janë beqarë. Ky është një tregues mjaft i qartë, Figura 3, se shumica kanë mbi supe edhe prokurime familjare

Figurë 3 - Shpërndarja e pacientëve në hulumtim sipas statusit civil



Për të mbyllur të dhënat demografike dhe për të vazhduar me seksionin e dytë të hulumtimit, shprehet dukshëm me grafik se niveli arsimor që mbizotëronte tek pacientët në dializë (Figura 4) ishte ai 9-vjeçar ose 8-vjeçar, siç e referonin ata, me 63.6% (21 pacientë) dhe

36.4% (12 pacientë) me arsim të mesëm.

Figurë 4 - Shpërndarja e pacientëve në hulumtim sipas nivelit arsimor

4. Niveli arsimor:
33 responses




Tabela 1 tregon një përmbledhje të të gjitha të dhënave demografike të treguara në Seksionin 2.2.1.

Tabelë 1 - Përmbledhje e të dhënave demografike të të anketuarve.

Variabli	Kategoria	Numri (n)	Perqindja (%)
Mosha	20-30 vjeç	2 pacientë	6.1%
	50-60 vjeç	11 pacientë	33.3%
	61-70 vjeç	17 pacientë	39.9%
	71-80 vjeç	7 pacientë	21.2%
Gjinia	F	13 pacientë	39.4%
	M	20 pacientë	60.6%
Statusi Civil	I/e martuar	28 pacientë	84.8%
	Beqar / e	5 pacientë	15.2%
Arsimimi	8-vjeçar	21 pacientë	63.6%
	I mesëm	12 pacientë	36.4%

Eksperienca në dializë, kujdesi infermieror dhe mbështetja

Seksioni "Eksperienca në dializë, kujdesi infermieror dhe mbështetja" në pyetësin e shpërndarë ka disa qëllime të rëndësishme, sidomos në kontekstin e një studimi për cilësinë e kujdesit infermieror. Ja qëllimet kryesore:

1. Vlerësimi i përvojës së pacientit në dializë. Pra kështu kuptojmë:

- Si e përjetojnë pacientët procesin e dializës.
 - Sa komod dhe të sigurt ndihen gjatë trajtimit.
 - Nëse kanë ndonjë shqetësim të përsëritur fizik ose emocional gjatë dializës.
2. Matja e cilësisë së kujdesit infermieror. Që vlerëson:
- Sa të kujdesshëm, të gatshëm dhe profesionalë janë infermierët.
 - Sa mirë komunikohet me pacientët.


- Nëse respektohen nevojat individuale të pacientëve.
3. Vlerësimi i mbështetjes emocionale dhe psikologjike. Pacientët në dializë shpesh përballen me stres afatgjatë. Kjo pjesë e pyetësorit synonë:
- Të kuptojë nëse ata ndihen të mbështetur emocionalisht.
 - Nëse infermierët u ofrojnë ndihmë psikologjike ose i drejtojnë te profesionistët përkatës.
4. Identifikimi i nevojave për përmirësim
- Të dhënat e mbledhura mund të ndihmojnë në:
- Identifikimin e dobësive në sistemin e kujdesit.
 - Përcaktimin e fushave që kërkojnë trajnime shtesë për stafin infermieror.
5. Rritja e cilësisë së përgjithshme të shërbimit
- Së fundmi përmes analizës së këtij seksioni, drejtuesit mund të:
- Hartojnë plane konkrete për përmirësimin e cilësisë së kujdesit.
 - Ndërtojnë një qasje më humane dhe të personalizuar ndaj pacientëve.
- Në përfundim, ky seksion është thelbësor për të kuptuar jo vetëm aspektin teknik të trajtimit me dializë, por edhe dimensionin njerëzor dhe emocional të kujdesit infermieror që luan rol kritik në përvojën dhe mirëqenien e pacientit.

Pyetja 1: Sa është kohëzgjatja në dializë?

Seksioni u hap me një pyetje interesante në llojin e saj sepse synonte të merrte informacionin se sa kohë nga jeta e tyre kishin shpenzuar pacientët e dializës duke kryer trajtimin, duke vendosur shëndetin në vijë të pare. Nga grafiku (figura 8) duke haptazi se ka varietete të ndryshme përsa i përket kohëzgjatjes. Ky është edhe një tregues se pacientë që kanë kohë të gjatë që janë pjesë e repartit të dializës po e superojnë fare mire, në pamundesi të një transplanti për ta ndërprer atë. Kështu të dhënat e mbledhura tregojnë se 6.1% (2 pacientë) kanë 4 muaj që kryejnë dializë. 12.1% (4 pacientë) kanë 6 muaj që kryejnë dializë. 9.1% (3 pacientë) kanë 1 vit që kryejnë dializë. Në mënyrë të barabartë edhe për 2 vite, 9.1%. Kalojmë me nga 3 vite janë 12.1% e pacientëve (4 veta). Me nga 4 vite që kryejnë dializë janë serisht 4 pacientë. 12.1%. 5 vjeçari shenon numrin më të lartë me 18.2% ose 6 pacientë që ndjekin dializën. Prej 6 vitesh kemi 12.1% ose 4 pacientë që ndjekin

dializë. Me 8 vite, 2 pacientë që përbëjnë 6.1% dhe në fund por jo nga rëndësia një pacientë që kryen dializë prej 9 vitesh me një vend prej 3%.


Figurë 5 – Shpërndarja e pacientëve sipas kohëzgjatjes në dializë



Pyetja 2: Sa here në javë kryeni dializë?

Sipas Peter Kerr[18], në hulumtimin e tij mbi frekuencën dhe kohëzgjatjen e sesioneve të dializës nëpër vende të ndryshme është theksuar se dializa zgjat zakonisht 4 orë, në 98% të pacientëve, të cilët e kryejnë dializën 3 herë në javë. E njëjta dukuri vihej re edhe në repartin e Dializës Vlorë. Të gjithë pacientët e marrë pjesë në anketim 100% kryenin dializën 3 herë në javë.

Figurë 6 – Shpërndarja e pacientëve sipas herëve që kryejnë dializë




Pyetja 3: Lloji i dializës që kryeni?

Duke qenë se ofrohen 2 tipe dializash, ajo peritoneale dhe hemodializa, me rëndësi do të ishte të dinim se cilën prej tyre kishte më shumë nevojë klienti i këtij reparti. Rezultoi se 100% e pacientëve të pyetur i

nënshtroheshin hemodializës (figura 7)

Figurë 7 – Shpërndarja e pacientëve sipas llojit të dializës që kryejnë




Pyetja 4: A vuani nga ndonjë sëmundje tjetër?

Në faktë është e zakonshme që pacientët në repartin e dializës, krahas sëmundjeve të veshkës të kenë bashkëshoqëruar edhe sëmundje të tjera. Kjo referencë është thelbësore të dihet nga stafi mjekësor për mbarëvajtjen e trajtimit. Prezente janë sëmundjet Kardiovaskulare ku theksi bie mbi HTA. Sëmundje hematologjike siç është Anemia. Mirëpo një theks i veçantë në repartin e dializës, pranë Spitalit Rajonal Vlorë, binte mbi sëmundjet hepatike. Hepatitet trajtoheshin me një kujdes të mirëfillt, me infermierë të specializuar dhe makineri bashkëkohore, në dhomë speciale.

Pacientët e marrë pjesë në anketim referuan se 21.2% ose 7 pacientë vuajnë nga tensioni i lartë (HTA). 15.2% ose 5 pacientë vuanin edhe nga hepatitis. Njëjtë në shifra edhe anemia 15.2% (5 pacientë), dhe pjesa e mbetur 48.5% (16 pacientë) referuan se nuk vuanin nga ndonjë sëmundje tjetër shoqëruese (figura 8).

Figurë 8 – Shpërndarja e pacientëve sipas sëmundjes që kanë shoqëruese




Pyetja 5: A keni ju një koordinator infermieror?

Kjo pyetje pasuese kishte për qëllim të nxirrte në pah se a e kishin vënë re pacientët praninë e dikujt përgjegjës për ata në rastin e ndonjë të papriture apo kur një infermierë i thjeshtë do të kishte pasur nevojë për dikë më të kualifikuar në rrethanat e asaj zone. Nga anketa u vu re se 100% e atyre që morën pjesë e kishin pa diskutim një koordinator infermieror (figura 9).

Figurë 9 – Shpërndarja e pacientëve nëse kishin a jo një koordinator infermieror

9. A keni ju një koordinator infermieror?
33 responses

*Pyetja 6: Muajin e fundit, sa here keni kërkuar ndihmë nga stafi infermieror?*

Qëllimi i kësaj pyetje është të vlerësojë nivelin e nevojës së pacientëve për mbështetje gjatë trajtimit me dializë dhe të identifikojë shkallën e ndërveprimit me stafin infermieror. Kjo pyetje ndihmon në analizimin e disponueshmërisë, qasjes dhe efektivitetit të kujdesit infermieror, si dhe mund të tregojë nëse ka mungesa në ofrimin proaktiv të shërbimit apo nevoja të përsëritura që kërkojnë më shumë vëmendje.

Nga anketa (figura 10) u vu re se 36.4% ose 12 pacientë nuk kishin pasur nevojë për ndihmë gjatë seancës së dializës. Rreth 39.4% ose 13 pacientë kishin kërkuar ndihmë nga stafi infermieror 2-3 herë muajin e fundit. 15.2% (5 pacientë) kishin kërkuar ndihmë 3-5 herë nga stafi infermieror dhe së fundmi 9.1% (3 pacientë) kishin kërkuar më shumë se 5 herë ndihmë nga stafi infermieror.

Figurë 10 – Shpërndarja e pacientëve sipas nevojës për ndihmë të stafit infermieror muajin e fundit


Pyetja 7: Infermierët më trajtojnë me respekt dhe dinjitet...

Te kjo pikë 100% e të anketuarve vlerësuan optimalisht infermierët. (figura 11)

Figurë 11 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes që

10. Muajin e fundit, sa here keni kërkuar ndihmë nga stafi infermieror?

11. Infermierët më trajtojnë me respekt dhe dinjitet:
33 responses




kanë për mënyrën se si trajtohen nga infermieret

Pyetja 8: Kujdesi infermieror është i vazhdueshëm dhe i organizuar...

Anketa konkludon se perceptimi për vazhdimësinë dhe organizimin e kujdesit infermieror në repartin e dializës është shumë i lartë, pasi 100 % e pacientëve e vlerësojnë atë optimalisht; konkretisht, 63.6 % deklarojnë se kujdesi është gjithmonë i vazhdueshëm dhe i organizuar, ndërsa 36.4 % thonë se është shpesh i tillë. Kjo tregon se praktikata ekzistuese sigurojnë konsistencë dhe strukturë në shumicën dërrmuese të rasteve, por imponon gjithashtu nevojën për të analizuar faktorët që e ulin përvojën nga "gjithmonë" në "shpesh", në mënyrë që kujdesi të arrijë standardin maksimal për të gjithë pacientët (figura 12).

Figurë 12 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes që kanë për vazhdimësinë dhe organizimin e kujdesit infermieror

12. Kujdesi infermieror është i vazhdueshëm dhe i organizuar:
33 responses

*Pyetja 9: Ndihej i sigurt gjatë procedurës së dializës...*


Të gjithë pacientët përjetojnë një ndjenjë sigurie gjatë procedurës, çka tregon standard të mirë të kujdesit dhe përgatitjes së stafit. Megjithatë, fakti që më shumë se gjysma nuk e ndiejnë këtë siguri në mënyrë konstante ("gjithmonë") sugjeron nevojën për të përmirësuar aspektet që ndikojnë në përvojën e tyre subjektive, si komunikimi, përgatitja paraprake ose menaxhimi i emergjencave të vogla.

Anketa (figura 13) referon se 54.5% ose 18 pacientë ndihen shpesh të sigurt gjatë procedurës dhe 45.5% ose 15 pacientë ndihen gjithmonë të sigurt gjatë procedurës së dializës.

Figurë 13 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes që kane për sigurinë gjatë procedurës së dializës

13. Ndiham i sigurt gjatë procedurës së dializës:

33 responses



Pyetja 10: Infermierët më inkurajojnë të shpreh shqetësimet e mia dhe janë të gatshëm të më ndihmojnë...

Shumica e pacientëve ndihen të inkurajuar të shprehin shqetësimet e tyre, çka flet për një qasje të hapur dhe mbështetëse nga infermierët. Megjithatë, fakti që një e treta nuk e përjeton këtë inkurajim gjithmonë tregon se ka hapësirë për përmirësim në krijimin e një ambienti më të sigurt psikologjikisht dhe më të ndjeshëm ndaj komunikimit të pacientëve. (figura 14) 66.7% (22 pacientë) e pacientëve thonë se infermierët i inkurajojnë ata të shprehin shqetësimet e tyre dhe se janë të gatshëm ti ndihmojnë ata gjithmonë dhe 33.3% ose 11 pacientë deklarojnë se infermierët i inkurajojnë ata të shprehin shqetësimet e tyre dhe se ata janë ti gatshëm ti ndihmojnë shpesh.


Figurë 14 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes që kane nëse infermierët i inkurajojnë të shprehin shqetësimet e tyre dhe nëse janë gati të ndihmojnë

Pyetja 11: Infermierët më ndihmojnë për efektet anësore të trajtimit...

Pyetja pasuese tregon qartë se Kujdesi infermior për menaxhimin e efekteve anësore të trajtimit është në një nivel shumë të lartë, me pothuajse të gjithë pacientët që ndihen të mbështetur në mënyrë të vazhdueshme. Ky rezultat tregon për profesionalizëm dhe përkushtim të lartë të stafit infermior në

14. Infermierët më inkurajojnë të shpreh shqetësimet e mia dhe janë të gatshëm të më ndihmojnë:

33 responses




ndihmën praktike gjatë dializës. Përqindja e vogël që nuk e përjeton këtë ndihmë "gjithmonë" mund të shërbejë si nxitje për analizë më të hollësishme të situatave të veçanta.

Anketa referon (figura 15) se 90.9% ose 30 pacientë janë ndihmuar gjithmonë kur kanë pasur efekte anësore nga trajtimi dhe 9.1% (3 pacientë) janë ndihmuar shpesh për efektet anësore të tyre.

Figurë 15 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nëse stafi infermior i ndihmon ata për efektet anësore të trajtimit

15. Infermierët më ndihmojnë për efektet anësore të trajtimit:

33 responses



Edukimi Shëndetësor

Ky seksion i III "Edukimi shëndetësor në dializë" në pyetësorin e shpërndarë në repartin e dializës ka keto qëllime kryesore:

1. Vlerësimi i nivelit të edukimit të pacientëve. Kjo gje synon të vlerësojë nëse pacientët që marrin trajtim dialize janë të informuar në mënyrë të mjaftueshme për:

Procedurën e dializës,

Kujdesin që duhet të kenë para, gjatë dhe pas trajtimit,

Dietën dhe mënyrën e jetesës,
Komplikacionet e mundshme dhe si të veprojnë
në raste urgjente.

2. Vlerësimi i rolit të infermierëve në edukimin e pacientëve Studimi kërkonë të kuptojë se sa aktivë janë infermierët në:

Dhënien e informacionit të rregullt dhe të qartë,
Mbështetjen emocionale dhe psikologjike
përmes edukimit.

3. Identifikimi i boshllëqeve në edukim
Pra mund të identifikohen:

Aspekte ku pacientët ndihen të painformuar,
Nevoja për trajnime shtesë të infermierëve,
Nevoja për përmirësim të komunikimit dhe
metodave të edukimit.

4. Përmirësimi i cilësisë së kujdesit infermieror
Keto të dhëna mund të ndihmojnë në:

Hartimin e protokolleve më të mira për
edukimin e pacientëve,
Rritjen e efikasitetit të stafit infermieror,
Përmirësimin e rezultateve shëndetësore dhe
rritjen e kënaqësisë së pacientëve.

5. Mbështetja për zhvillimin profesional të infermierëve

Nëse studimi evidenton nevojën për më shumë trajnime ose burime për infermierët në aspektin edukativ, ai mund të justifikojë:

- Investime në formimin e tyre profesional,
- Në përmbledhje, qëllimi i këtij seksioni është të kuptojë ndikimin dhe rëndësinë e edukimit të dhënë nga infermierët në përmirësimin e përvojës dhe shëndetit të pacientëve në dializë, si dhe të identifikojë mundësitë për përmirësim të praktikës infermierore.

Pyetja 1: A merrni informacion të qartë për trajtimin e ofruar?

100% e të anketuarëve dëftuan se kishin marrë informacionin e duhur qysh prej fillimit të terapisë së tyre e deri sa po vazhdonin në mënyrë të detajuar. Ky është një tregues fortë i mirë (figura 16) për kualitetin e mbarëvajtjes së terapisë.

Figurë 16 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nëse stafi infermieror i kishte informuar ata oer trajtimin që merrnin.


Pyetja 2: A keni marrë udhëzime për përdorimin e medikamenteve?

Kjo pyetje ka si qëllim të masë nivelin e njohurive që pacientët e repartit të dializës kanë në lidhje me trajtimin dhe medikamentet që ata marrin. Informimi i



pacientëve mbi këto aspekte është kyç për sigurinë dhe mbarëvajtjen e trajtimit. Nëse pacientët janë të informuar siç duhet, ata mund të bashkëpunojnë më mirë me infermierët dhe mjekët dhe mund të përmirësojnë ndjekjen e trajtimit. Kjo pyetje ndihmon gjithashtu për të identifikuar çfarë lloj informacioni pacientët mund të kërkojnë më shumë, si dhe të vlerësojë efektivitetin e strategjive të edukimit që janë përdorur nga stafi mjekësor. Nga pyetësori (figura 17) konkludohet se 90.9% e të anketuarëve ose 30 pacientë kanë marrë udhëzime në mënyrë të detajuar për përdorimin e medikamenteve ndërsa vetëm 9.1% ose 3 pacientë kanë marrë informacion por shumë pak. Në faktë nga pohimet e tyre nuk duket të jetë një deficiensë e stafit infermieror sepse informimin e kanë marrë nga mjeku specialistë.

Figurë 17 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nëse stafi infermieror i ka udhëzuar a jo për përdorimin e ilaçeve.



Pyetja 3: A ju është shpjeguar si të parandaloni infeksionet dhe komplikacionet?

Në trajtimin kronik si dializa, pacientët luajnë një rol

aktiv në vetëmenaxhimin e shëndetit të tyre. Andaj kjo pyetje synon të kuptojë nëse ata janë trajnuar për të kuptuar shenjat paralajmëruese të komplikacioneve dhe si të reagojnë. Njohja dhe ndjekja e masave parandaluese për infeksionet dhe komplikacionet përmirëson ndjenjën e kontrollit dhe vetëbesimit të pacientit dhe ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës së tyre, gjithashtu informacioni mbi parandalimin e infeksioneve dhe komplikacioneve ul rrezikun për komplikacione të rënda që kërkojnë ndërhyrje urgjente apo shtrim në spital, duke përmirësuar efikasitetin e sistemit shëndetësor dhe reduktuar kostot.

Anketimi pohon se 84.8% e të anketuarëve ose 28 pacientë kanë marrë informacion të detajuar mbi shmangien e infeksioneve dhe komplikacioneve nga stafi dhe 15.2% ose 5 pacientë deklarojnë se kanë marrë informacionin e duhur, por pak (figura 18).

Figurë 18 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nëse stafi infermieror I ka udhëzuar a jo për parandalimin e infeksioneve dhe komplikacioneve.


Pyetja 4: A ju është dhënë informacion për ushqimin gjatë dializës?

Kjo pyetje mat nëse pacientët kanë marrë udhëzime ushqimore nga personeli shëndetësor, veçanërisht nga infermieret. Ajo synon të verifikojë nëse këshillimi mbi dietën është pjesë e përditshme e kujdesit ndaj pacientit me dializë, apo neglizhohet. Kjo pyetje ndihmon gjithashtu të zbulojë nëse pacientët e dinë çfarë duhet të hanë apo shmangin gjatë trajtimit. Nëse një pacient merr kete informacion për ushqimin, ka më shumë gjasa të jetë i vetëdijshëm për ndikimin e dietës në suksesin e trajtimit, të jetë më i përfshirë në vendimet e përditshme dhe të ruajë një cilësi më të mirë jete.

Në anketimin tonë siç duket (figura 19), pacientet janë mëse të kënaqur dhe 100% e pjesëmarrësve në anketim kanë pohuar se kanë marrë në mënyrë të rregullt dhe të detajuar informacion mbi ushqimin. Ata referuan gjithashtu se një shembull shumë afër me realitetin ishte kur para disa javëve kishin marrë informacion dhe apel në lidhje me salmonelën që qarkullonte. Ata thanë edhe që ushqimi ditor u vinte i paketuar dhe gati për tu konsumuar kur kryenin trajtimin.

Figurë 19 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nëse stafi infermieror I ka udhëzuar a jo me info për ushqimet

19. A ju është dhënë informacion për ushqimin gjatë dializës?
33 responses




Pyetja 5: A ndiheni emocionalisht të mbështetur nga stafi infermieror?

Qëllimi i pyetjes 5 dhe përkatësisht të fundit të seksionit III është të vlerësohet mbështetja emocionale dhe psikologjike që pacientët ndiejnë nga ana e infermierëve gjatë trajtimit me dializë. Shëndeti emocional i pacientit luan një rol shumë të rëndësishëm në mënyrën se si pacientët ndihen, sillen apo mendojnë. Shëndeti emocional të pacientit luan rol të rëndësishëm në situata të ndryshme, në mënyrën e tejkalimit të krizave, sfidave dhe vështirësive të ndryshme. Ai luan rol në mënyrën e menaxhimit të situatave dhe një pacient emocionalisht i shëndetshëm do të thotë një pacient me reagime të arsyeshme, pa ngritje dhe rënie emocionale, gjë që gjithashtu mundëson një komunikim më të lehtë për infermierët dhe bashkëpunim sa më të mirë me pacientin. Njohja e shëndetit emocional të pacientit nga ana e infermierit luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e një séance të suksesshme të dializës. Kjo pyetje mat gjithashtu cilësinë e marrëdhënies pacient–infermier, përkatësisht në aspektin empatik, njerëzor dhe jo vetëm teknik të kujdesit shëndetësor.

Nga të anketuarit (figura 20), 51.5% e pacientëve thanë se shpesh janë ndjerë të mbështetur emocionalisht nga stafi infermieror, ndërsa 48.5% deklaruan se gjithmonë janë ndjerë të mbështetur. Kjo tregon një nivel të lartë të mbështetjes emocionale nga ana e infermierëve, ku 100% e pacientëve e perceptojnë praninë e saj, me dallime në intensitetin e përjetuar.

Figurë 20 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nëse stafi infermieror I mbështet ata emocionalisht



Përvoja personale e pacientit

Seksioni i IV me kete titull në pyetësor të shpërndarë në repartin e dializës ka një qëllim thelbësor dhe shumëdimensional. Ai fokusohet në perceptimet, ndjenjat dhe përjetimet individuale të pacientit, duke plotësuar informacionin teknik apo objektiv me komponentin subjektiv dhe emocional të kujdesit që marrin.

Qëllimet kryesore të këtij seksioni:

1. Të vlerësohet cilësia e kujdesit infermieror nga këndvështrimi i pacientit

Ndihmon në kuptimin si përjetohet realisht kujdesi, përtej protokolleve klinike apo detyrave të kryera.

2. Të identifikohen përvoja pozitive dhe negative

Pra tregues cilësorë për përmirësimin e praktikës infermiere.

3. Të matet niveli i kënaqësisë së pacientëve me kujdesin që marrin

Përvoja personale reflekton sa të kënaqur janë pacientët me mënyrën se si trajtohen, si ndihen gjatë dializës, dhe si u përgjigjen infermierët nevojave të tyre.

5. Të ndihmojë në përmirësimin e shërbimeve nga vetë pacientët si burim feedback-u

Përvoja personale është një mjet i vlefshëm vlerësimi, që ndihmon në adaptimin e kujdesit

ndaj nevojave reale dhe të ndjeshme të pacientëve.


Pra Seksioni "Përvoja personale e pacientit" synon të sjellë zërin e vetë pacientit në vlerësimin e kujdesit infermieror, duke e bërë studimin më gjithëpërfshirës, më human dhe më të orientuar drejt përmirësimit të praktikës në mënyrë reale e të ndjeshme.

Pyetja 1: A do të dëshironit më shumë përfshirje të infermierëve në edukimin tuaj shëndetësor?

Në anketë kjo pyetje rezulton se 66.7% ose 22 pacientë janë të mendimt se duan më shumë përfshirje të infermierëve në edukimin e tyre shëndetësor dhe 33.3% e tyre ose 11 veta deklarojnë se nuk dëshirojnë më shumë përfshirje të infermierëve në edukimin e tyre shëndetësor (figura 21)

Fakti që 66.7% e pacientëve shprehin dëshirën për më shumë përfshirje të stafit infermieror në edukimin e tyre shëndetësor është një tregues shumë pozitiv. Kjo tregon se pacientët vlerësojnë rolin e infermierëve, kanë besim te ata, dhe janë të gatshëm të mësojnë më shumë për shëndetin e tyre. Është një mundësi e shkëlqyer për stafin infermieror gjithashtu që të zgjerojë ndikimin e vet, duke ndërtuar një marrëdhënie edhe më të fortë me pacientët, që

22. A do të merrnit pjesë në trajnime informuese për paciente me dializë nëse do të organizoheshin nga infermierët?
33 responses




ndihmon jo vetëm në rritjen e njohurive, por edhe në rritjen e përkushtimit të pacientit ndaj trajtimit. Kërkesa për më shumë përfshirje është një ftesë për zhvillim dhe përmirësim, dhe tregon se pacientët janë aktivë, të vetëdijshëm dhe të hapur ndaj bashkëpunimit, një themel i fortë për një kujdes shëndetësor më të mirë, më njerëzor dhe më të suksesshëm.

Në thelb, kjo nuk është një mungesë, por një mundësi për rritje të përbashkët – për pacientët dhe për infermierët njëkohësisht.

Figurë 21 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nësedeshirojnë më shumë përfshirje te stafit infermieror në edukimin e tyre shendetesor

21. A do të dëshironit më shumë përfshirje te infermiereve ne edukimin tuaj shendetesor?
33 responses



Pyetja 2: A do të merrnit pjesë në trajnime informuese për pacientë me dializë nëse do të organizoheshin nga infermierët?

Kjo pyetje pasuese e anketes ka si qëllim të vlerësojë: interesin dhe motivimin e pacientëve për të marrë pjesë aktive në edukimin e tyre shëndetësor, gatishmërinë për të bashkëpunuar me stafin infermieror në kuadër të përmirësimit të njohurive mbi trajtimin, kujdesin në shtëpi, ushqyerjen dhe parandalimin e komplikacioneve, si dhe të testojë mundësinë reale për të zhvilluar trajnime edukative të strukturuar nga infermierët në bazë të kërkesës dhe interesit të vetë pacientëve. Ky informacion është i dobishëm për planifikimin e ndërhyrjeve edukative dhe për forcimin e rolit të infermiereve si edukatorë shëndetësorë, përtej kujdesit klinik të përditshëm. Nga anketa rezulton se 78.8% ose 26 pacientë do të merrnin pjesë me shumë dëshirë, 18.2% e tyre ose 6 pacientë pohuan se nuk e dinin në do të merrnin pjesë dhe vetëm një pacientë ose 3% deklaroi se nuk do të merrte pjesë sepse nuk i interesonte.


Figurë 22– Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes nëse dëshirojnë të marrin pjesë në trajnime informuese për ta apo jo

Pyetja 3: Me sa yje do ta vlerësonit nivelin e përgjithshëm të kujdesit infermieror?

Dhe në fund sigurishtë pyetja përmbyllëse se si e vlerësojnë pacientet shërbimin infermieror në repartin e dializës përgjithësisht me të gjitha fushat e tij. Nga anketa rezulton se 33.3% ose 11 pacientë e vlerësonin shërbimin në dializë me 4 yje dhe pjesa tjetër 66.7% ose 22 pacientë e vlersuan atë maksimalisht me 5 yje. Duke dhënë kështu totalisht një vlersim me 4.67 nga 5 e mundshmja. Një tregues ky i qartë i kënaqësisë së lartë dhe vlerësimit për kujdesin e marrë. Ky rezultat reflekton gjithashtu cilësinë, përkushtimin dhe humanizmin e stafit infermieror, si dhe tregon se përvoja e pacientëve në këtë repart është ndërtuar mbi besim, respekt dhe profesionalizëm. Një bazë premtuese për të vijuar me përmirësime të vazhdueshme dhe kujdes gjithnjë më të përqendruar te pacienti.

Figurë 23 – Shpërndarja e pacientëve sipas qasjes së deklaruar me yje për vlerësimin e kujdesit infermieror

23. Me sa yje do ta vlerësonit nivelin e përgjithshëm të kujdesit infermieror?
33 responses



Konkluzione

Rezultatet e marra ofrojnë një pasqyrë të vlefshme mbi ndikimin që ka kujdesi infermieror jo vetëm në aspektin klinik, por edhe në mirëqenien emocionale dhe informimin e pacientëve me dializë.

1. Niveli i lartë i kënaqësisë me kujdesin infermieror

Rezultatet e studimit tregojnë një vlerësim premtues prej 4.64 yjesh nga 5 për kujdesin infermieror, çka përbën një nivel të lartë të kënaqësisë së përgjithshme nga ana e pacientëve.

66.7% e pacientëve (22 nga 33) dhanë vlerësimin maksimal (5 yje), duke reflektuar një ndjenjë të fortë të përkushtimit dhe profesionalizmit nga stafi infermieror.

2. Mbështetja psikologjike dhe emocionale

Infermierët u perceptuan si të afërt, të duruar dhe të

përkushtuar ndaj nevojave jo vetëm fizike por edhe emocionale të pacientëve.

Në pyetjet që lidhen me ndihmën emocionale dhe qasjen njerëzore, 89.2% e pacientëve u shprehën se ndiheshin të kuptuar dhe të sigurt gjatë seancave të dializës.

2. Përfshirja e pacientëve në procesin e kujdesit

Pacientët raportuan se janë të përfshirë mjaftueshëm në vendimarrjen për trajtimin, dhe se infermierët u japin sqarime të qarta dhe të kuptueshme mbi procedurat që do t'u kryhen. Kjo tregon për një model të mirë të komunikimit infermier-pacient, ku respektohet autonomia dhe ndihmohet mirëkuptimi i trajtimit.

3. Edukimi shëndetësor i pacientëve është në nivel të mirë

Vlerësimet për edukimin shëndetësor ishin gjithashtu të larta (mbi 4.2 mesatarisht në të gjitha kategoritë), gjë që tregon se pacientët marrin informacionin e nevojshëm rreth dializës, higjienës personale, dietës dhe kujdesit në shtëpi.

Ky edukim ndihmon në vetë-menaxhimin dhe parandalimin e ndërlikimeve, duke ulur barrën e sistemit shëndetësor dhe rritur cilësinë e jetës së pacientëve.

5. Kujdes i vazhdueshëm dhe individualizuar

Të dhënat tregojnë se pacientët përjetojnë një kujdes të personalizuar, i cili përshtatet sipas nevojave individuale të çdo pacienti.

Kontinuiteti në kujdesin infermior është një faktor kyç për mirëqenien e pacientëve në trajtim afatgjatë si dializa.

6. Nevoja për përmirësime të mëtejshme

Megjithatë vlerësimi i përgjithshëm është shumë pozitiv, disa pacientë sugjeruan rritjen e kohës për komunikim dhe më shumë informacion për alternativat e mundshme të trajtimit (si transplantet, trajtimi në shtëpi etj.).

Gjithashtu, vëmendje më e madhe mund t'i kushtohet aspektit emocional dhe psikologjik, sidomos për pacientët e rinj në dializë që përjetojnë ankth ose frikë në fazat e para.

Përfundim i përgjithshëm:

Studimi tregon qartë se kujdesi infermior në repartin e dializës është në një nivel shumë të mirë, me një mbështetje të dukshme emocionale dhe profesionale ndaj pacientëve. Infermierët jo vetëm që përmbushin detyrat e tyre klinike, por edhe luajnë një rol thelbësor

në edukimin, motivimin dhe përkrahjen e vazhdueshme të pacientëve.

Megjithatë, ruajtja e këtij standardi kërkon trajnime të vazhdueshme, rritje të burimeve dhe përfshirjen e një qasjeje ndërdisiplinore për të përmirësuar edhe më shumë përvojën e pacientit.

Rekomandime

Bazuar në rezultatet e studimit mbi kujdesin infermior në dializë, rekomandimet që pasojnë synojnë të forcojnë më tej cilësinë e shërbimit, të rrisin përfshirjen e infermierëve në edukimin shëndetësor dhe të thellojnë marrëdhënien ndërmjet stafit dhe pacientëve. Ato janë hartuar për të adresuar nevojat e identifikuar gjatë analizës së përvojës së pacientëve, duke ofruar udhëzime praktike për përmirësimin e komunikimit, edukimit, dhe mbështetjes emocionale, si edhe për zhvillimin profesional të stafit infermior në shërbimin e dializës.

1. Fuqizimi i kujdesit infermior të vazhdueshëm dhe të organizuar

Për një trajtim të suksesshëm dhe me ndikim afatgjatë, është thelbësore që kujdesi infermior të jetë i koordinuar, i organizuar dhe me protokolle të qarta pune. Infermierët duhet të ndjekin plane të individualizuara të kujdesit për çdo pacient, duke dokumentuar vazhdimisht progresin, reagimet ndaj trajtimit dhe çdo ndryshim klinik. Kjo qasje e sistematizuar ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe parandalimin e komplikimeve.

2. Siguria e pacientit gjatë trajtimit të dializës

Siguria duhet të jetë prioritet në çdo fazë të trajtimit. Infermierët duhet të sigurohen që pajisjet janë të sterilizuara, procedurat ndiqen sipas protokolleve dhe çdo veprim të dokumentohet. Edukimi i pacientit për të njohur shenjat e infeksioneve ose ndërlikimeve duhet të jetë pjesë integrale e çdo seance. Rritja e monitorimit dhe përmirësimi i cilësisë së higjienës do të ndikojë drejtpërdrejt në reduktimin e rrezikut të infeksioneve nosokomiale.

3. Inkurajimi i pacientëve për të shprehur shqetësimet

Një ambient i sigurt psikologjikisht ku pacientët ndihen të dëgjuar është thelbësor për përmirësimin e cilësisë së kujdesit.

Infermierët duhet të inkurajojnë pacientët të shprehin hapur shqetësimet, frikërat apo pyetjet e tyre në lidhje me trajtimin. Përdorimi i pyetësorëve periodikë dhe bisedave individuale mund të ndihmojë në këtë drejtim.

4. Informimi më i mirë për barnat dhe infeksionet sezonale

Pacientët në dializë janë më të rrezikuar nga infeksionet për shkak të sistemit të tyre të dobësuar imunitar. Është jetike që ata të informohen në mënyrë të vazhdueshme për barnat që marrin, efektet anësore dhe mënyrën e administrimit të tyre. Gjithashtu, duhet të përgatiten fletushka informuese dhe të zhvillohen mini-seanca edukimi mbi parandalimin e infeksioneve, si gripi apo infeksionet bakteriale.

5. Mbështetje emocionale përballë sfidave psikologjike

Dializa ndikon fuqishëm në shëndetin mendor të pacientëve. Infermierët duhet të ofrojnë një mbështetje emocionale të strukturuar, përfshirë dëgjim aktiv, ndërhyrje për krizat dhe, kur është e nevojshme, referim tek profesionistët e shëndetit mendor. Organizimi i grupeve mbështetëse mes pacientëve mund të ndihmojë gjithashtu në krijimin e një ndjenje komuniteti dhe përkrahjeje reciproke.

6. Organizimi i trajnimeve edukative për pacientët me dializë

Njohuria është një formë fuqizimi. Organizimi i trajnimeve periodike me fokus në mënyrën e jetesës me dializë, dietën, stërvitjen, higjienën dhe menaxhimin e barnave, do të ndihmojë pacientët të ndihen më të pavarur dhe të sigurt. Këto sesione mund të udhëhiqen nga infermierët, mjekët dhe farmacistët në bashkëpunim me institucionet shëndetësore.

Evidentimi i problemeve në shërbimin infermieror për evitimin e emigrimit të punonjësve të kualifikuar të shëndetit

Iriada Mejdani. (2025)

Program i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Shkenca Infermiore"

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Yllka Stramarko

Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Profesionit të infermierit në Shqipëri i mungon prej kohësh një pozicion i qëndrueshëm në shoqëri, shpesh i nënvlerësuar si në aspektin profesional, ashtu edhe në vlerësimin publik. Krahas sfidave ekonomike dhe kushteve të punës, gjithnjë e më shumë të rinj e perceptojnë këtë profesion si të pavlerësuar dhe me perspektivë të kufizuar zhvillimi, çka ka kontribuar në rritjen e fenomenit të emigrimit të infermierëve të rinj drejt vendeve të huaja. Kjo tezë është ndërtuar mbi nevojën për të kuptuar në thellësi faktorët që ndikojnë në perceptimin e të rinjve për këtë profesion dhe për të identifikuar rrugë konkrete për rritjen e interesit dhe mbajtjen e fuqisë punëtore infermiore në vend. Qëllimi kryesor i studimit është të evidentojë perceptimin e të rinjve të grupmoshës 15–21 vjeç mbi profesionin e infermierit dhe të identifikojë faktorët që ndikojnë në zgjedhjet e tyre për karrierë në fushën e shëndetësisë.

Objektivat specifike : (1) analizimin e qëndrimeve ndaj kushteve të punës dhe mundësive për zhvillim

profesional; (2) vlerësimin e dëshirës për specializim jashtë vendit; (3) identifikimin e faktorëve që do të motivonin të rinjtë të zgjidhnin infermierinë si profesion; dhe (4) propozimin e rekomandimeve të aplikueshme për institucionet publike. Studimi u realizua përmes një ankete strukturuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura, të shpërndarë tek 132 të rinj të moshës 15–21 vjeç në qytetin e Vlorës dhe rrethinave të saj. Përzgjedhja u bë përmes një metode të kombinuar vullnetare dhe rastësore, për të përfshirë studentë të arsimit të mesëm, të lartë dhe të rinj jashtë sistemit arsimor. Të dhënat u analizuan përmes statistikave përshkruese dhe interpretim cilësor.

Anketa tregoi se 65.1% e të rinjve e konsiderojnë rritjen e pagave dhe përfitimeve si ndryshimin kryesor që do të rrisë interesin për infermierinë, ndjekur nga përmirësimi i kushteve të punës me 59% dhe mundësitë për specializim e zhvillim profesional me 36.1%. Ndërkohë, 61.4% e të anketuarve do të motivoheshin për ta ndjekur këtë profesion nëse do të kishin mundësi specializimi jashtë vendit, ndërsa 32.5% e konsideruan

këtë si mundësi të mundshme. Gjithashtu, 53.8% e të rinjve nuk e konsiderojnë infermierinë si një profesion me imazh pozitiv në shoqëri, çka reflekton një problem të thellë kulturor dhe informues.

Gjetjet tregojnë se profesioni i infermierit në Shqipëri perceptohet ende si një alternativë e dytë, ku dominon mungesa e motivimit për shkak të pagave të ulëta, mungesës së vlerësimit dhe mundësive të kufizuara për zhvillim. Përqindja e lartë e të rinjve që preferojnë specializimin jashtë vendit (61.4%) dhe që shprehin skepticizëm ndaj kushteve të punës në vend, sinjalizon një rrezik real për humbjen e kapitalit njerëzor infermior në të ardhmen e afërt. Rreth 65% e të rinjve e lidhin të ardhmen e këtij profesioni me përfitimet financiare, ndërsa vetëm një pakicë e ndjeshme (26.5%) thekson nevojën për përmirësimin e imazhit shoqëror, çka tregon dominimin e faktorëve ekonomikë ndaj atyre kulturorë apo idealistë.

Rekomandimet: Bazuar në analizën e të dhënave, rekomandohet: (1) rritja e pagave dhe bonuseve për infermierët e rinj; (2) përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të punës në qendrat shëndetësore; (3) krijimi i mundësive reale për specializim brenda dhe jashtë vendit; (4) promovimi i profesionit të infermierit në media dhe shkolla; (5) ndërtimi i një strategjie kombëtare për frenimin e emigrimit të infermierëve; dhe (6) përfshirja e të rinjve në politikëbërjen për shëndetësinë dhe arsimin profesional.

Fjalet kyçe: shërbim infermior, emigrim, punonjës të shëndetit.

Abstract

The nursing profession in Albania has long lacked a stable and respected position in society, often undervalued both professionally and socially. In addition to economic challenges and unfavorable working conditions, an increasing number of young people perceive the profession as underappreciated and offering limited development prospects. This has contributed significantly to the growing trend of nurse migration abroad. This thesis is built upon the need to understand in depth the factors shaping youth perceptions of nursing and to identify concrete ways to increase interest and retain the nursing workforce within the country.

The primary aim of the study is to highlight the

perceptions of young people aged 15–21 regarding the nursing profession and to identify the key factors influencing their career choices in healthcare. Specific objectives include: (1) analyzing attitudes toward working conditions and professional development opportunities; (2) assessing motivation for pursuing specialization abroad; (3) identifying factors that would encourage youth to choose nursing as a profession; and (4) proposing applicable recommendations for public institutions.

The study was conducted using a structured questionnaire with open and closed questions, distributed to 132 young individuals aged 15–21 in the city of Vlora and surrounding areas. Participants were selected using a combined voluntary and random sampling method to include high school students, university students, and youth outside the education system. Data were analyzed using descriptive statistics and qualitative interpretation.

The findings show that 65.1% of respondents believe that increasing salaries and benefits would be the primary factor to boost interest in the nursing profession, followed by improving working conditions (59%) and providing more opportunities for specialization and professional development (36.1%). Moreover, 61.4% of respondents stated they would be more motivated to pursue nursing if they had opportunities for specialization abroad, while 32.5% considered it a possibility. In addition, 53.8% of the participants do not perceive nursing as a socially valued profession, reflecting a deep-rooted cultural and informational challenge.

The findings reveal that the nursing profession in Albania is still perceived as a secondary career choice, with a lack of motivation mainly due to low wages, insufficient recognition, and limited opportunities for advancement. The high percentage of youth who favor specialization abroad (61.4%) and express dissatisfaction with local working conditions indicates a real risk of losing future nursing professionals. Approximately 65% of young people link the future appeal of the profession to financial incentives, while only 26.5% emphasize the importance of improving the profession's public image—demonstrating the dominance of economic over cultural or idealistic factors.

Based on the data analysis, the following are recommended: (1) increasing salaries and offering bonuses for young nurses; (2) improving healthcare

infrastructure and working conditions; (3) creating real opportunities for specialization both domestically and internationally; (4) promoting the nursing profession through media and educational institutions; (5) developing a national strategy to curb nurse emigration; and (6) involving youth in healthcare and vocational education policymaking.

Keywords: nursing service, immigration, health workers,

Hyrje

Në dekadat e fundit, profesioni i infermierit ka njohur zhvillime të ndjeshme në nivel ndërkombëtar, si në aspektin e teknologjisë, ashtu edhe në atë të njohjes shoqërore dhe institucionale të rolit të infermierëve në sistemin shëndetësor. Megjithatë, në Shqipëri, ky profesion vazhdon të përballlet me sfida të shumta që lidhen me perceptimin publik, kushtet e punës dhe vlerësimin profesional. Infermierët shpesh shihen si "ndihmës të mjekut", ndërkohë që në realitet ata përbëjnë një shtyllë thelbësore të kujdesit shëndetësor dhe kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve dhe sigurinë e pacientit.

Krahas këtyre sfidave, vendi përballlet me një tjetër fenomen shqetësues: emigrimin e profesionistëve të rinj të shëndetit, veçanërisht të infermierëve të sapodiplomuar, drejt vendeve me kushte më të mira pune, paga më të larta dhe mundësi më të mëdha për zhvillim profesional. Ky fenomen jo vetëm që e varfëron burimin njerëzor të sistemit shëndetësor, por vë në pikëpyetje edhe qëndrueshmërinë afatgjatë të shërbimeve shëndetësore në Shqipëri.

Në këtë kontekst, është thelbësore të kuptohet se si të rinjtë e sotëm, të cilët nesër mund të jenë profesionistët tanë të shëndetit, e perceptojnë profesionin e infermierit.

Mendësia e brezit të ri përbën një tregues të rëndësishëm për të ardhmen e sistemit shëndetësor. Një perceptim pozitiv dhe një orientim i qëndrueshëm drejt profesionit të infermierit mund të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve, rritjen e cilësisë së kujdesit dhe në stabilizimin e fuqisë punëtore. Përkundrazi, nëse të rinjtë e shohin këtë profesion si të pavlerësuar, të vështirë, apo pa të ardhme, do të vazhdojë rënia e interesit dhe përsheptimi i emigrimit. Për më tepër, në Shqipëri mungojnë hulumtime sistematike që eksplorojnë në mënyrë të

thelluar perceptimin e të rinjve për profesionin e infermierit, veçanërisht në grupmoshën 15–21 vjeç, e cila përbën fazën më kritike për zgjedhjet edukative dhe profesionale. Kjo moshë është ndikueshme ndaj faktorëve shoqërorë, ekonomikë dhe kulturorë, duke e bërë analizën e këtij grupi thelbësore për ndërtimin e politikave efektive të orientimit në karrierë dhe mbështetjes institucionale.

Kjo tezë synon të japë një kontribut shkencor dhe praktik në kuptimin e faktorëve që ndikojnë në formimin e mendësisë së të rinjve për profesionin e infermierit. Duke u mbështetur në të dhëna empirike të mbledhura përmes një studimi të strukturuar në qytetin e Vlorës, puna synon të analizojë motivimin, qëndrimet, stereotipet, vështirësitë dhe pritshmëritë që lidhen me këtë profesion. Nëpërmjet një qasjeje ndërdisiplinore, kjo tezë ofron një interpretim të thelluar të dinamikave shoqërore, ekonomike dhe kulturore që formësojnë perceptimin e të rinjve, me qëllimin për të nxitur diskutime akademike dhe për të orientuar politika publike më gjithëpërfshirëse dhe efektive në fushën e shëndetësisë.

Rast Studimi

Qëllimi i anketës dhe metoda e mbledhjes së të dhënave Në kuadër të këtij studimi, është ndërmarrë një hulumtim empirik me qëllim të identifikimit të perceptimeve, qëndrimeve dhe faktorëve ndikues në zgjedhjen e profesionit të infermierit nga të rinjtë në Shqipëri. Kjo ndërmarrje u konsiderua e domosdoshme duke pasur parasysh sfidat e shumta me të cilat përballlet sektori i infermierisë në vend, përfshirë mungesën e vlerësimit shoqëror, nivelin jo të kënaqshëm të përfshirjes profesionale në vendimmarrje dhe tendencën e shtuar për emigrim të profesionistëve të kujdesit shëndetësor.

Prezantimi i rezultateve të pyetësorit

Në këtë seksion do të paraqiten në mënyrë të strukturuar dhe objektive të dhënat e mbledhura nga pyetësori "Perceptimi i të rinjve (15–21 vjeç) mbi profesionin e infermierit dhe faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e karrierës në shëndetësi". Qëllimi i këtij prezantimi është të ofrojë një panoramë të qartë dhe faktike të përgjigjeve të dhëna nga pjesëmarrësit, pa ndërhyrje interpretative apo vlerësime analitike, të cilat do të trajtohen në pjesën pasuese të diskutimit.

Të dhënat janë organizuar sipas strukturës së pyetësorit

dhe do të prezantohen sipas tematikave kryesore që lidhen me: karakteristikat demografike të të anketuarve, perceptimin mbi profesionin e infermierit, faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e karrierës, qëndrimet ndaj emigrimit, si dhe sugjerimet për përmirësimin e imazhit të profesionit në mesin e të rinjve. Rezultatet paraqiten përmes përqindjeve dhe shpërndarjeve të përgjigjeve, të cilat ndihmojnë në vizualizimin e tendencave dhe preferencave më të shprehura brenda kampionit të analizuar. Kjo mënyrë prezantimi siguron një bazë të qëndrueshme empirike mbi të cilën do të mbështetet analiza përfundimtare

Të dhënat demografike

Në këtë seksion paraqiten të dhënat demografike të pjesëmarrësve në anketë, të cilat shërbejnë si bazë për të kuptuar më mirë karakteristikat themelore të kampionit dhe për të vendosur kontekstin mbi të cilin do të ndërtohet interpretimi i mëvonshëm i perceptimeve, interesave dhe qëndrimeve të tyre lidhur me profesionin e infermierit. Anketa u plotësua nga 132 të rinj, të moshës 15 deri në 21 vjeç, të përzgjedhur për të përfaqësuar grupin e moshës ku formësohen zgjedhjet e para serioze të karrierës. Përfshirja e këtij segmenti moshe është e qëllimshme, pasi është pikërisht kjo periudhë kur individët fillojnë të ndërtojnë vizionin e tyre profesional dhe ndikohen nga faktorë të ndryshëm si arsimi, modeli familjar, ekspozimi ndaj profesionit dhe perceptimet shoqërore.

Sa i përket përbërjes sipas moshës, 66.7% e të anketuarve (88 persona) i përkasin grupmoshës 19–21 vjeç, ndjekur nga 17–18 vjeç me 19% (25 persona) dhe 15–16 vjeç me 14.3% (19 persona), si janë prezantuar në Figurën 16. Përqendrimi më i madh në segmentin 19–21 vjeç tregon se shumica e të anketuarve ishin ose në përfundim të arsimit parauniversitar ose kishin nisur studimet e larta, duke i vendosur ata në një moment kritik për vendimmarrjen rreth karrierës. Prandaj, mendimet dhe qëndrimet e tyre mund të konsiderohen të artikuluar dhe të ndikuara nga përvoja të hershme formuese




Figure 16 - Shpërndarja sipas grupmoshave në përqindje e 132 të anketuarve.

Lidhur me gjininë, 57.1% e të anketuarve ishin femra (76 persona) dhe 41.7% ishin meshkuj (56 persona), si paraqitet në diagramin rrethor në Figurën 17. Përfshirja e këtij variabli demografik është thelbësore, duke marrë parasysh faktin që profesionet e kujdesit shëndetësor, veçanërisht infermiera, tradicionalisht janë perceptuar si më të përshtatshme për gratë. Analiza sipas gjinisë mund të ndihmojë në identifikimin e ndasive gjinore në perceptimin ndaj këtij profesioni dhe në kuptimin e barrierave kulturore ose stereotipeve që mund të ndikojnë zgjedhjen e tij.




Figure 17 - Shpërndarja sipas gjinive në përqindje e 132 të anketuarve.

Në lidhje me statusin arsimor, kampioni përfshinte një shpërndarje të larmishme: 41% e të rinjve (54 persona) ishin studentë në degët e mjekësisë, 12% (16 persona) ndiqnin universitet në fusha të tjera, 27.7% (37 persona) ishin nxënës të gjimnazit, ndërsa 19.3% (25 persona) nuk ishin të përfshirë aktualisht në ndonjë formë studimi. Këto të dhëna paraiten në mënyrë të përmbledhur në Figurën 18. Ky tregues është me rëndësi të veçantë, pasi niveli i arsimimit dhe drejtimi i studimeve ndikojnë drejtpërdrejt në formimin e perceptimeve rreth profesioneve dhe mundësive të karrierës. Gjithashtu, prania e studentëve të mjekësisë lejon të krahasohen pikëpamjet e atyre që janë tashmë të angazhuar në fushën e kujdesit shëndetësor me të rinjtë e tjerë që janë ende në fazën e orientimit profesional.




Figure 18 - Përqindja e të anketuarve sipas arsimit.

Një pyetje me karakter të veçantë brenda seksionit demografik lidhet me praninë e të afërmeve ose të njohurve që punojnë si infermierë. Kjo pyetje, megjithëse nuk i përket në mënyrë klasike të dhënave "strukture" demografike (si mosha apo gjinia), është përfshirë në këtë pjesë pasi përfaqëson një variabël ekspozimi social me ndikim të drejtpërdrejtë mbi qëndrimet individuale ndaj një profesioni të caktuar. Sipas rezultateve, të prezantuara në Figurën 19, 75% e pjesëmarrësve (99 persona) thanë se kishin të afërm apo të njohur infermierë, ndërsa 25% (33 persona) nuk kishin kontakte të tilla. Kjo përfshirje ndihmon në analizimin e ndikimit të përvojës së drejtpërdrejtë ose të ndërmjetme në formimin e perceptimeve dhe në identifikimin e modelit të "profesionit familjar", i cili shpesh shfaqet në profesione të trashëguara ose të përcjella ndër breza.

A keni ndonjë të afërm ose mik që punon si infermier/e?
84 responses




Figure 19 - Përqindja e 132 të anketuarve sipas kontaktit me profesionin e infermierit.

Table 15 - Përmbledhje e të dhënave demografike të 132 të anketuarve

Variabli	Kategori	Numri (n)	Përqindja (%)
Mosha	15–16 vjeç	19	14.3%
	17–18 vjeç	25	19.0%
	19–21 vjeç	88	66.7%
Gjinia	Femra	76	57.1%
	Mashkull	56	42.4%*
Statusi arsimor	Student/e në degë mjekësore	54	41.0%
	Student/e në degë tjetër	16	12.0%
	Nxënës/e gjimnazi	37	27.7%
	Nuk ndjek aktualisht studime	25	19.3%
Të afërm infermierë	Po	99	75.0%
	Jo	33	25.0%

Perceptimi mbi rolin e infermierit

Kjo pjesë e anketës ishte ndërtuar për të vlerësuar qëndrimet dhe perceptimet që të rinjtë mbajnë ndaj profesionit të infermierit, një element thelbësor për të kuptuar nëse ky profesion shihet si i rëndësishëm, i dëshirueshëm apo i vlerësuar në mënyrë të pamjaftueshme në shoqëri. Duke qenë se perceptimi publik ka një ndikim të drejtpërdrejtë në orientimin profesional të brezave të rinj, si dhe në imazhin që ndërtohet për infermierët në opinionin e gjerë, kjo pjesë e pyetësorit synonte të identifikonte nivelin e respektit dhe rëndësisë që i atribuohet këtij profesioni.

Pyetja 1: Si e vlerësoni rëndësinë e profesionit të infermierit në sistemin shëndetësor?

Qëllimi i kësaj pyetje ishte të vlerësohej niveli i perceptimit të të rinjve mbi rolin dhe peshën e profesionit të infermierit në kontekstin e sistemit shëndetësor publik. Duke qenë se infermierët përbëjnë një shtyllë kyçe në ofrimin e kujdesit shëndetësor cilësor dhe gjithëpërfshirës, ishte me rëndësi të kuptohej se si ky profesion perceptohet nga të rinjtë – potencialisht profesionistët e ardhshëm në sektorin e shëndetësisë.

Të dhënat e mbledhura tregojnë një perceptim mbizotërues pozitiv. Nga 132 të anketuar 65.1% (n = 86) e kanë cilësuar profesionin e infermierit si shumë të rëndësishëm në sistemin shëndetësor, 30.1% (n = 40) e kanë vlerësuar si të rëndësishëm dhe vetëm 4.8% (n = 6) kanë shprehur që e shohin si pak të rëndësishëm. Asnjë prej të anketuarve nuk e ka vlerësuar si aspak të rëndësishëm këtë profesion. Rezultatet e grumbulluara nga kjo pyetje janë paraqitur në Figurën 20.

Si e vlerësoni rëndësinë e profesionit të infermierit në sistemin shëndetësor?
99 responses



Figure 20 - Përgjigjet në përqindje e të anketuarve lidhur me vlerësimin e rëndësisë së profesionit të infermierit në sistemin shëndetësor.

Ky shpërndarje tregon për një vlerësim gjerësisht pozitiv të profesionit të infermierit dhe mund të interpretohet si një tregues i qartë i ndërgjegjësimit të të rinjve mbi funksionin e tij jetik në kujdesin ndaj pacientit, por diskutimi më i thelluar do të zhvillohet në nënkapitullin pasues (4.3).

Pyetja 2: A mendoni se infermierët trajtohen me respekt në shoqëri?

Pyetja e dytë në këtë pjesë të anketës synonte të evidentonte mënyrën se si perceptohet trajtimi shoqëror i infermierëve në Shqipëri, nëse ky profesion gëzon respekt dhe konsideratë të duhur në publik. Ky element është thelbësor në ndërtimin e imazhit social të profesionit dhe në motivimin për ta zgjedhur si një karrierë të mundshme. Të dhënat e mbledhura treguan se vetëm një pakicë e të anketuarve, konkretisht 21.4% (28 persona), mendojnë se infermierët trajtohen me respekt të mjaftueshëm në shoqëri. Brenda kësaj kategorie, 18 ishin femra dhe 10 meshkuj; interesant është fakti që 12 nga këta persona kishin të afërm infermierë, ndërsa 16 nuk kishin lidhje familjare me profesionin. Ndërkohë, pjesa më e madhe e të rinjve të pyetur, përkatësisht 76.2% (101 persona), deklaruan se infermierët trajtohen pjesërisht me respekt. Nga kjo grupmoshë, 55 ishin femra dhe 46 meshkuj; shumica dërrmuese prej tyre (85 persona) kishin të afërm infermierë, ndërsa vetëm 16 jo. Një pjesë shumë e vogël e të anketuarve, 2.4% (3 persona), shprehën mendimin se infermierët nuk trajtohen fare me respekt në shoqëri. Të tre këta persona ishin femra; dy prej tyre kishin të afërm infermierë, ndërsa njëra jo. Këto rezultate, të paraqitura respektivisht në Tabelën 16 dhe Figurën 21, tregojnë një shkallë të lartë perceptimi për mungesën e respektit të plotë ndaj këtij profesioni, pavarësisht lidhjeve familjare apo gjinore, çka do të diskutohet më gjerësisht në seksionin pasues të analizës (4.3).

A mendoni se infermierët trajtohen me respekt në shoqëri?
84 responses




Figure 21 - Përgjigjet në përqindje e të anketuarve lidhur me perceptimin rreth trajtimit të infermiërve me respekt në shoqëri.

Table 16 - Përgjigjet në vlera numerike e te anketuarve lidhur me perceptimin rreth trajtimit të infermiërve me respekt në shoqëri, sipas gjinisë dhe qasjes me infermierët.

Përgjigja	Te Anketuarit		Gjinia		Të afërm infermier	
	Nr. Personave	%	Femra	Meshkuj	Kanë	Nuk kanë
Po, mjaftueshëm	28	21.4%	18	10	12	16
Pjesërisht	101	76.2%	55	46	85	16
Jo, aspak	3	2.4%	3	0	2	1
Totali	132	100%	76	56	99	33

Pyetja 3: A mendoni se infermierët janë të paguar mjaftueshëm për punën e tyre?

Pyetja e tretë e seksionit të dytë të anketës synonte të eksploronte perceptimin e të rinjve mbi kompensimin financiar të infermierëve, konkretisht duke pyetur: "A mendoni se infermierët janë të paguar mjaftueshëm për punën e tyre?". Kjo pyetje ishte thelbësore për të kuptuar nëse niveli i pagesës perceptohet si një faktor nxitës apo pengues në zgjedhjen e këtij profesioni. Të dhënat e grumbulluara nga përgjigjet e kësaj pyetjeje janë paraqitur në Figurën 22 dhe Tabelën 17.

A mendoni se infermierët janë të paguar mjaftueshëm për punën e tyre?
84 responses




Figure 22 - Përgjigjet në përqindje e të anketuarve lidhur me perceptimin mbi vlerësimin monetar të profesionit të infermierit.

Nga gjithsej 132 të anketuar, vetëm 12 persona (9.5%) vlerësuan se pagat e infermierëve janë të përshtatshme për punën që ata kryejnë. Brenda kësaj grupi, 9 ishin femra dhe 3 meshkuj. Në aspektin e edukimit, 2 ishin studentë në degë të lidhura me mjekësinë, 7 ndjekin universitete në fusha të tjera, 2 janë gjimnazistë, dhe 1 nuk ndjek aktualisht asnjë program studimi. Ndërkohë, shumica dërrmuese e të anketuarve, përkatësisht 93 persona (70.2%), deklaruan se pagat janë të ulëta. Ky grup përbëhej nga 47 femra dhe 46 meshkuj. Në raport me nivelin arsimor, 51 prej tyre ishin studentë në degë të mjekësisë, 6 në universitete të tjera, 24 ishin gjimnazistë, ndërsa 12 nuk ishin të përfshirë në ndonjë program arsimor në momentin e anketimit. Një përqindje relativisht e konsiderueshme, 20.3% e pjesëmarrësve (27 persona), u përgjigjën se nuk kishin informacion të mjaftueshëm për të gjykuar mbi nivelin e

pagesës së infermierëve. Brenda këtij grupi, 20 ishin femra dhe 7 meshkuj. Nga aspekti i formimit arsimor, 1 ishte student në degë të mjekësisë, 3 në degë të tjera universitare, 11 gjimnazistë, dhe 12 të tjerë nuk ndiqnin studime në momentin e mbledhjes së të dhënave.

Table 17 - Përgjigjet në vlera numerike e te anketuarve lidhur me perceptimin mbi vlerësimin monetar të profesionit të infermierit në bazë të gjinisë dhe arsimit.

Përgjigja	Te Anketuarit		Gjinia		Arsimimi			
	Nr. Personave	%	F	M	Univ. Mjekësi	Univ. Ijetër	Gjimnaz	Nuk ndjek studime
Po, pagat janë të përulueshme	12	9.5%	9	3	2	7	2	1
Jo, pagat janë të ulëta	93	70.2%	47	46	51	6	24	12
Nuk kam informacion të mjaftueshëm	27	20.3%	20	7	1	3	11	12
Totali	132	100%	76	56	54	16	37	25

Këto rezultate ofrojnë një pasqyrë të qartë të perceptimit kritik që të rinjtë kanë ndaj pagesës së infermierëve, dhe sugjerojnë se ndjenja e nënvlerësimit ekonomik është e përhapur dhe mbase ndikon drejtpërdrejt në imazhin e këtij profesioni në publikun e ri.

Pyetja 4: Sa të vështirë e konsideroni punën e një infermieri?

Pyetja e katërt e seksionit të dytë të anketës synonte të matë perceptimin mbi nivelin e vështirësisë së profesionit të infermierit, duke u kërkuar pjesëmarrësve të vlerësonin: "Sa të vështirë e konsideroni punën e një infermieri?". Kjo pyetje ndihmon në kuptimin e mënyrës sesi të rinjtë e perceptojnë ngarkesën fizike dhe psikologjike që shoqëron këtë profesion, dhe sa kjo mund të ndikojë në tërheqjen apo refuzimin e tij si karrierë e mundshme.

Nga përgjigjet e mbledhura, të paraqitura në Figurën 23 dhe Tabelën 18, rezultojnë se 42.9% e të anketuarve (56 persona) e konsiderojnë punën e infermierit si shumë të vështirë. Brenda këtij grupi, 36 ishin meshkuj dhe 20 femra, duke treguar një përqindje më të lartë të meshkujve që e perceptojnë këtë profesion si veçanërisht sfidues. Përgjigja më e përhapur ishte megjithatë varianti "të vështirë", i zgjedhur nga 60 persona (45.2%), ku përbërja gjinore ndryshon ndjeshëm: 48 femra dhe vetëm 12 meshkuj. Ky rezultat

sugjeron që ndër femrat ekziston një ndjeshmëri më e lartë ndaj aspekteve të lodhshme apo të ndërlikuara të punës infermierore. Një numër më i vogël i pjesëmarrësve, 14 persona (10.7%), e cilësuan punën si mesatarisht të vështirë, nga të cilët 6 ishin femra dhe 8 meshkuj. Vetëm 2 persona (1.2%) e vlerësuan atë si të lehtë, dhe të dy ishin femra.

Sa të vështirë e konsideroni punën e një infermieri?
84 responses




Figure 23 - Përgjigjet në përqindje e të anketuarve lidhur me perceptimin mbi vështirësinë e punës së infermierit.

Table 18 - Përgjigjet në vlera numerike e të anketuarve lidhur me perceptimin mbi vështirësinë e punës së infermierit në bazë të gjinisë.

Vlerësimi i vështirësisë së punës	Te Anketuarit		Gjinia	
	%	Numri	Femra	Meshkuj
Shumë të vështirë	42.9%	56	20	36
Të vështirë	45.2%	60	48	12
Mesatare	10.7%	14	6	8
Të lehtë	1.2%	2	2	0
Totali	100%	132	76	56

Këto të dhëna tregojnë se perceptimi mbi vështirësinë e profesionit është në përgjithësi i lartë, me rreth 88% të të rinjve që e konsiderojnë atë si shumë të vështirë ose të vështirë. Ky fakt është i rëndësishëm për të kuptuar barrierat psikologjike që mund të ndikojnë në zgjedhjen për të ndjekur këtë profesion në të ardhmen, dhe do të analizohet më tej në seksionin 4.3.

Faktorët që Ndikojnë në Zgjedhjen e Karrierës

Zgjedhja e një profesioni përbën një nga vendimet më të rëndësishme në jetën e një individi, veçanërisht gjatë fazës së adoleshencës dhe rinisë së hershme, kur krijohen aspiratat dhe orientimi profesional. Kjo pjesë e anketës është hartuar me synimin për të identifikuar faktorët kyç që ndikojnë të rinjtë në marrjen e vendimeve rreth karrierës së tyre, me fokus të veçantë në profesionin e infermierit. Duke u bazuar në literaturën ndërkombëtare dhe realitetin social shqiptar, faktorë të tillë si ndikimi i familjes, statusi social i profesionit, siguritë ekonomike dhe perceptimi

për vështirësinë apo shpërblimin e punës janë marrë në shqyrtim si elementë që mund të ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në preferencat e të rinjve për të ndjekur një karrierë në fushën e kujdesit shëndetësor.

Të dhënat që rrjedhin nga kjo pjesë synojnë të ofrojnë një kuptim më të thelluar të motivimeve, pritshmërive dhe barrierave që ndihen nga brezi i ri në raport me profesionin e infermierit, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e politikave më të mira për orientimin profesional dhe përmirësimin e imazhit të këtij profesioni në Shqipëri.

Pyetja 1: Cili faktor ka ndikimin më të madh në zgjedhjen tuaj të karrierës?

Rezultatet e kësaj pyetjeje tregojnë se preferencat e të rinjve në lidhje me karrierën janë të ndikuara nga një sërë faktorësh të brendshëm dhe të jashtëm, duke reflektuar prioritetet e tyre personale, sociale dhe ekonomike. Të dhënat janë paraqitur në Figurën 24 dhe Tabelën 19. Faktori më i përmendur ishte interesi dhe pasioni personal, i cili u zgjodh nga 32.1% e të anketuarve, ose 42 persona në total. Nga këta, 31 ishin femra dhe 11 meshkuj, ndërsa sipas grupmoshave, përzgjedhja dominohej dukshëm nga të rinjtë e moshës 19-21 vjeç (39 persona), duke treguar se sa më afër të jenë me vendimmarrjen për karrierë, aq më shumë peshon aspekti individual dhe motivimi personal në këtë zgjedhje.

Cili faktor ka ndikimin më të madh në zgjedhjen tuaj të karrierës?
84 responses




Figure 24 - Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit.

Megjithatë, rezultati më i lartë u shënua nga faktori siguria e punës dhe pagat e mira, që u përzgjodh nga 33.3%, ose 44 persona. Kjo tregon një orientim pragmatik nga të rinjtë, ku vendimmarrja për të ardhmen profesionale ndikohet nga perspektiva për stabilitet ekonomik. Interesant është fakti që ky opsion u përzgjodh më shumë nga meshkujt (28 persona) sesa nga femrat (16), dhe kishte përfaqësim të gjerë edhe në grupmoshën 15-16 vjeç (13 persona), duke treguar një ndërgjegjësim të hershëm për rëndësinë e sigurisë

financiare.

Table 19 - Faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit në bazë të moshës dhe gjinisë.

Faktori i Zgjedhur	Gjinia			Moshë		
	n	F	M	15-16	17-18	19-21
Interesi dhe pasioni personal	42	31	11	0	3	39
Siguria e punës dhe pagat e mira	44	16	28	13	12	19
Opinionet e familjes dhe shoqërisë	13	11	2	0	1	9
Mundësitë për emigrim dhe zhvillim jashtë vendit	33	17	15	6	6	21

Faktori "mundësitë për emigrim dhe zhvillim jashtë vendit" u rendit i treti me 25% të përgjigjeve, ose 33 persona, ku pjesëmarrësit ishin pothuajse të ndarë në mënyrë të barabartë mes femrave (17) dhe meshkujve (15). Ky rezultat sugjeron se një përqindje jo e vogël e të rinjve e shohin të ardhmen e tyre profesionale të lidhur me mundësitë jashtë Shqipërisë, qoftë për zhvillim të mëtejshëm arsimor, qoftë për kushte më të mira pune dhe jetese. Ndërsa faktori "opinionet e familjes dhe shoqërisë" ishte më pak i përmendur, me vetëm 9.5% ose 13 persona. Nga këta, 11 ishin femra, gjë që mund të sugjerojë një ndikim pak më të theksuar të opinionit të jashtëm tek vajzat në raport me djemtë. Gjithashtu, ky faktor u zgjodh kryesisht nga pjesëmarrësit të grupmoshës 19-21 vjeç, çka mund të reflektojë se, ndonëse më të pjekur, disa të rinj vazhdojnë të marrin parasysh ndikimet sociale dhe familjare në zgjedhjet e tyre.

Këto rezultate ofrojnë një pasqyrë të balancuar mes motivimeve personale dhe atyre strukturore, duke theksuar se vendimmarrja rreth karrierës është një proces kompleks dhe shumëfaktorësh, që ndryshon në varësi të gjinisë dhe moshës së individit.

Pyetja 2: A do të konsideroni ndjekjen e një karriere si infermier/e?

Një ndër pyetjet kyçe në pjesën e tretë të anketës lidhej me qëndrimin e të rinjve ndaj mundësisë për të ndjekur një karrierë si infermier apo infermiere. Kjo pyetje synonte të vlerësonte predispozitën individuale për t'u përfshirë në këtë profesion, si dhe ndikimin potencial të faktorëve demografikë dhe socialë në këtë vendim.

Nga të dhënat e mbledhura, paraqitur në Figurën 25 dhe Tabelën 20, rezultoi se 58.3% e të anketuarve (77 persona) deklaruan se do ta konsideronin ndjekjen e një karriere si infermier/e. Nga këta, pjesa më e madhe ishin femra (61 persona), ndërsa meshkujt përbënin një minorancë më të ulët (16 persona). Sa i përket grupmoshës, 9 prej tyre i përkisnin moshës 15-16 vjeç, 12 ishin 17-18 vjeç dhe një shumicë dominuese prej 56

personash i përkisnin moshës 19–21 vjeç. Kjo tregon një interes më të madh për këtë profesion te të rinjtë në prag të vendimmarrjes akademike dhe profesionale. Po ashtu, 55 nga këta persona kishin të afërm infermierë, duke lënë të kuptohet se modeli familjar dhe ekspozimi ndaj profesionit mund të ndikojë pozitivisht në orientimin profesional.

Në kategorinë "Ndoshta" u përgjigjën 31% e të rinjve (41 persona), ku 29 prej tyre ishin meshkuj dhe vetëm 12 femra. Kjo tregon një hezitim më të madh te meshkujt, ndoshta për shkak të stereotipeve gjinore apo mungesës së përfaqësimit në këtë fushë. Nga ana e moshës, 3 prej tyre ishin 15–16 vjeç, 10 ishin 17–18 vjeç dhe pjesa më e madhe (28 persona) përbëhej nga të rinj të moshës 19–21 vjeç. Nga ana tjetër, shumica kishin të afërm infermierë (31 persona), gjë që tregon se, ndonëse lidhja familjare me profesionin ka ndikim, ajo nuk është gjithmonë përcaktuese për një vendim të qartë.

Vetëm 10.7% (14 persona) e të anketuarve deklaruan se nuk do ta konsideronin një karrierë si infermier/e. Pjesa dërrmuese e këtyre ishin meshkuj (11 persona) dhe vetëm 3 femra, duke treguar një mungesë të interesit të theksuar në këtë grup gjinor. Interesant është fakti se 7 nga refuzuesit i përkisnin moshës më të re, 15–16 vjeç, që mund të interpretohet si mungesë informacioni apo distancë psikologjike nga realiteti profesional. Gjithashtu, 13 nga refuzuesit kishin të afërm në këtë profesion, çka mund të sinjalizojë edhe perceptime kritike të brendshme mbi vështirësitë e profesionit.

A do të konsideronit ndjekjen e një karriere si infermier/e?
84 responses




Figure 25 - Përgjigjet në përqindje e te anketuarve lidhur me konsideratën për të ndjekur karrierën si infermiere.

Table 20 - Përgjigjet numerike e të anketuarve lidhur me konsideratën për të ndjekur karrierën si infermierë, në bazë të gjinisë, moshës dhe nëse kanë pasur të afërm infermier.

Përgjigja	%	Numër personash	Gjinia		Moshë		Të afërm infermier	
			F	M	15-16	17-18	19-21	Kanë Nuk kanë
Po	58.3%	77	61	16	9	12	56	22
Ndoshta	31.0%	41	12	29	3	10	28	10
Jo	10.7%	14	3	11	7	3	4	13

Këto të dhëna ndihmojnë për të kuptuar më mirë se si ndërthuren faktorët gjinorë, moshë dhe ndikimi i afërsisë me profesionin në formësimin e aspiratave profesionale të të rinjve për të hyrë në profesionin e infermierit.

Pyetja 3: Cilat janë arsyt kryesore që do t'ju shtynin të zgjidhnit profesionin e infermierit?

Në këtë pyetje, të anketuarit kishin mundësi të zgjidhnin më shumë se një alternativë, çka lejon një kuptim më të gjerë mbi faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e profesionit të infermierit. Të dhënat tregojnë se pasioni për të ndihmuar të tjerët u rendit si arsyeja më e përmendur, duke u përzgjedhur nga 52% e pjesëmarrësve (69 persona). Brenda këtij grupi, 49 ishin femra dhe 20 meshkuj, çka sugjeron se dimensionin empatik ka një ndikim të dukshëm, veçanërisht te gjinia femërore.

Në vend të dytë renditet mundësia për punësim të sigurt, e cila u përmend nga 47.6% e të anketuarve (63 persona), prej të cilëve 43 ishin femra dhe 20 meshkuj. Ky rezultat nënvizon rëndësinë që të rinjtë i japin stabilitetit të punës, një faktor kyç në një treg pune në ndryshim të vazhdueshëm. Ndërkohë, përfitimet financiare u konsideruan si motivim nga 23.8% e pjesëmarrësve (31 persona), me një dominim të dukshëm të gjinisë mashkullore – 25 meshkuj kundrejt 6 femrave. Ky ndryshim tregon një orientim më të theksuar të meshkujve drejt aspektit ekonomik në zgjedhjen e karrierës.

Gjithashtu, vlerësimi dhe statusi social i profesionit u theksua si arsye nga 28.6% e të anketuarve (38 persona), ku vërehet një përqendrim i lartë i gjinisë femërore – 33 femra dhe vetëm 5 meshkuj, duke reflektuar ndjeshmërinë më të lartë të vajzave ndaj perceptimit shoqëror të profesionit. Së fundmi, 13.1% e të rinjve (17 persona) raportuan arsye të tjera që nuk përfshiheshin në alternativat e ofruara. Në këtë kategori, ndarja gjinore ishte më e balancuar: 9 femra dhe 8 meshkuj, ndërsa përgjigjet përfshinin arsye personale, familjare apo përvoja të mëparshme me profesionin.




Figure 26 - Shpërndarja në vlera numerike e të anketuarve për arsyet kryesore të ndikimit të zgjedhjes së profesionit të infermierit në bazë të gjinisë.

Pyetja 4: Cilat janë arsyet kryesore që do t'ju pengonin të zgjidhnit këtë profesion?

Pjesëmarrësit në studim u pyetën lidhur me faktorët pengues që mund të ndikojnë në mospërzgjedhjen e profesionit të infermierit. Të dhënat janë treguar në Figurën 27. Duke qenë se kjo pyetje lejonte përzgjedhjen e më shumë se një opsioni, të dhënat ofrojnë një pamje të gjerë mbi perceptimet e të rinjve për sfidat që shoqërojnë këtë profesion.

Pagat e ulëta rezultojnë të jenë faktori më i përmendur, duke u identifikuar si pengesë nga 56% e të anketuarve (74 persona). Brenda këtij grupi, 45 ishin meshkuj dhe 29 femra, çka tregon një ndjeshmëri më të lartë të meshkujve ndaj aspektit financiar të profesionit. Ky rezultat përforcon të dhënat e mëparshme të pyetjes për perceptimin d




Figure 27 - Shpërndarja në vlera numerike e të anketuarve për arsyet kryesore të ndikimit të zgjedhjes së profesionit të infermierit.

Një tjetër faktor me ndikim është mungesa e mundësive për zhvillim profesional, e përmendur nga

29.8% e të anketuarve (39 persona). Këtu vihet re një dominim absolut i gjinisë femërore me 37 femra kundrejt vetëm 2 meshkujve, çka mund të lidhet me pritshmëritë më të larta të vajzave për avancim në karrierë dhe rritje të kompetencës profesionale.

Mungesa e vlerësimit për profesionin u identifikua si një pengesë nga 32.1% e të rinjve (42 persona), me një shpërndarje gjinore prej 27 femrash dhe 15 meshkujsh. Ky rezultat është në përputhje me gjetjet e mëparshme ku një përqindje e madhe e të anketuarve shprehej se infermierët nuk respektohen sa duhet në shoqëri. Së fundi, arsye të tjera u përmendën nga një numër më i vogël pjesëmarrësish, 4.8% (6 persona), të gjitha femra, që përfshinin përgjigje si preferenca për profesione të tjera, frikë nga ngarkesa emocionale, ose pasiguri në vetvete për të përballuar presionin që kërkon profesionin.

Pyetja 5: A keni menduar ndonjëherë të punoni jashtë vendit si infermier/e?

Për të kuptuar prirjen e të rinjve drejt emigrimit profesional, pjesëmarrësve në studim iu drejtua pyetja nëse kishin menduar ndonjëherë të ushtronin profesionin e infermierit jashtë Shqipërisë. Të dhënat, prezantuar në Figurën 28 dhe Tabelën 21, tregojnë një ndarje të qartë në tri kategori kryesore: ata që e kanë konsideruar seriozisht këtë mundësi ("Po"), ata që janë të pavendosur ("Ndoshta"), dhe ata që nuk e kanë menduar ose e refuzojnë një mundësi të tillë ("Jo"). Nga të anketuarit, 41.7% (55 persona) deklaruan se kanë menduar të punojnë jashtë vendit si infermierë. Brenda këtij grupi, dominojnë femrat (46), ndërsa meshkujt janë të përfaqësuar me vetëm 9 persona. Në aspektin moshor, 28 nga këta ishin në grupmoshën 19-21 vjeç, çka sugjeron një interes në rritje për emigrimin pas përfundimit të shkollimit. 12 ishin të grupmoshës 15-16 vjeç, dhe 15 në grupmoshën 17-18 vjeç, duke dëshmuar se mendimi për emigrim lind që në fazat e hershme të edukimit të të rinjve.

A keni menduar ndonjëherë të punoni jashtë vendit si infermier/e?
34 responses




Figure 28 - Përqindja e 132 të anketuarve rreth mendimit për të punuar jashtë vendit në profesionin e infermierit/es.

Përgjigjja	Nr. personave	%	Gjinia		Moshë		
			Femra	Meshkuj	15-16	17-18	19-21
Po	55	41.7%	46	9	12	15	28
Ndoshta	55	41.6%	26	29	5	8	42
Jo	14	10.7%	4	18	2	2	10
Totali	132	100%	76	56	19	25	80

Një përqindje shumë e ngjashme, 41.6% (55 persona), deklaruan se ndoshta do ta konsideronin një mundësi të tillë në të ardhmen. Kjo kategori përfaqëson një segment të pasigurt, i cili mund të ndikohet lehtësisht nga faktorë të jashtëm si politikat e punësimit, vlerësimi social i profesionit apo kushtet ekonomike. Nga ky grup, 29 ishin meshkuj dhe 26 femra, dhe përsëri, shumica dërrmuese (42 persona) i përkasin moshës 19-21 vjeç, që përkon me përfundimin e arsimit të mesëm apo të lartë.

Ndërkohë, vetëm 10.7% (22 persona) shprehën se nuk kanë menduar kurrë të punojnë jashtë vendit si infermierë. Ky grup dominohet nga meshkujt (18 persona), ndërsa vetëm 4 janë femra, një shpërndarje që mund të interpretohet si një prirje më e ulët e meshkujve për të ndjekur një karrierë infermiere në emigrim. Në aspektin moshor, 18 persona nga kjo kategori i përkasin grupmoshës 19-21 vjeç, ndërsa grupmoshat 15-16 dhe 17-18 përfaqësohen me nga 2 persona secila.

Këto rezultate tregojnë se, pavarësisht vështirësive që lidhen me profesionin e infermierit në Shqipëri, një pjesë shumë e madhe e të rinjve (mbi 83%) janë të hapur

ndaj mundësisë së ushtrimit të këtij profesioni jashtë vendit, duke reflektuar qartë trendin e emigrimit profesional si një realitet i pranishëm në mendësinë e brezit të ri.

Pyetja 6: Sa e rëndësishme është për ju stabiliteti ekonomik në zgjedhjen e një karriere?

Rezultatet e pyetjes së gjashtë në Pjesën III të anketës tregojnë qartësisht se stabiliteti ekonomik përbën një faktor vendimtar në zgjedhjen e karrierës nga të rinjtë. Gjysma e të anketuarve (50%, përkatësisht 66 persona) e konsiderojnë stabilitetin ekonomik shumë të rëndësishëm. Nga kjo kategori, 30 ishin femra dhe 36 meshkuj, çka tregon se rëndësia e aspektit ekonomik është e përhapur në mënyrë të barabartë midis gjinive, megjithëse pak më e theksuar te meshkujt.

Një tjetër pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve (40.5%, ose 53 persona) deklaruan se e shohin stabilitetin ekonomik si të rëndësishëm në

vendimarrjen e tyre për karrierën. Nga këta, 38 ishin femra dhe 15 meshkuj, duke sugjeruar se kjo përgjigje ishte më e zakonshme ndër femrat. Vetëm 9.5% e të anketuarve (13 persona në total – 8 femra dhe 5 meshkuj) deklaruan se stabiliteti ekonomik është pak i rëndësishëm, ndërsa asnjë nga të anketuarit nuk e vlerësoi atë si aspak të rëndësishëm. Këto të dhëna dëshmojnë se siguria dhe qëndrueshmëria financiare janë faktorë me ndikim të fortë në përcaktimin e drejtimit profesional të të rinjve, veçanërisht në një kontekst socio-ekonomik ku garancia për të ardhmen është një nga shqetësimet kryesore të brezave të rinj.

Sa e rëndësishme është për ju stabiliteti ekonomik në zgjedhjen e një karriere?
54 responses




Figure 29 - Shpërndarja në përqindje e të anketuarve lidhur me rëndësinë e stabilitetit ekonomik në zgjedhjen e një karriere.

Table 21 - Shpërndarja në përqindje dhe vlera e të anketuarve lidhur me rëndësinë e stabilitetit ekonomik në zgjedhjen e një karriere, në bazë të gjinisë.

Alternativa e Përgjigjes	Numri i Personave	Përqindja (%)	Femra	Meshkuj
Shumë e rëndësishme	66	50.0%	30	36
E rëndësishme	53	40.5%	38	15
Pak e rëndësishme	13	9.5%	8	5
Aspak e rëndësishme	0	0.0%	0	0
Totali	132	100%	76	56

Pyetja 7: A ndikon opinioni i familjes suaj në zgjedhjen e karrierës tuaj?

Në lidhje me ndikimin e opinionit familjar në procesin e zgjedhjes së karrierës, të dhënat e mbledhura nga pjesëmarrësit tregojnë një ndikim të moderuar, por jo vendimtar nga familja. Konkretisht, 31% e të anketuarve (40 persona) kanë deklaruar se opinioni i familjes ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në zgjedhjen e karrierës së tyre. Nga këta, shumica dërrmuese janë femra (36) dhe vetëm 4 janë meshkuj, duke sugjeruar një ndjeshmëri më të lartë të vajzave ndaj ndikimeve familjare në krahasim me djemtë.

A ndikon opinioni i familjes suaj në zgjedhjen e karrierës tuaj?
84 responses




Figure 30 - Shpërndarja në përqindje e 132 të anketuarve lidhur me ndikimin e opinionit të familjes në zgjedhjen e karrierës.

Ndërkohë, përgjigjja më e përhapur ishte "Pak", e zgjedhur nga 50% e të anketuarve (66 persona), çka tregon një prani të opinionit familjar si faktor ndikues, por jo përcaktues. Në këtë grup, përfaqësimi gjinor është më i balancuar: 34 femra dhe 32 meshkuj, duke reflektuar se të dyja gjinitë e pranojnë ndikimin e familjes, por në mënyrë të kufizuar.

Së fundi, 19% e të rinjve (26 persona) janë shprehur se opinioni i familjes nuk ka aspak ndikim në vendimet e tyre profesionale. Ky grup dominohet nga meshkujt (20 persona), në krahasim me vetëm 6 femra, duke nënvizuar një tendencë më të lartë të djemve për të marrë vendime të pavarura lidhur me karrierën. Këto rezultate sugjerojnë se ndërsa familja vazhdon të luajë një rol të caktuar në orientimin profesional të të rinjve, niveli i ndikimit të saj ndryshon ndjeshëm në varësi të gjinisë, duke qenë më i fortë te femrat dhe më i zbehur te meshkujt.

Përmirësimi i Interesit për Profesionin e Infermierit

Profesionet e lidhura me kujdesin shëndetësor, dhe veçanërisht infermiera, përballen sot me sfida të shumta që lidhen jo vetëm me nevojën për staf të kualifikuar, por edhe me rënien e interesit të të rinjve për ta ndjekur këtë karrierë. Kjo situatë paraqitet shqetësuese, sidomos në kontekstin shqiptar, ku emigrimi i profesionistëve të shëndetësisë dhe mungesa e kushteve të favorshme të punës kontribuojnë në një mungesë gjithnjë e më të ndjeshme të infermierëve në sistemin publik dhe privat. Për të siguruar një shërbim shëndetësor cilësor dhe të qëndrueshëm, është e domosdoshme të adresohen faktorët që pengojnë ose dekurajojnë të rinjtë nga zgjedhja e këtij profesioni dhe, njëkohësisht, të promovohen mekanizmat që nxisin interesin dhe

motivimin për të hyrë në fushën e infermierisë.

Në këtë pjesë, do të analizohen propozimet e të rinjve për mënyrat konkrete që mund të ndihmojnë në përmirësimin e imazhit dhe tërheqjes ndaj profesionit të infermierit, duke përfshirë përmirësimet në kushtet e punës, politikat mbështetëse për zhvillim profesional, si dhe fushatat ndërgjegjëse dhe edukative që synojnë të promovojnë vlerat thelbësore të këtij profesioni.

Pyetja 1: Çfarë ndryshimesh mendoni se duhen bërë për të rritur interesin e të rinjve për profesionin e infermierit?

Rezultatet e marra nga të anketuarit tregojnë një konsensus të qartë mbi nevojën për përmirësime strukturore dhe ekonomike për të nxitur interesin e të rinjve për profesionin e infermierit. Alternativa më e përzgjedhur ishte rritja e pagave dhe përfitimeve, e cila u mbështet nga 65.1% e pjesëmarrësve (86 persona). Kjo kategori dominon sidomos tek meshkujt (55 nga 86) dhe është më e pranishme tek grupmosha 19–21 vjeç (49 persona). Sa i përket formimit arsimor, shumica që përzgjedhën këtë opsion ishin studentë të universiteteve të lidhura me mjekësinë (46 persona).




Figure 31 - Shpërndarja në vlera numerike e të anketuarve për ndryshimet kryesore të nevojshme për të rritur interesin mbi profesionin e gjinisë, në bazë të gjinisë.

Table 22 - Shpërndarja në vlera numerike e të anketuarve për ndryshimet kryesore të nevojshme për të rritur interesin mbi profesionin e gjinisë, në bazë të gjinisë, moshës dhe arsimit.

Alternativa	Anketimi %	n	Moshë			Arsimimi			Nuk ndjek studime
			15-16	17-18	19-21	Univ. mjekësi	Univ. tjetër	Gjimnaz	
Rritja e pagave dhe përfitimeve	65.1%	86	17	20	49	46	16	10	16
Përmirësimi i kushteve të punës	59%	78	18	12	48	36	16	12	16
Më shumë mundësi për specializim dhe zhvillim profesional	36.1%	48	5	13	30	31	10	7	0
Rritja e vlerësimit dhe imazhit të profesionit në shoqëri	26.5%	35	2	5	28	25	5	5	0

Përmirësimi i kushteve të punës u përmend nga 59% e të anketuarve (78 persona), me një shpërndarje relativisht të balancuar ndërmjet gjinive dhe dominancë të grupmoshës së rritur (48 persona në grupin 19–21 vjeç). Edhe në këtë rast, pjesa më e madhe vjen nga profilet universitare të lidhura me fushën e shëndetësisë (36 persona). Mundësitë për specializim dhe zhvillim profesional u konsideruan të rëndësishme nga 36.1% e të rinjve (48 persona), kryesisht nga femrat (32 nga 48) dhe studentët e universiteteve të fushës mjekësore (31 persona). Kjo tregon një vëmendje të shtuar ndaj zhvillimit të karrierës dhe rritjes së kompetencave profesionale në këtë profesion.

Ndërsa rritja e vlerësimit dhe imazhit të profesionit në shoqëri u përzgjedh nga 26.5% e të anketuarve (35 persona), ku dominuan sërish femrat (26 persona) dhe grupmosha 19–21 vjeç. Kjo sugjeron se perceptimi publik për rolin e infermierit është një faktor që ndikon ndjeshëm në vendimmarrjen për karrierë, sidomos tek femrat dhe të rinjtë që tashmë ndjekin studime në fushat mjekësore.

Në përgjithësi, të dhënat nxjerrin në pah se përmirësimi i kushteve ekonomike dhe profesionale, si dhe i statusit social të profesionit të infermierit, janë ndër prioritetet kryesore që mund të ndikojnë në rritjen e interesit për këtë profesion në mesin e të rinjve shqiptarë.

Pyetja 2: A do të ishit më të motivuar të ndiqnit këtë profesion nëse do të kishte më shumë mundësi për specializim jashtë vendit?

Në pyetjen e dytë të kësaj pjese, të rinjtë u pyetën nëse do të ndiheshin më të motivuar për të ndjekur profesionin e infermierit nëse do të ekzistonin më shumë mundësi për specializim jashtë vendit. Rezultatet, e prezantuara në Figurën 32 dhe Tabelën 23, tregojnë se një shumicë e konsiderueshme, 61.4% e të anketuarve (n = 81), shprehën se do të ndiheshin më të motivuar, ndërsa 32.5% (n = 43) u shprehën me një qëndrim më të rezervuar duke zgjedhur opsionin “ndoshta”. Vetëm një pakicë prej 6% (n = 8) deklaruan se nuk do të ndiheshin më të motivuar, pavarësisht mundësive të tilla.

A do të ishit më të motivuar të ndiqnit këtë profesion nëse do të kishte më shumë mundësi për specializim jashtë vendit?
81 responses




Figure 32 - Shpërndarja në përqindje e 132 të anketuarve lidhur me ndikimin e specializimeve në motivimin e zgjedhjes së profesionit të infermierit.

Table 23 - Shpërndarja në vlera numerike e 132 të anketuarve lidhur me ndikimin e specializimeve në motivimin e zgjedhjes së profesionit të infermierit, në bazë të gjinisë.

Alternativa	Nr. personave	Femra	Meshkuj	%
Po - Do të isha më i/e motivuar	81	61	20	61.4%
Ndoshta	43	14	29	32.5%
Jo - Nuk do të isha më i/e motivuar	8	7	1	6.0%
Totali	132	82	50	100%

Në ndarjen gjinore, rezulton se pjesa më e madhe e femrave janë të prira të ndikohen nga mundësitë për specializim jashtë vendit – nga 81 respondentët që janë përgjigjur “po”, 61 janë femra, ndërsa 20 janë meshkuj. Ndërkohë, midis atyre që janë shprehur me “ndoshta”, 24 janë meshkuj dhe 14 femra, duke sugjeruar një nivel më të lartë të pasigurie mes djemve. Sa i përket kategorisë “jo”, ajo përfaqësohet në mënyrë të kufizuar, me vetëm 8 persona në total, ku 7 janë femra dhe 1 mashkull. Këto të dhëna tregojnë qartë se mundësitë për specializim jashtë vendit perceptohen si një faktor mjaft motivues për shumicën e të rinjve, veçanërisht për vajzat, duke e bërë këtë një drejtim të rëndësishëm për politikën nxitëse të sistemit arsimor dhe shëndetësor.

Pyetja 3: Nëse do të kishit mundësi të takonit një infermier/e me përvojë, cilat do të ishin pyetjet tuaja kryesore për këtë profesion?

Të dhënat e mbledhura nga pyetja e hapur “Nëse do të kishit mundësi të takonit një infermier/e me përvojë, cilat do të ishin pyetjet tuaja kryesore për këtë profesion?” tregojnë qartë një interes të thellë dhe të shumëanshëm të të rinjve për të kuptuar realitetin konkret të profesionit të infermierit. Ndryshe nga përgjigjet e pyetjeve me alternativa të kufizuara, ky format i hapur u ka dhënë mundësi pjesëmarrësve të shprehin lirisht shqetësimet, kureshtjet dhe pritshmëritë e tyre në lidhje me këtë profesion, duke ndriçuar më mirë perceptimin e përgjithshëm që ata kanë për fushën e infermierisë.

Një pjesë shumë e madhe e përgjigjeve janë

përqendruar te aspekti financiar i profesionit. Pyetje si "Sa është paga?", "A paguheni mjaftueshëm për punën që bëni?", "A ia vlen ky profesion në kushtet aktuale në Shqipëri?" janë ndër më të përmendurat. Kjo tregon qartazi se stabiliteti ekonomik dhe siguria financiare janë faktorë vendimtarë në vendimarrjen e të rinjve për karrierën e tyre, dhe se mungesa e transparencës në lidhje me përfitimet ekonomike të këtij profesioni është një pikë e rëndësishme që kërkon adresim.

Një tjetër grup i konsiderueshëm përgjigjesh fokusohet në vështirësitë dhe sfidat e profesionit të infermierit, ku të rinjtë kërkojnë të dinë: "A është një profesion i vështirë?", "Cilat kanë qenë momentet më sfiduese gjatë karrierës?", "A ka qenë e lehtë për ju të zhvilloheni profesionalisht në Shqipëri?". Këto pyetje pasqyrojnë pasigurinë dhe frikën nga ngarkesa e punës, si dhe nevojën për të kuptuar më mirë dimensionin emocional dhe fizik të angazhimit në këtë profesion. Një tjetër temë që del në pah është motivimi dhe pasioni për profesionin. Pyetjet si "A e bëni me dëshirë këtë punë?", "Çfarë ju motivon çdo ditë?", "A ndiheni të lumtur me profesionin tuaj?" dëshmojnë për dëshirën e të rinjve që të kuptojnë nëse ky profesion ofron kënaqësi personale dhe shpërblim moral, përtej pagës dhe kushteve fizike të punës.

Gjithashtu, shumë prej pjesëmarrësve janë treguar të interesuar për të kuptuar dinamikat ndërpersonale në ambientin e punës, duke kërkuar informacion mbi marrëdhëniet me mjekët, pacientët dhe kolegët infermierë. Këto shqetësime lidhen ngushtë me cilësinë e përvojës profesionale dhe me atë që shpesh cilësohet si "klime organizative" në institucionet shëndetësore, e cila ndikon drejtpërdrejt në motivimin dhe qëndrueshmërinë në profesion.

Table 24 - Pyetjet më të shpeshta referuar infermierëve sipas kategorive nga të anketuarit.

Kategoria e pyetjeve	Numri i përafërt i përmendjeve	Përqindja (%)
Sa është paga? / A paguheni mjaftueshëm? / A ia vlen financiarisht?	47	35.6%
Cilat janë sfidat më të mëdha në këtë profesion? / A është i vështirë?	33	25.0%
A e bëni me pasion këtë profesion? / A jeni të kënaqur me profesionin tuaj?	18	13.6%
Si janë marrëdhëniet me mjekët, infermierët e tjerë dhe pacientët?	16	12.1%
Si ka qenë rrugëtimi juaj profesional? / A ka pasur vështirësi gjatë ngritjes në detyrë?	10	7.6%
A e rekomandoni këtë profesion? / A do ia sugjeronit fëmijëve tuaj?	8	6.1%

Në fund, një numër i konsiderueshëm të rinjsh kanë shprehur interes për rrugëtimin profesional të infermierëve me përvojë, duke pyetur: "Si keni arritur

në këtë pikë?", "A është e mundur të rritesh në karrierë në Shqipëri?", "Cilat janë mundësitë për specializim dhe zhvillim profesional?". Këto pyetje tregojnë një dëshirë reale për perspektivë dhe avancim profesional, dhe njëkohësisht reflektojnë mungesën e informacionit të strukturuar për rrugët dhe mundësitë që ofron ky profesion në vend.

Në përfundim, përgjigjet e kësaj pyetje të hapur dëshmojnë për një interes serioz dhe të argumentuar të të rinjve, të cilët duan të informohen më mirë, të kenë më shumë

qartësi dhe të ndërtojnë një vendim të vetëdijshëm dhe realist për të ardhmen e tyre profesionale. Kjo nënvizon rëndësinë e ofrimit të modeleve reale nga praktika, mentorimit dhe transparencës institucionale, për të rritur besimin dhe interesin ndaj profesionit të infermierit.

Pyetja 4: Si mendoni se mund të parandalohet emigrimi i infermierëve të kualifikuar?

Bazuar në analizën e përgjigjeve të pyetjes së hapur nr. 4: "Si mendoni se mund të parandalohet emigrimi i infermierëve të kualifikuar?", vihet re një konsensus i gjerë midis të rinjve mbi faktorët kryesorë që ndikojnë në vendimin për të emigruar, si dhe masat që mund të merren për të frenuar këtë fenomen në rritje. Përgjigjet tregojnë se të rinjtë janë të vetëdijshëm për sfidat reale me të cilat përballen profesionistët e shëndetësisë në Shqipëri dhe ofrojnë sugjerime që reflektojnë shqetësime sociale dhe ekonomike konkrete.

Pjesa dërrmuese e përgjigjeve përqendrohet në nevojën për rritjen e pagave, si një ndër mjetet më të rëndësishme për të parandaluar largimin e infermierëve nga vendi. Pothuajse çdo pjesëmarrës përmend drejtpërdrejt ose tërthorazi rëndësinë e kompensimit të drejtë dhe të motivueshëm financiar, duke e konsideruar atë si themelin për të siguruar stabilitet ekonomik dhe motivim profesional. Shprehje si "të rriten pagat", "paga më të larta", "pagesa më të mira" janë ndër më të përsëriturat dhe tregojnë se të rinjtë e perceptojnë nivelin aktual të pagave në Shqipëri si jo të mjaftueshëm për të mbajtur profesionistët në vend.

Table 25 - Vleresimet kryesore sipas të anektuarve për

mënyrat se si mund të pengohet emigrimi i infermierëve të kualifikuar.

Temat Kryesore	Përshkrimi	Shembuj nga përgjigjet
Rritja e pagave	Paga më të larta për të motivuar qëndrimin në Shqipëri dhe për të konkuruar me ofertat e vendeve të huaja.	"Të mblen pagat", "Rritja e pagave", "Pagesa më të larta", "Duke miratuar"
Përmirësimi i kushteve të punës	Ambient punë i sigurt, me infrastrukturë moderne dhe trajtim për mirësjelljen, të denjë për punonjësit shëndetësorë.	"Kushtet më të mira punë", "Të kushtet", "Respekt më i madh ndaj profesionit", "Të trajtohen më mirë nga pacientët"
Vlerësimi dhe respektimi i profesionit	Njohje më e madhe institucionale dhe sociale për rolin e infermierit në sistemin shëndetësor.	"Duke u vlerësuar më shumë", "Respekt më i madh ndaj profesionit", "Të trajtohen më mirë nga pacientët"
Zhvillimi profesional në vend	Ofrimi i mundësive për trajnime, specializime dhe avancim në karrierë brenda Shqipërisë.	"Mundësi për profesionalizim", "Eksperienca të ndryshme", "Trajtime", "Zhvillim profesional"
Bursa dhe stimuj financiarë	Mbështetje ekonomike për studentët dhe infermierët përmes bursave dhe bonuseve.	"Bursa", "Të jepen bonuse", "Përfundimi i bursave", "Stimuj financiarë"
Mundësi më të mira punësimit	Krijimi i më shumë vendeve të punës dhe transparencë në rekrutimin punësor.	"Mundësi më të mira për punësim në Shqipëri", "Të mos largohen jashtë vendit"
Zgjedhje personale	Disa të rinj e konsiderojnë emigrimin si një vendim personal për një të ardhme më të mirë, jo dikujt, por është zgjedhje gjilmonë i ndikuar vetëm nga personale kushtet ekonomike.	

Një tjetër aspekt i rëndësishëm që del në pah është përmirësimi i kushteve të punës. Të rinjtë theksojnë rëndësinë e krijimit të një mjedisi profesional që ofron siguri, dinjitet dhe kushte të përshtatshme për ushtrimin e profesionit. Përgjigjet si "kushte më të mira punë", "të përmirësohen kushtet e punës", "të rregullohen kushtet e punësimit", tregojnë për një ndjeshmëri të lartë ndaj ambientit të punës, mungesës së infrastrukturës dhe nevojës për modernizimin e spitaleve dhe qendrave shëndetësore, përfshirë edhe aksesin në teknologji të avancuar. Në disa prej përgjigjeve vihet re edhe kërkesa për vlerësim më të madh profesional dhe social të infermierëve. Të rinjtë kërkojnë që puna e infermierit të respektohet më shumë, të ketë më shumë bonuse, përfitime dhe trajtim të dinjitetshëm nga institucionet dhe komuniteti. Ky vlerësim shihet jo vetëm si një çështje morale, por edhe si një mënyrë për të krijuar ndjesinë e përkatësisë dhe krenarisë për profesionin.

Një pjesë tjetër e përgjigjeve nënvizon mundësitë për zhvillim profesional, përmes bursave, trajnimeve, eksperiencave të reja dhe rrugëve të avancimit në karrierë. Kjo tregon për një dëshirë reale të të rinjve që të kenë alternativa zhvillimi brenda vendit, pa qenë të detyruar të emigrojnë për të arritur objektivat e tyre profesionale. Termat "bursa", "mundësi punësimi", "rritje profesionale", përmenden si mënyra për të ofruar perspektivë të qartë dhe shpresë për një të ardhme më të mirë në sistemin shëndetësor vendas.

Është me interes të përmendet se disa nga të rinjtë theksojnë se emigrimi është një zgjedhje personale, duke e pranuar si të drejtë individuale që nuk mund të ndalohej plotësisht, por që mund të reduktohet në mënyrë të konsiderueshme nëse adresohet në mënyrë serioze pakënaqësia aktuale e profesionistëve të shëndetësisë në Shqipëri.

Në përfundim, analiza e kësaj pyetjeje të hapur tregon se arsyet për emigrimin e infermierëve të kualifikuar janë shumëdimensionale, por edhe zgjidhjet e propozuara nga të rinjtë janë po aq të qarta: rritja e pagave, përmirësimi i kushteve të punës, zhvillimi profesional dhe vlerësimi shoqëror i profesionit të infermierit përbëjnë katër shtyllat kryesore të ndërhyrjes për ta frenuar këtë trend. Këto sugjerime të vetë studentëve ose të rinjve duhet të merren seriozisht nga institucionet përkatëse, nëse synohet ndërtimi i një sistemi shëndetësor të qëndrueshëm dhe tërheqës për brezat e ardhshëm.

Konkluzione

Studimi i realizuar me titull "Evidentimi i problemeve në shërbimin infermior për evitimin e emigrimit të punonjësve të kualifikuar të shëndetit" synoi të ofrojë një pasqyrë të thelluar mbi perceptimet, motivimet dhe faktorët ndikues që formësojnë marrëdhënien e të rinjve shqiptarë me profesionin e infermierit, si dhe të identifikojë

rreziqet e braktisjes së këtij profesioni përmes emigrimit. Në përfundim të analizës së të dhënave dhe diskutimit të gjerë mbi përgjigjet e pjesëmarrësve, si dhe në dritën e literaturës shkencore dhe kontekstit socio-ekonomik shqiptar, mund të nxirren disa përfundime themelore:

1. Profesion i vlerësuar, por nën presion shoqëror dhe ekonomik

Të dhënat treguan se profesioni i infermierit perceptohet në mënyrë përgjithësisht pozitive nga të rinjtë shqiptarë, sidomos në raport me humanizmin, ndihmën ndaj të

tjerëve dhe sigurinë e punës. Megjithatë, kjo vlerësim përplasat me realitetin e një profesioni që shpesh perceptohet si i nënvlerësuar ekonomikisht dhe shoqërisht në Shqipëri. Vërehet një kontrast i qartë mes dimensionit etik të profesionit dhe mungesës së kushteve të favorshme për zhvillim profesional në vend.

2. Orientimi ndaj infermierisë ndikohet fuqishëm nga

gjinia, mosha dhe përvoja personale

Analiza statistikore (përmes testit chi-square) evidentoi lidhje të rëndësishme ndërmjet gjinisë dhe gatishmërisë për të ndjekur karrierë si infermier. Femrat shfaqën më shumë predispozitë pozitive dhe motivim për t'u angazhuar në këtë fushë, ndërsa meshkujt ishin më të rezervuar, ndoshta për shkak të stereotipeve gjinore dhe perceptimeve kulturore që ende e shohin infermierinë si profesion të "femrës". Po ashtu, individët që kishin të afërm infermierë shfaqën një prirje dukshëm më të lartë për të ndjekur këtë karrierë, duke dëshmuar ndikimin e faktorit të modelimit personal dhe rolit të afërsisë me profesionin.

3. Prirje e fortë për emigrim në kërkim të mundësive më të mira.

Një nga gjetjet më të rëndësishme të studimit është prania e një predispozite të forte për të ndjekur karrierën e infermierit jashtë vendit. Rreth 83% e të rinjve u shprehën "Po" ose "Ndoshta" në pyetjen lidhur me gatishmërinë për të punuar si infermierë jashtë Shqipërisë, me prirje më të theksuar tek grupmosha 19–21 vjeç. Kjo tregon se motivimi për këtë profesion ekziston, por ai kanalizohet jashtë vendit për shkak të mungesës së politikave të brendshme mbështetëse. Femrat, në mënyrë të veçantë, e shohin emigrimin si një mundësi për rritje dhe siguri profesionale.

4. Nevoja për përmirësime sistematike dhe ndërhyrje institucionale

Nëpërmjet analizës së pyetjeve lidhur me mënyrat për të nxitur interesin për këtë profesion, u bë e qartë se të rinjtë nuk kërkojnë vetëm paga më të larta, por një përmirësim gjithëpërfshirës të sistemit: kushte më të mira pune, mundësi specializimi, respekt institucional dhe një imazh më pozitiv në shoqëri. Këto janë komponentë të pandashëm të një strategjie kombëtare që duhet të ndërtohet jo vetëm për të promovuar infermierinë, por edhe për të siguruar që profesionistët e rinj të ndihen të vlerësuar dhe të motivuar për të qëndruar në vend.

5. Specializimi jashtë vendit si shtytës kyç për motivim profesional

Një përqindje e lartë e të anketuarve (61.4%) u shprehën se do të ishin më të motivuar të ndjeknin profesionin e infermierit nëse do të kishin mundësi për specializim jashtë vendit. Analiza statistikore tregoi lidhje domethënëse me gjininë, ku femrat paraqitën një motivim dukshëm më të lartë. Kjo sugjeron se bashkëpunimet ndërkombëtare dhe

programet e shkëmbimit mund të shërbejnë si ura për të ruajtur dhe zhvilluar potencialin e infermierëve shqiptarë brenda sistemit shëndetësor vendas.

6. Roli i edukimit dhe informimit si faktor parandalues ndaj emigrimit të hershëm

Rezultatet sugjerojnë se mungesa e informacionit, orientimit profesional të hershëm dhe kontaktit me realitetin e punës në infermieri mund të jenë ndër shkaqet që shtyjnë të rinjtë drejt vendimeve për emigrim. Ndaj, politikat arsimore duhet të përfshijnë më shumë komponentë orientues në lidhje me profesionet shëndetësore, duke përfshirë praktika të hershme, ndërgjegjësim për perspektivat në vend dhe mbështetje institucionale gjatë studimeve.

Në përmbyllje, ky studim tregon qartë se sfidat me të cilat përballlet profesioni i infermierit në Shqipëri nuk lidhen vetëm me aspektet financiare, por me një kompleks faktorësh që prekin strukturën e sistemit shëndetësor, imazhin publik të profesionit dhe politikat e zhvillimit profesional. Të rinjtë shqiptarë e duan dhe e respektojnë profesionin e infermierit, por janë gjithnjë e më të prirur ta ndjekin atë jashtë vendit, për shkak të mungesës së mundësive për zhvillim dhe vlerësim real në atdhe. Kjo kërkon ndërhyrje urgjente për të krijuar një sistem më të qëndrueshëm dhe më tërheqës, ku infermierët e rinj të ndihen të mbështetur, të motivuar dhe të vlerësuar.

Vetëm përmes një qasjeje të integruar politike, institucionale dhe sociale, Shqipëria mund të parandalojë largimin masiv të profesionistëve të rinj dhe të sigurojë një sistem shëndetësor të fortë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm në të ardhmen.

Rekomandime

Në thellësinë e rezultateve të këtij studimi dhe analizës së thelluar të perceptimeve të të rinjve për profesionin e infermierit, si dhe të faktorëve që ndikojnë në zgjedhjet e tyre për karrierë dhe prirjen për emigrim, rekomandimet e mëposhtme synojnë të kontribuojnë në forcimin e sistemit shëndetësor dhe në krijimin e kushteve të favorshme për mbajtjen dhe zhvillimin profesional të infermierëve të rinj brenda vendit:

Rritja e pagave dhe përfitimeve financiare për infermierët. Shteti shqiptar dhe institucionet publike shëndetësore duhet të ndërmarrin hapa të qartë për rritjen e pagës bazë dhe ofrimin e bonuseve stimuluese për infermierët, në mënyrë që

ky profesion të konkurrojë denjësisht me ofertat që vijnë nga vendet e huaja. Politikat e kompensimit duhet të jenë transparente, të ndërlidhura me performancën dhe të orientuara drejt mbajtjes afatgjatë të stafit të kualifikuar.

Përmirësimi i kushteve të punës dhe infrastrukturës spitalore

Kushtet aktuale të punës shpesh janë të vështira dhe të papërshtatshme, çka ndikon negativisht jo vetëm në cilësinë e kujdesit shëndetësor, por edhe në motivimin profesional. Investimi në infrastrukturën teknologjike dhe logjistike, si dhe sigurimi i një ambienti pune të sigurt, të respektuar dhe etik, është thelbësor për ruajtjen e fuqisë punëtore infermiore në Shqipëri.

Zhvillimi i mundësive të specializimit dhe edukimit të vazhdueshëm profesional

Duhet të krijohen dhe të mbështeten programe konkrete specializimi për infermierët, si brenda vendit ashtu edhe përmes bashkëpunimeve ndërkombëtare. Mundësia për të ndjekur studime pasuniversitare, trajnimet e avancuara dhe shkëmbimet akademike ndihmon jo vetëm në zhvillimin e kapaciteteve profesionale, por edhe në rritjen e besimit dhe ndjesisë së vlerësimit institucional.

Forcimi i orientimit profesional dhe informimit të hershëm.

Zbatimi i fushatave të mirëstrukturuara për informimin e nxënësve të shkollave të mesme mbi realitetin e profesionit të infermierit, përmes punëtorive, vizitave në qendra shëndetësore dhe kontakteve me profesionistët e fushës, do të ndihmonte në ndërtimin e një perceptimi realist dhe pozitiv për këtë profesion, që nga moshat e hershme.

Rritja e imazhit shoqëror dhe vlerësimit publik të profesionit të infermierit

Media, sistemi arsimor dhe vetë institucionet shëndetësore duhet të luajnë një rol më aktiv në promovimin e figurës së infermierit si një profesion jetik, i ndërlikuar dhe me rëndësi të lartë sociale. Duhet të mbështeten fushata ndërgjegjësuëse dhe të nxitet krijimi i roleve model në opinionin publik.

Krijimi i mekanizmave për pjesëmarrjen aktive të infermierëve në vendimmarrje Infermierët shpesh përjashtohen nga strukturat vendimmarrëse të institucioneve shëndetësore.

Rekomandohet që ata të përfaqësohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në bordet menaxheriale dhe në hartimin e politikave të brendshme të spitaleve, çka rrit përfshirjen, ndjesinë e pronësisë dhe përgjegjësinë profesionale.

Hartimi i një strategjie kombëtare për frenimin e emigrimit të infermierëve

Qeveria shqiptare duhet të hartojë një strategji afatmesme dhe afatgjatë për të parandaluar "rrjedhjen e trurit" në sistemin shëndetësor, e cila duhet të përfshijë: mbajtjen e të dhënave të sakta mbi numrin dhe prirjet e infermierëve që largohen nga vendi; ndërtimin e marrëveshjeve bilaterale me shtetet pritëse për kushte të drejta pune; dhe ofrimin e stimulave për rikthimin dhe riintegrimin e infermierëve të emigruar.

Përfshirja e të rinjve në hartimin e politikave për profesionin

Të rinjtë që ndjekin arsimin profesional ose universitar në infermieri duhet të përfshihen në mënyrë aktive në forumet dhe organizatat që mbrojnë interesat e profesionit të tyre. Kjo përfshirje jo vetëm që ndihmon në ndërtimin e një lidhësi të ri profesional, por edhe përçon një ndjesi përkatësie dhe përgjegjësie qytetare.

Sfidat dhe nevojat e të sëmurëve kronikë gjatë pandemisë Covid-19 në qendrat shëndetësore të qytetit të Vlorës

Klaudeta Kondi (2025)

Program i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Shkenca Infermierore"

Udhëheqës shkencor: Prof. asoc.Dr.Enkelejd Mëhilli

Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Pandemia COVID-19 ka ndikuar thellësisht tek individët me sëmundje kronike, duke sjellë vështirësi në aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore, sigurimin e barnave, mirëqenien psikologjike dhe stabilitetin ekonomik. Pacientët kronikë përfaqësojnë një grup vulnerabël, për të cilin pandemia ka ekspozuar sfida të shumëfishta në kujdesin parësor dhe në jetën e përditshme.

Qëllimi i këtij studimi është të vlerësojë ndikimin e pandemisë COVID-19 në përjetimin e sfidave dhe identifikimin e nevojave të pacientëve me sëmundje kronike në qendrat shëndetësore të qytetit të Vlorës, duke analizuar aspektet shëndetësore, psikologjike, sociale dhe ekonomike.

Ky është një studim miks (kuantitativ dhe kualitativ), i realizuar në qendrat shëndetësore të qytetit të Vlorës gjatë periudhës qershor–shtator 2023. Në studim u përfshinë 52 pacientë me sëmundje kronike si diabet mellitus, hipertension arterial, sëmundje

kardiovaskulare, renale dhe pulmonare obstruktive.

Të dhënat u mblodhën me pyetësorë të strukturuar dhe intervista të hapura. Analizat statistikore përfshin metoda përshkruese dhe korrelacion Pearson, ndërsa të dhënat cilësore u përpunuan përmes analizës tematike të përvojave të pacientëve.

Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 59.8 vjeç ($SD=15.75$; range 19–87), me një lidhje statistikisht të rëndësishme midis moshës dhe numrit të sëmundjeve kronike ($r=0.439$, $p<0.01$). Hipertensioni arterial (47.4%) dhe diabeti mellitus (39.7%) ishin patologjitë më të shpeshta, ndërsa 44.2% raportuan komorbiditete. Vështirësi në aksesin shëndetësor deklaruan 98.1% e pacientëve, me nivele të ulëta kënaqësie ndaj shërbimeve, ndërkohë që 69.2% raportuan pengesa financiare për sigurimin e barnave. Vlerat mesatare të glicemisë (257.9 mg/dL) dhe tensionit arterial ($149.9/91.7$ mmHg) pasqyruan gjendje të pakontrolluar, duke shoqëruar përkeqësim të simptomave tek 64.5% e diabetikëve dhe 67.6% e

hipertensivëve. Nga ana psikologjike, mbi 86% e pacientëve përjetuan frikë dhe ndjesi stigmatizimi, ndërsa 42.3% ankth pothuajse çdo ditë dhe 65.4% raportuan vështirësi të theksuara në përballimin e stresit. Dimensioni socio-ekonomik rezultoi i rënduar, me 92.3% të pjesëmarrësve që deklaruan humbje të të ardhurave dhe 59.6% humbje të vendit të punës, ndërkohë që vetëm 9.6% përfituan ndihmë financiare. Analiza cilësore e intervistave konfirmoi këto gjetje, duke nxjerrë në pah izolimin social, reduktimin e aktivitetit fizik (67.3%) dhe uljen e konsumit të frutave e perimeve (50%), por edhe reflektime mbi rëndësinë e kujdesit personal, mbështetjes familjare dhe solidaritetit gjatë krizës.

Studimi tregoi se pandemia COVID-19 ka ndikuar ndjeshëm në cilësinë e jetës së pacientëve kronikë, duke përkeqësuar gjendjen klinike, mirëqenien psikologjike dhe situatën ekonomike. Rezultatet theksojnë domosdoshmërinë e politikave shëndetësore dhe sociale më gjithëpërfshirëse, të cilat garantojnë akses në shërbime, furnizim të qëndrueshëm me barna dhe mbështetje psiko-sociale e ekonomike për këtë kategori pacientësh.

Fjalët kyçe: Covid-19, të sëmurë kronik, sfida, barriera, komorbiditet, diabet mellitus, hipertension, sëmundje kardio- vaskulare

Abstract

The COVID-19 pandemic has profoundly affected individuals with chronic diseases, creating difficulties in accessing healthcare services, obtaining medications, maintaining psychological well-being, and ensuring economic stability. Chronic patients represent a vulnerable group for whom the pandemic exposed multiple challenges in primary care and daily life.

The aim of this study is to evaluate the impact of the COVID-19 pandemic on the experiences, challenges, and needs of patients with chronic conditions in primary healthcare centers in the city of Vlora, by analyzing health, psychological, social, and economic aspects.

This is a mixed-methods study (quantitative and qualitative) conducted in primary healthcare centers in Vlora during the period June–September 2023. The study included 52 patients with chronic conditions

such as diabetes mellitus, arterial hypertension, cardiovascular diseases, renal diseases, and chronic obstructive pulmonary disease. Data were collected through structured questionnaires and open-ended interviews. Statistical analyses included descriptive methods and Pearson's correlation, while qualitative data were analyzed thematically to explore patients' experiences.

The mean age of participants was 59.8 years (SD=15.75; range 19–87), with a statistically significant positive correlation between age and the number of chronic conditions ($r=0.439$, $p<0.01$). Hypertension (47.4%) and diabetes mellitus (39.7%) were the most common pathologies, while 44.2% reported comorbidities. A total of 98.1% experienced difficulties in accessing healthcare services, with low satisfaction levels, and 69.2% reported financial barriers to obtaining medications. Mean blood glucose (257.9 mg/dL) and blood pressure values (149.9/91.7 mmHg) reflected uncontrolled conditions, with worsening of symptoms in 64.5% of diabetic patients and 67.6% of hypertensive patients. Psychologically, over 86% reported fear and stigma, 42.3% experienced anxiety almost daily, and 65.4% had significant difficulty coping with stress. The socio-economic dimension was severely affected, with 92.3% reporting loss of income and 59.6% reporting job loss, while only 9.6% received financial support. Qualitative interviews confirmed these findings, highlighting social isolation, reduced physical activity (67.3%), decreased fruit and vegetable consumption (50%), and reflections on the importance of self-care, family support, and solidarity during the crisis.

The study showed that the COVID-19 pandemic significantly impacted the quality of life of chronic patients, worsening their clinical condition, psychological well-being, and economic situation. The results emphasize the need for more inclusive health and social policies that ensure access to services, a sustainable supply of medicines, and psycho-social and economic support for this vulnerable group.

Keywords: Covid-19, chronically ill, challenges, barriers, comorbidity, diabetes mellitus, hypertension, cardiovascular disease

Hyrje

Pandemia COVID-19, e cila u shfaq fillimisht në Wuhan, Kinë, në dhjetor 2019, u përhap me shpejtësi në mbarë

botën duke shkaktuar miliona infeksione dhe një numër të lartë vdekjesh [1]. Përveç ndikimit të drejtpërdrejtë shëndetësor, pandemia solli pasoja të gjera sociale dhe ekonomike, duke u konsideruar si kriza më e madhe shëndetësore globale në një shekull [2]. Personat me sëmundje kronike dhe sisteme imunitare të dobësuara rezultuan veçanërisht të ndjeshëm ndaj formave të rënda dhe fatale të infeksionit [3], ndërsa ndërprerja e shërbimeve shëndetësore e përkeqësoi më tej gjendjen e tyre klinike [5].

Grupet më të rrezikuara përfshinin pacientët me diabet mellitus, hipertension arterial, sëmundje kardiovaskulare, sëmundje renale kronike dhe sëmundje pulmonare obstruktive kronike, të cilët jo vetëm kishin rrezik më të madh për komplikacione, por edhe përballuan vështirësi në qasjen e rregullt ndaj vizitave mjekësore dhe analizave laboratorike gjatë periudhës së izolimit [5]. Përveç kufizimeve strukturore, ata përjetuan ndikime të theksuara psikologjike, si rritja e stresit dhe ankthit, si dhe ndryshime në rutinën ditore, përfshirë dietën dhe aktivitetin fizik [3].

Në këtë kuadër, pacientët kronikë përfaqësojnë një kategori të veçantë, ku menaxhimi i kujdesit shëndetësor nuk varej vetëm nga sistemi shëndetësor, por edhe nga vetëdijësimi individual dhe zbatimi i masave parandaluese. Analiza e përjetimeve dhe nevojave të tyre gjatë pandemisë është thelbësore për të kuptuar si kufizimet institucionale, ashtu edhe mekanizmat personalë të përballimit.

Duke u mbështetur mbi këtë kontekst, ky studim ka për qëllim të vlerësojë sfidat dhe nevojat e pacientëve kronikë pranë qendrave shëndetësore në qytetin e Vlorës gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Përfundimet e studimit synojnë të kontribuojnë në përmirësimin e qasjeve të kujdesit shëndetësor për këtë grup të brishtë, si dhe të ofrojnë rekomandime për menaxhimin më efikas të situatave të ngjashme në të ardhmen.

Qëllimi i punimit

Të vlerësohet ndikimi i pandemisë COVID-19 në përjetimin e sfidave dhe identifikimin e nevojave të pacientëve me sëmundje kronike në raport me ofrimin e shërbimeve në qendrat shëndetësore të qytetit të Vlorës.

Objektivat specifike të punimit

Të identifikohen sfidat kryesore të pacientëve kronikë në aksesimin e kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19.

Të shqyrtohen vështirësitë në marrjen e barnave, vizitave mjekësore dhe shërbimeve diagnostikuese nga pacientët me sëmundje kronike gjatë periudhës së kufizimeve.

Të përshkruhen perceptimet dhe përvojat e pacientëve lidhur me funksionimin e qendrave shëndetësore gjatë krizës shëndetësore.

Të vlerësohet ndikimi i pandemisë në gjendjen psikologjike, stilin e jetesës dhe përkeqësimin e simptomave të sëmundjes.

Të analizohen nevojat prioritare të të sëmurëve kronikë për mbështetje shëndetësore dhe sociale në kushtet e pandemisë.

Të analizohen ndryshimet në menaxhimin e sëmundjes kronike gjatë periudhës së kufizimeve pandemike.

Hipotezat e punimit

H₁: Individët me sëmundje kronike kanë përjetuar vështirësi të konsiderueshme në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë COVID-19.

H₂: Ndërprerja e trajtimeve dhe vështirësitë në sigurimin e barnave kanë ndikuar negativisht në simptomat e sëmundjeve kronike.

H₃: Aksesimi i shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë është ndikuar ndjeshëm nga faktorë ekonomikë dhe logjistikë, përfshirë kufizimet në transport dhe funksionimin e qendrave shëndetësore.

H₄: Pacientët që kanë përjetuar ndërprerje të kujdesit shëndetësor gjatë pandemisë raportojnë nivele më të larta të stresit, ankthit dhe pasigurisë.

H₅: Pandemia COVID-19 ka ndikuar dukshëm në reduktimin e aktivitetit fizik dhe ndryshimin e zakoneve ushqimore të pacientëve me sëmundje kronike.

H₆: Pacientët me kontakt të kufizuar me ofruesit e kujdesit shëndetësor janë më të predispozuar të raportojnë përkeqësim të simptomave të sëmundjes.

Rezultatet


Analizimi i karakteristikave demografike të sëmurëve kronik të përfshirë në studim

Të dhënat e mbledhura përfshijnë një kampion prej 52 individësh, për të cilët është regjistruar moshë si një nga karakteristikat demografike bazë. Analiza statistikore përshkruese tregoi se moshë mesatare e pjesëmarrësve është 59.8 vjeç, duke sugjeruar një prirje drejt moshave të rritura dhe të moshuara. Kjo vlerë mbështetet edhe nga mesorja, e cila rezultoi 62.5 vjeç. Moshë më e vogël në kampion ishte 19 vjeç, ndërsa më e madhja në 87 vjeç, duke përfaqësuar një shtrirje të konsiderueshme moshore prej 68 vitesh. Në aspektin e shpërndarjes së të dhënave, devijimi standard (SD) = 15.75 vjeç tregon një shpërndarje të moderuar të vlerave rreth mesatares. Vlera më e shpeshtë e moshës ishte 69 vjeç, e cila përbën modën e shpërndarjes dhe tregon një përqendrim të lartë të pjesëmarrësve në këtë grupmoshë

Tabela 1. Karakteristikat statistikore të moshës tek të sëmurët kronik

Statistikat përshkruese për moshën	
Treguesi	Vlera
Numri total i pjesëmarrësve	52
Moshë mesatare	59.8
Mesorja	62.5
Moshë mbizotruese	69
Moshë më e vogël	19
Moshë më e madhe	87
Shtrirja (Range)	68
Devijimi standard (SD)	15.75


Grafiku 1. Shpërndarja sipas gjinisë e pacientëve kronikë



Nga të dhënat e grafikut 1 rezulton se përfaqësimi gjinor është pothuajse i balancuar, meshkuj ishin 27 pjesëmarrës (51.9%), ndërsa femra ishin 25

pjesëmarrëse (48.1%).

Grafiku 2. Shpërndarja e sëmundjeve kronike tek pjesëmarrësit



Përsa i përket komorbiditeteve rezulton se më shumë se gjysma e pjesëmarrësve (55.8%) vuajnë vetëm nga një sëmundje kronike, duke përfaqësuar grupin më të madh brenda kampionit. Në anën tjetër, 32.7% e pjesëmarrësve kanë raportuar se vuajnë nga dy sëmundje kronike, ndërsa 11.5% deklarojnë se kanë tre sëmundje kronike njëkohësisht. Këto gjetje tregojnë se një përqindje e konsiderueshme e individëve (pothuajse gjysma) përjetojnë komorbiditet, d.m.th. ekzistencën e më shumë se një sëmundje kronike në të njëjtin individ. Ky fenomen është veçanërisht i rëndësishëm për analizën e ndikimeve të mundshme në cilësinë e jetës, ngarkesën ekonomike dhe aksesin në kujdesin shëndetësor, veçanërisht në periudha krizash si pandemia COVID-19.

Tabela 2. Prevalenca e sëmundjeve kronike

	Prevalenca e sëmundjeve kronike (n=78)	
	Nr	Përqindja (%)
Diabet Mellitus (DM)	31	39.7%
Hipertension (HTA)	37	47.4%
Sëmundje Cardio-Vasculare (SCV)	6	7.7%
Sëmundje Renale Kronike (SRK)	2	2.6%
Sëmundje Pulmonare Obstruktive Kronike (SPOK)	2	2.6%

Nga tabela vërejmë se ndër sëmundjet kronike më të përhapurat ishte hipertensioni arterial (HTA), i raportuar nga 47.4% e pjesëmarrësve, duke u renditur

si sëmundja më e zakonshme në këtë grup studimi. Diabeti mellitus (DM) zuri vendin e dytë, i pranishëm në 39.7% të individëve të anketuar. Gjithashtu, sëmundjet kardiovaskulare (SCV) u raportuan nga 7.7% e pjesëmarrësve, ndërsa sëmundjet renale kronike (SRK) dhe sëmundja pulmonare obstruktive kronike (SPOK) ishin të pranishme në 2.6% të rasteve.

Tabela 3. Mesatarja e sëmundjeve sipas gjinisë

Gjinia	Nr pjesëmarrësve	Nr total i sëmundjeve	Mesatarja e sëmundjeve
Femër	25	37	1.48
Mashkull	27	41	1.52
Total	52	78	1.5

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën 3: Mesatarja e sëmundjeve sipas gjinisë, vërehet një shpërndarje relativisht e barabartë e pjesëmarrësve sipas gjinisë, me 25 femra dhe 27 meshkuj. Numri total i sëmundjeve të raportuara është 37 për femra dhe 41 për meshkujt, mesatarja e sëmundjeve të raportuara ndryshon lehtë mes grupeve. Femrat kanë një mesatare më të ulët të sëmundjeve (1.48) krahasuar me meshkujt (1.52), duke sugjeruar se, mesatarisht, femrat pjesëmarrëse në studim kanë raportuar më pak sëmundje kronike sesa meshkujt.

Tabela 4. Marrëdhënia midis moshës dhe numrit të sëmundjeve kronike

		Mosha	Nga sa sëmundje kronike vuani
Mosha	Pearson Correlation	1	.439**
	Sig. (2-tailed)		.001
	N	52	52
Nga sa sëmundje kronike vuani	Pearson Correlation	.439**	1
	Sig. (2-tailed)	.001	
	N	52	52

Për të vlerësuar lidhjen mes moshës dhe numrit të sëmundjeve kronike nga të cilat vuajnë pjesëmarrësit, u krye një analizë e koeficientit të korrelacionit Pearson. Rezultatet treguan se ekziston një lidhje pozitive statistikisht shumë domethënëse midis moshës dhe numrit të sëmundjeve kronike ($r = 0.439$, $p < 0.01$), çka tregon se me rritjen e moshës rritet edhe ngarkesa nga sëmundjet kronike.

Tabela 5. Marrëdhënia midis gjinisë dhe numrit të sëmundjeve kronike

		Gjinia	Nga sa sëmundje kronike vuani
Gjinia	Pearson Correlation	1	-.111
	Sig. (2-tailed)		.433
	N	52	52
Nga sa sëmundje kronike vuani	Pearson Correlation	-.111	1
	Sig. (2-tailed)	.433	
	N	52	52

Rezultatet e korrelacionit Pearson për të vlerësuar lidhjen ndërmjet gjinisë dhe numrit të sëmundjeve kronike të raportuara nga pjesëmarrësit, treguan një lidhje negative shumë të dobët dhe jo statistikisht të rëndësishme midis dy variablave ($r = -0.111$, $p = 0.43$), duke sugjeruar se gjinia nuk përbën një faktor të rëndësishëm në lidhje me numrin e sëmundjeve kronike në këtë kampion.

Analizimi i aksesit në qëndrat shëndetsore gjatë mbylljes nga Covid-19

Nga gjithsej 52 pjesëmarrës, 32 individë (61.5%) raportuan se kanë përjetuar një gjendje akute ose urgjente gjatë periudhës së mbylljes për shkak të COVID-19, ndërsa 20 individë (38.5%) raportuan se nuk kanë pasur një situatë të tillë. Këto të dhëna sugjerojnë se mbi gjysma e pacientëve kronikë janë përballur me nevojën të menjëhershme shëndetsore gjatë pandemisë. Ky është një tregues i rëndësishëm për rrezikshmërinë klinike që mbartin sëmundjet kronike, si dhe për nevojën që pacientët e tillë të kenë akses të pandërprerë në kujdes urgjent.

Grafiku 3. Përjetimi i gjendjeve akute ose urgjente gjatë mbylljes nga Covid-19




Tabela 6. Vështirësia në lidhje me aksesin në kujdesin shëndetësor gjatë pandemisë

Sa i vështirë ishte akses/ qasja në institucionin e kujdesit shëndetësor gjatë karantinës?	Frekuenca (n=52)	Përqindja
E lehtë	1	1.9%
Pak e vështirë	17	32.7%
Shumë e vështirë	34	65.4%

Nga të dhënat rezulton se një shumicë dërrmuese e pjesëmarrësve (98.1%) përjetuan vështirësi në aksesin ndaj kujdesit shëndetësor për situata akute ose urgjente gjatë periudhës së izolimit nga COVID-19. Konkretisht: 65.4% e pjesëmarrësve e përshkruan aksesin si “shumë të vështirë”, (32.7%) si “pak të vështirë” dhe vetëm (1.9%) e perceptuan aksesin si të lehtë.

Tabela 7. Funkcionimi i qëndrave shëndetsore gjatë mbylljes nga Covid-19

A funksiononte klinika/qendra shëndetsore në zonën/ lokalitetin tuaj gjatë mbylljes nga Covid-19?	Frekuenca (n=52)	Përqindja
Po	48	96.2%
Jo	2	3.8%
Nuk e di	2	0%

Në shumicën e rasteve (96.2%), pacientët raportuan se qendrat shëndetësore ishin funksionale gjatë periudhës së izolimit. Kjo është një gjetje pozitive dhe tregon një përpjekje të dukshme të sistemit shëndetësor për të ruajtur ofrimin e shërbimeve bazë, edhe gjatë një krize. 3.8% raportuan mos funksionim të qëndrës shëndetsore ndërsa ekzistenca e përgjigjeve si “Nuk e di” sinjalizon mungesë informacioni apo komunikimi efektiv me komunitetin, veçanërisht në zona rurale apo më të izoluar.

Tabela 8. Kënaqësia lidhur me aksesin në trajtim gjatë pandemisë

Sa të kënaqur jeni me aksesin për trajtim gjatë mbylljes?	Frekuenca (n=52)	Përqindja
0 (shumë të pakënaqur)	1	1.9%
1	2	3.8%
2	21	40.4%
3	18	34.6%
4	9	17.3%
5	1	1.9%
6 (shumë të kënaqur)	0	0%

Rezultatet e nxjerra treguan një nivel përgjithësisht të ulët të kënaqësisë me aksesin në trajtim gjatë izolimit pandemik. (40.4%) e pacientëve dhanë notën 2, dhe (34.6%) dhanë notën 3, në një shkallë ku 0 nënkupton


“shumë i pakënaqur” dhe 6 nënkupton “shumë i kënaqur”. Vetëm (17.3%) dhanë një notë më të lartë (4), dhe pjesa tjetër (5.7%) dhanë notat më të ulëta (0 ose 1). Kjo shpërndarje pasqyron një pakënaqësi të theksuar me aksesin shëndetësor, pavarësisht funksionimit të raportuar të qendrave shëndetësore.

Analizimi i statusit të Covid-19 në familje

Tabela 9. Diagnostikimi dhe trajtimi spitalor i pacientëve me Covid-19

A jeni diagnostikuar me Covid-19?	Diagnostikuar	Përqindja	Hospitalizuar	Përqindja
Po	45	86.5%	18	40%
Jo	7	13.5%	27	60%

Grafiku 4. Diagnostikimi dhe hospitalizimi për shkak të Covid-19



Nga të anketuarit (n=52), rezulton se 45 persona (86.5%) janë diagnostikuar me COVID-19, ndërsa 7 persona (13.5%) nuk janë diagnostikuar. Kjo tregon një përqindje të lartë të infektimit në mesin e të anketuarve, çka mund të lidhet me ekspozimin e lartë të këtij grupi ndaj faktorëve të rrezikut. Nga ata që janë diagnostikuar me COVID-19 (n=45), 18 të infektuar (40%) kanë patur nevojë për hospitalizim, ndërsa 27 persona (60%) e kanë kaluar sëmundjen pa pasur nevojë për kujdes spitalor. Mesatarja e ditëve të qëndrimit në spital për ata që janë hospitalizuar ishte 11.2 ditë, kjo tregon ashpërsinë e sëmundjes për rastet që kanë kërkuar trajtim spitalor.

Tabela 10. Diagnostikimi dhe hospitalizimi i familjarëve me covid-19

A ishte ndonjë nga pjestarët e familjes i diagnostikuar ose i hospitalizuar me Covid-19?	Diagnostikuar	Përqindja %	Hospitalizuar	Përqindja %
Po	34	65.4%	9	(26.5%)
Jo	18	34.6%	25	(73.5%)

Nga gjithsej 52 persona të anketuar, 34 prej tyre (65.4%) raportuan se një ose më shumë pjesëtarë të familjes së tyre janë diagnostikuar me Covid-19. Ndërkohë, 18 persone (34.6%) nuk kanë pasur ndonjë rast të tillë në familje. Nga grupi prej 34 personash që raportuan raste të familjarëve të diagnostikuar, vetëm 9 raste (26.5%) kanë përfunduar me hospitalizim. Shumica, pra 25 raste (73.5%), nuk kanë kërkuar shtrim në spital.

Mesatarja e ditëve të qëndrimit në spital për familjarët e hospitalizuar ishte 10.8 ditë, duke treguar një nivel të moderuar të ashpërsisë së sëmundjes për rastet që kanë kërkuar trajtim spitalor.

Tabela 11. Humbje familjare si pasojë e Covid-19


A ka vdekur ndonjë nga pjestarët e familjes tuaj si pasojë e Covid-19, dhe nëse po sa persona?	Frekuenca (n=52)	Përqindja %
Po	8	15.40%
Jo	44	84.60%

Nga gjithsej 52 persona të anketuar, 8 individë (15.4%) raportuan se kanë humbur një pjesëtarë të familjes si pasojë e infektimit me COVID-19. Ndërkohë, shumica e të anketuarve, 44 persone (84.6%), deklaruan se nuk kanë pasur raste vdekjeje në familjen e tyre të lidhura me COVID-19.

Analizimi i statusit shëndetsor dhe ndikimi i Covid-19 në gjëndjen kronike


Nga të anketuarit, 59.6% (n=31) kanë raportuar se kanë patur vështirësi në marrjen e barnave si pasojë e pandemisë Covid-19 për sëmundjen kronike, ndërsa 40.4% (n=21) nuk kanë raportuar vështirësi. (grafiku 5).

Grafiku 5. Vështirësia në sigurimin e barnave




Diabeti mellitus (DM) përbën sëmundjen më të përhapur, e raportuar nga 19 pjesëmarrës. Kjo tregon se pacientët me diabet kanë qenë veçanërisht të ndjeshëm ndaj ndërprerjeve të shërbimeve shëndetësore dhe vështirësive në furnizimin me barna. Hipertensioni arterial (HTA) është raportuar nga 12 persona, duke dëshmuar për një përhapje të konsiderueshme të sfidave edhe në menaxhimin e kësaj patologjie gjatë pandemisë. Ndërkohë, sëmundjet kardiovaskulare (SCV) janë raportuar nga 2 individë, SPOK nga 1 pjesëmarrës, çka sugjerojnë një prevalencë më të ulët në këtë mostër, por gjithsesi përfaqësojnë një kategori me rëndësi të veçantë klinike për shkak të riskut që paraqesin. (grafiku 6).

Grafiku 6. Shpërndarja e vështirësisë sipas sëmundjes




Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve raportoi vështirësi në marrjen e ilaçeve për shkak të problemeve financiare, konkretisht 36 (69.2%) të sëmurë kronik paten vështirësi ndërsa 16 persona (30.8%) nuk hasën vështirësi. (grafiku 7).

Grafiku 7. Vështirësitë financiare të pacientëve në marrjen e trajtimit gjatë COVID-19




Të dhënat e përpunuara tregojnë se pacientët me sëmundje kronike kanë përjetuar vështirësi të konsiderueshme në marrjen e trajtimit dhe barnave për shkak të gjendjes së rënduar ekonomike gjatë pandemisë COVID-19. Sipas të dhënave, Diabeti Mellitus (DM) përfaqëson sëmundjen më të përfshirë në raportimet e vështirësive, me 20 raste. Hipertensioni (HTA) me 15 raste që raportojnë vështirësi financiare për sigurimin e trajtimit. Sëmundjet kardiovaskulare (SCV) dhe pulmonare (SPOK) janë përmendur nga 1 rast për secilën nga pjesëmarrësit. (grafiku 8)

Grafiku 8.




Në grafikun numër 9 tregohen qëndrimet e të sëmurëve diabetik (n=31) sesa shpesh e kanë kontrolluar nivelin e glicemisë në shtëpi. Rezulton se 38.7% kryejnë këtë veprim një herë në javë, ndërsa 21.4% e kontrollojnë dy herë në muaj dhe 17.9%, deklaruan se nuk e monitorojnë fare nivelin e sheqerit në gjak në shtëpi. Vetëm një pjesë më e vogël e pacientëve deklaruan se e masin gliceminë në intervale më të shpeshta: 10.7% e bëjnë këtë dy herë në javë, ndërsa një përqindje e barabartë (10.7%) e mat çdo dy ditë. Ndërkohë, 7.1% e kryejnë kontrollin një herë në muaj, një frekuencë që në praktikën klinike konsiderohet jo e mjaftueshme për menaxhimin efektiv të diabetit.

Grafiku 9. Frekuenca e kontrollit të nivelit të glicemisë në shtëpi



Nga të diagnostikuarit me diabet mellitus (n=31), një shumicë dërrmuese prej 83.9% raportuan se e kanë kontrolluar nivelin e glicemisë gjatë mbylljes nga Covid-19, ndërkohë që 16.1% deklaruan se nuk e kanë kontrolluar.

Grafiku 10. Kontrolli i glicemisë gjatë mbylljes për shkak të Covid-19



Vlerat e raportuara të glicemisë treguan një mesatare prej 257.9 mg/dL, që sugjeron hiperglicemi të pakontrolluar tek shumica e pjesëmarrësve. Kufijtë varionin nga 170 mg/dL deri në 480 mg/dL, duke përfshirë vlera potencialisht të rrezikshme për komplikacione akute. Në grupin e diabetikëve 3 pjesëmarrës mendonin se niveli i glicemisë ishte nën kontroll.

Tabela 12. Kontrolli i HbA1c gjatë mbylljes nga Covid-19

A është kontrolluar HbA1c gjatë karantinës?		
Përgjigja	Frekuenca	Përqindja %
Po	12	38.7%
Jo	19	61.3%
Total	31	100%

Nga të dhënat e grumbulluara, rezultoi se vetëm 38.7% e pacientëve diabetikë deklaruan se kanë matur nivelin e HbA1c gjatë periudhës së izolimit, ndërsa shumica, 61.3%, nuk e kishin kryer këtë matje. Nga pacientët që kishin matur HbA1c një përqindje prej (29%) besonin se gjendja e tyre ishte nën kontroll, ndërsa 16.1% e vlerësuan si jashtë kontrolli, 32.3% nuk e dinin, ndërkohë, 22.6% e pjesëmarrësve raportuan vlera të matura të HbA1c, të cilat varionin nga 6.2% deri në 10.3%, me një mesatare prej 7.6%. Kjo mesatare tregon një prirje drejt hiperglicemisë. Vlera maksimale e regjistruar, 10.3%, sugjeron rrezik për zhvillimin e komplikacioneve.

Tabela 13. Përkeqësimi i simptomave të diabetit gjatë mbylljes nga Covid-19

A u përkeqësuan simptomat e diabetit gjatë mbylljes nga Covid-19?		
Përgjigja	Frekuenca	Përqindja %
Po	20	64.5%
Jo	6	19.4%
Nuk e di	5	16.1%
Total	31	100%

Shumica e pjesëmarrësve që vuanin nga DM, përkatësisht 64.5%, raportuan një përkeqësim të simptomave të diabetit apo niveleve të glikemisë gjatë mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19. Vetëm 19.4% pohuan se gjendja e tyre nuk ishte përkeqësuar, ndërsa 16.1% nuk ishin të sigurt për ndryshimet në simptomat e diabetit.

Tabela 14. Matja e presionit arterial gjatë karantinës

A e keni matur presionin arterial gjatë karantinës nga Covid-19?		
Përgjigja	Frekuenca	Përqindja %
Po	45	86.5%
Jo	7	13.5%
Total	52	100%

Sipas të dhënave të grumbulluara, rezultoi se edhe pse jo të gjithë hipertensivë shumica e të anketuarëve kishin matur presionin arterial. Konkretisht nga (n=52), 86.5% e kishin matur tensionin arterial gjatë mbylljes nga COVID-19, ndërsa vetëm 13.5% nuk e kishin bërë këtë matje. Ky rezultat tregon një ndërgjegjësim relativisht të mirë për monitorimin e presionit arterial edhe në kushte të izolimit,

veçanërisht për individët me hipertension ose rrezik kardiovaskular.

Bazuar nga raportimet e 45 individëve që kishin matur PA gjatë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19 u përlllogarit një mesatare e presionit sistolik prej 149.9 mmHg dhe një mesatare e presionit diastolik prej 91.7 mmHg. Të dyja këto vlera tejkalojnë kufijtë e sipërm të tensionit normal (120/80 mmHg), duke sugjeruar prani të gjendjeve të hipertensionit të pakontrolluar në shumicën e rasteve të raportuara. Kufijtë e regjistruar varionin nga 100/70 mmHg deri në 200/110 mmHg. Përveç matjeve objektive, 7 pjesëmarrës ofruan vlerësime subjektive të gjendjes së tensionit të tyre. Nga këta, 75% besonin se tensioni i tyre ishte "nën kontroll", ndërsa 25% nuk ishin të sigurt ("nuk e di")

Tabela 15. Frekuenca e matjes së presionit arterial

Kur e keni matur presionin arterial?		
Përgjigja	Frekuenca	Përqindja %
Çdo ditë	28	62.2%
Çdo javë	3	6.7%
Të çrregullt	14	31.1%
Total	45	100%

Nga të dhënat e mbledhura mbi kohështirjen e matjes së tensionit arterial gjatë periudhës së izolimit, rezultoi se 62.2% e pjesëmarrësve e kanë matur tensionin rregullisht, çdo ditë, duke treguar një nivel të mirë të vetëkujdesit në kushtet e mbylljes. Një pjesë më e vogël, 6.7%, raportuan matje periodike javore, ndërsa 31.1% në mënyrë të çrregullt.

Tabela 16. Përkeqësimi i simptomave të presionit arterial gjatë mbylljes nga Covid-19

A u përkeqësuan simptomat e presionit arterial gjatë mbylljes nga Covid-19?		
Përgjigja	Frekuenca	Përqindja %
Po	25	67.6%
Jo	12	32.4%
Total	37	100%


Rezultatet tregojnë se nga 37 pjesëmarrës që deklaruan se vuanin nga hipertensioni, gati dy të tretat (67.6%) e pjesëmarrësve raportuan një përkeqësim të simptomave të tensionit arterial gjatë periudhës së mbylljes për shkak të pandemisë COVID-19. Nga ana tjetër, 32.4% nuk vërejtën ndonjë ndryshim në gjendjen e tyre.

Tabela 17. Përjetimi i frikës në lidhje me infeksionin Covid-19

A keni përjetuar frikë në lidhje me infeksionin Covid-19?			
Përgjigja	Frekuenca		Përqindja %
Po	45		86.5%
Jo	7		13.5%
Total	52		100%

Të dhënat tregojnë një përqindje të lartë të pjesëmarrësve (86.5%) që raportuan se kanë përjetuar frikë ose ndjesi stigmatizimi lidhur me pandeminë COVID-19. Kjo pasqyron një ndikim psikologjik dhe social të situatës pandemike, ku ndjenja të tilla janë të lidhura jo vetëm me frikën nga infektimi, por edhe me stigmatizimin e mundshëm nga komuniteti për shkak të sëmundjes, simptomave, apo kontakteve me persona të infektuar. Përkundrazi kësaj, vetëm 13.5% nuk raportuan përjetim të frikës apo stigmatizimit, çka sugjeron se në një numër të vogël të rasteve ka pasur ndoshta më shumë mbështetje sociale, qasje më të mirë ndaj informacionit, ose qëndrueshmëri më të lartë psikologjike.

Grafiku 11. Mënyrat e përballimit të stresit gjatë Covid-19



Të dhënat tregojnë se 65.4% e pjesëmarrësve e kanë përballuar stresin me vështirësi, ndërsa 23.1% me pak vështirësi. Vetëm 7.7% raportuan se po përballeshin shumë mirë, dhe 3.8% e konsideruan stresin si të papërfillshëm.

Analizimi i statusit dhe kufizimeve të Covid-19 në zonën e banimit

Tabela 18. Informacion mbi rastet e infektimit nga Covid-19 në komunitet

A keni dëgjuar për raste të konfirmuar me Covid-19 në familje të tjera në zonën tuaj?		
Përgjigja	Frekuenca (n=52)	Përqindja (%)
Po	50	96.2%
Nuk e di	2	3.8%

Nga rezultatet e nxjerra 96.2% e pjesëmarrësve deklaruan se kishin dëgjuar për persona të infektuar të konfirmuar me COVID-19 brenda komunitetit të tyre, ndërsa vetëm 3.8% pohuan se nuk ishin të sigurt për këtë informacion. Kjo përqindje shumë e lartë tregon një shpërndarje të gjerë të informacionit apo prani të dukshme të rasteve pozitive në nivel komunitar, e cila mund të ketë ndikuar si në perceptimin e rrezikut personal, ashtu edhe në reagimet emocionale të popullatës gjatë pandemisë.

Tabela 19. Perceptimet e pacientëve kronik mbi lëvizshmërinë dhe kontaktet sociale gjatë karantinës nga Covid-19

Gjatë periudhës së karantinës nga COVID-19			
	Po	Jo	Nuk e di
A lejohej hyrja në lokalitetet e personave që nuk i përkisnin lagjes tuaj (familjare, miq) etj?	7 (13.5%)	40 (76.9%)	5 (9.6%)
A keni mundur të largoheni nga zona juaj e banimit për nevojat ushqimore ose furnizime të tjera?	30 (57.7%)	22 (42.3%)	0 (0%)
A ju nevojitej leje për të lënë qytetin/fshatin?	51 (98.1%)	1 (1.9%)	0 (0%)
A jeni mbledhur me fqinjët tuaj për aktivitete të ndryshme si: festa, shëtitje, praktika	0 (0%)	52 (100%)	0 (0%)

fetare, dasma, funerale?			
A keni vizituar shtëpinë e fqinjët në lagje (p.sh., për ushqim ose për të luajtur letrë)?	2 (3.8%)	50 (96.2%)	0 (0%)
A janë lejuar fëmijët në lagje të luajnë lirshëm jashtë?	11 (21.2%)	28 (53.8%)	13 (25%)

Gjetjet e tabelës reflektojnë kufizimet dhe sjelljet e komunitetit gjatë periudhës së karantinës të shkaktuar nga pandemia COVID-19. Sipas rezultateve, 98.1% e të anketuarve kanë raportuar se u është dashur të pajisen me leje për të lënë qytetin apo fshatin, çka tregon një zbatim rigoroz të masave kufizuese nga autoritetet. Gjithashtu, 76.9% deklaruan se nuk lejohej hyrja në lagje e personave që nuk ishin banorë të saj, duke përforcuar kufizimin e kontakteve me jashtë. Megjithatë, 57.7% e pjesëmarrësve deklaruan se kishin mundur të largoheshin nga zona e banimit për nevojat ushqimore apo furnizime të tjera, çka sugjeron se ndonëse kufizimet ishin të rrepta, ato nuk pengonin plotësisht qasjen në nevojat bazë. Në lidhje me kontaktet sociale, të dhënat tregojnë respektim të lartë të distancimit fizik: asnjë prej të anketuarve nuk raportoi se ishte mbledhur me fqinjët për aktivitete kolektive si festa apo praktika fetare, ndërsa 96.2% nuk kishin vizituar shtëpitë e fqinjëve, duke përjashtuar kontaktin edhe për arsye të nevojshme. Përsa i përket fëmijëve, 53.8% e të anketuarve deklaruan se nuk ishin lejuar të luanin lirshëm jashtë, ndërsa 21.2% raportuan të kundërtën, dhe një përqindje jo e vogël (25%) nuk ishin në dijeni.

Tabela 20. Qëndrimet e pacientëve kronikë ndaj masave parandaluese dhe rregullave të qeverisë për Covid-19

A e dini nëse masat e mëposhtme ishin rekomanduar nga qeveritë vendore/shtetërore/kombëtare për të kontrolluar përhapjen e Covid-19?			
	Po	Jo	Nuk e di

Larja e duarve	44 (84.6%)	5 (9.6%)	3 (5.8%)
Distancimi social	49 (94.3%)	2 (3.8%)	1 (1.9%)
Vendosja e maskës	52 (100%)	0 (0%)	0 (0%)
Pastrimi i frutave/perimeve përpara përdorimit	17 (32.7%)	17 (32.7%)	18 (34.6%)

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, rezulton se pjesa më e madhe e të sëmurëve kronikë ishin të vetëdijshëm për masat kryesore të rekomanduara nga autoritetet shëndetësore për parandalimin e përhapjes së COVID-19. Konkretisht, 100% e pjesëmarrësve e konsideronin vendosjen e maskës si një masë të rekomanduar nga qeveria, ndërsa 94.3% pranuan distancimin social dhe 84.6% larjen e duarve. Këto përqindje tregojnë një nivel të lartë ndërgjegjësimi për masat bazë të higjienës dhe mbrojtjes personale.

Megjithatë, një gjetje e veçantë e studimit lidhet me perceptimin mbi pastrimin e frutave dhe perimeve, ku vetëm 32.7% e konsideruan këtë si masë të rekomanduar, ndërsa pjesa tjetër ose nuk ishin të sigurt (34.6%), ose mendonin se nuk ishte e tillë (32.7%). Kjo tregon ekzistencën e një paqartësie në nivelin e informacionit publik lidhur me masat dytësore, të cilat nuk ishin të standardizuara në udhëzimet ndërkombëtare. Ky rezultat sugjeron se, ndonëse komunikimi mbi masat themelore ka qenë i qartë dhe i efektshëm, aspektet më të detajuara të higjienës nuk janë përcjellë në mënyrë të njëtrajtshme, duke krijuar boshllëqe në perceptimin e qytetarëve.

Tabela 21. Qëndrimet e pacientëve kronikë ndaj masës parandaluese të mbajtjes së maskës

A u kërkohej mbajtja e maskës kur dilnit nga shtëpia?		
Përgjigjia	Frekuenca	Përqindja (%)
Po	52	100%
Jo	0	0%
Nuk e di	0	0%

Të gjithë pjesëmarrësit (100%) deklaruan se u kërkohej të mbanin maskë në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës së pandemisë. Ky nivel unanim i përgjigjeve reflekton jo vetëm një zbatim të plotë të rregullave të përcaktuara nga autoritetet, por edhe një ndërgjegjësim të konsoliduar në komunitet për rëndësinë e mbrojtjes personale dhe kolektive.

Analizimi i gatishmërisë së masave parandaluese dhe domosdoshmërive të përditshme

Tabela 22. Aksesit i pacientëve kronikë në maska gjatë pandemisë Covid-19

A kishit mundësi të blinit dhe përdornit çdo lloj maske të përshtatshme gjatë Covid-19?		
Përgjigjia	Frekuenca	Përqindja (%)
Po	10	19.2%
Jo	34	65.4%
Nuk e di	8	15.4%

Nga të dhënat e grumbulluara, 65.4% e pjesëmarrësve raportuan se nuk kanë pasur mundësi të blejnë çdo lloj maske të përshtatshme në vend gjatë pandemisë, ndërsa vetëm 19.2% pohojnë se ky akses ka qenë i mundur. Pjesa tjetër (15.4%) shprehet se nuk e di nëse ky akses ishte realisht i mundur. Kjo shpërndarje sugjeron se mungesa e furnizimit me pajisje mbrojtëse, veçanërisht maskat, ka përbërë një sfidë të rëndësishme për të sëmurët kronikë gjatë valëve të para të pandemisë.

Tabela 23. Qëndrimet e pacientëve kronik ndaj disponueshmërisë së ushqimeve dhe furnizimeve gjatë pandemisë Covid-19

A i dispononit artikujt e mëposhtëm në zonën tuaj gjatë Covid-19?			
	Po	Jo	Nuk e di
Fruta të freskëta/prime	16 (30.8%)	36 (69.2%)	0 (0%)
Ushqime/furnizime (oriz, miell, vaj)	51 (98.1%)	1 (1.9%)	0 (0%)
Ushqime shtazore (vezë, mish, ushqime jo-vegjetariene)	33 (63.5%)	19 (36.5%)	0 (0%)

Të dhënat në tabelë pasqyrojnë perceptimin e të sëmurëve kronikë lidhur me disponueshmërinë e artikujve bazë ushqimorë në zonat ku ata banonin gjatë periudhës së pandemisë Covid-19. Rezultatet tregojnë se ushqimet bazë si orizi, mielli dhe vaji ishin më të disponueshmet, me 98.1% të pjesëmarrësve që pohuan se i kishin në dispozicion. Kjo tregon një furnizim të qëndrueshëm me produkte themelore për

përballimin e nevojave të përditshme. Megjithatë, vërehet një mungesë në disponueshmërinë e frutave të freskëta dhe perimeve, ku 69.2% e të anketuarve deklaruan se këto nuk ishin të disponueshme, ndërsa vetëm 30.8% raportuan se i kishin në dispozicion. Kjo përbën një shqetësim të veçantë për grupin e të sëmurëve kronikë, për të cilët dieta e balancuar është thelbësore për ruajtjen e shëndetit. Gjithashtu, ushqimet shtazore (si veza, mishi apo produktet jo-vegjetariene) rezultuan të pamjaftueshme për një pjesë të konsiderueshme të të anketuarve, me 36.5% që raportuan mungesën e tyre.

Tabela 24. Ndryshimet e çmimeve të artikujve të jetesës gjatë pandemisë Covid-19

A janë rritur çmimet për artikujt e përgjithshëm të jetesës në krahasim me periudhën para shfaqjes së Covid-19?		
Përgjigjia	Frekuenca	Përqindja (%)
Po	52	100%
Jo	0	0%
Nuk e di	0	0%

Rezultatet (100%) tregojnë se çmimet e artikujve të përgjithshëm të jetesës janë rritur krahasuar me periudhën para pandemisë COVID-19. Ky rezultat nënvizon një perceptim të qartë dhe të përbashkët për rritjen e kostos së jetesës, një dukuri që mund të lidhet me prishjen e zinxhirëve të furnizimit, rritjen e çmimeve të transportit dhe pasiguritë ekonomike që shoqëruan krizën globale shëndetësore. Kjo rritje e çmimeve ka të ngjarë të ketë ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës dhe aksesin në ushqime, veçanërisht për personat me të ardhura të kufizuara edhe si pasojë e gjëndjes së tyre kronike.

Nga rezultatet e marra shohim se 61.5% e pjesëmarrësve kanë pohuar se kanë dëgjuar për raste ku persona të caktuar nuk kanë mundur të sigurojnë ndihmë mjekësore. Një pjesë e tyre (38.5%) kanë pohuar se nuk janë përballur me/apo nuk kanë dijeni për raste të tilla.

Tabela 25. Pamundësia për të siguruar ndihmë mjekësore gjatë pandemisë Covid-19

A keni dëgjuar për ndonjë person që është detyruar të largohet nga qyteti për të marrë ndihmë mjekësore?		
Përgjigjia	Frekuenca	Përqindja (%)
Po	32	61.5%

Jo	20	38.5%
Nuk e di	0	0%

Ky rezultat hedh dritë mbi një aspekt të rëndësishëm të krizës së COVID-19: pengesat në qasjen ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Analizimi i Pasojave të Covid-19 në punësimin dhe të ardhurat e familjes

Tabela 26. Statusi i punësimit të pjesëmarrësve

A jeni aktualisht i/e punësuar?		
Përgjigjia	Frekuenca	Përqindja (%)
Pension	27	51.9%
Po	13	25%
Jo	12	23.1%

Nga pjesëmarrësit 51.9% ishin në pension, 25.0% ishin të punësuar, ndërsa 23.1% deklarorin të pa punë. Vihet re një prani e lartë e individëve në moshë pensioni në kampionin e studimit, çka mund të ketë patur një ndjeshmëri më të lartë ndaj sfidave të pandemisë si nga aspekti shëndetësor, ashtu edhe ekonomik. Një pjesë jo e vogël e papunë gjithashtu ngre shqetësime për ndikimin social dhe ekonomik të krizës së COVID-19 në grupet në moshë pune.

Nga 13 pjesëmarrës që pohuan se ishin të punësuar gjatë Covid-19, vetëm 7.7% kanë vazhduar të punojnë rregullisht gjatë periudhës së izolimit, ndërsa 38.5% raportuan se kanë qenë pa punë, dhe po aq deklaruan se kanë shkuar në punë më rrallë. Një përqindje më e vogël (15.4%) është angazhuar në punë nga shtëpia.

Tabela 27. Vazhdimësia e punës gjatë mbylljes nga Covid-19

A keni vazhduar të punoni gjatë periudhës së mbylljes për shkak të COVID-19?		
Përgjigjia	Frekuenca (n=13)	Përqindja (%)
Po	1	7.7%

Jo (pa punë)	5	38.5%
Vajta rrallë në punë	5	38.5%
Punë nga shtëpia	2	15.4%

Tabela 28. Ndikimi ekonomik i Covid-19

Gjatë periudhës së karantinës nga Covid-19			
	Po	Jo	Nuk e di
A keni përjetuar ju ose anëtarët në familjen tuaj humbje të punës si rezultat i Covid-19	31 (59.6%)	21 ((40.4%)	0 (0.0%)
A keni përjetuar ju ose anëtarët në familjen tuaj humbje të të ardhurave si rezultat i Covid-19	48 (92.3%)	4 (7.7%)	0 (0.0%)
A keni marrë ndonjë lloj mbështetje financiare nga qeveria	47 (90.4%)	5 (9.6%)	0 (0.0%)

Të dhënat pasqyrojnë një ndikim të ndjeshëm të pandemisë COVID-19 në mirëqenien ekonomike të pjesëmarrësve dhe familjeve të tyre. Rreth 59.6% raportuan humbje të vendit të punës, duke sinjalizuar pasiguri të theksuar në tregun e punës dhe mungesë elasticiteti ndaj krizave të papritura. Kjo situatë u përkeqësua më tej nga humbja e të ardhurave, e përjetuar nga 92.3% e të anketuarve, çka tregon se ndikimi financiar nuk kufizohej vetëm tek papunësia, por përfshinte edhe ata që vazhduan të punonin në kushte të reduktuara. Mbështetja institucionale ka rezultuar e mangët, pasi 90.4% kanë deklaruar se nuk kanë marrë asnjë ndihmë financiare nga qeveria.

Analizimi i statusit shëndetësor i të sëmurëve kronike

Tabela 29. Problemet me lëvizshmërinë gjatë pandemisë Covid-19

A keni hasur vështirësi në lëvizshmëri gjatë pandemisë Covid-19?		
Përgjigjia	Frekuenca (n=52)	Përqindja (%)

Nuk kam problem me ecjen	33	63.5%
Kam disa problem me ecjen	16	30.8%
Kam ngelur në shtrat	3	5.8%

63.5% e pjesëmarrësve nuk raportuan probleme me lëvizshmërinë, duke sugjeruar një gjendje të qëndrueshme fizike në shumicën e pacientëve kronikë të anketuar. Megjithatë, 30.8% pohuan se kanë pasur disa vështirësi me ecjen, ndërsa 5.8% deklaruan se kanë qenë të detyruar të qëndrojnë në shtrat. Kjo shpërndarje pasqyron se, ndonëse një pjesë e madhe e të sëmurëve kronikë ruajtën aftësinë për lëvizje, një përqindje e konsiderueshme përjetoi kufizime fizike që mund të jenë ndikuar nga vetë gjendja shëndetësore, mungesa e aktivitetit fizik, izolimi apo pamundësia për të aksesuar kujdesin shëndetësor të nevojshëm gjatë pandemisë.

Tabela 30. Kujdesi ndaj vetes gjatë pandemisë Covid-19

A keni hasur vështirësi në kujdesin ndaj vetes gjatë pandemisë Covid-19?		
Përgjigjia	Frekuenca (n=52)	Përqindja (%)
Nuk kam problem me kujdesin ndaj vetes	32	61.5%
Kam disa problem me kujdesin ndaj vetes	16	30.8%
Nuk jam në gjendje të kujdesem për veten	4	7.7%

Rezultatet tregojnë se 61.5% e pjesëmarrësve nuk kanë hasur vështirësi në kujdesin ndaj vetes, çka sugjeron një nivel të mirë funksional në aktivitetet bazë të përditshme për pjesën më të madhe të të anketuarve. Megjithatë, 30.8% raportuan disa probleme në kujdesin personal, dhe 7.7% deklaruan se nuk janë në gjendje të lahen apo të vishen vetë. Pra, edhe pse shumica ruajtën pavarësinë funksionale gjatë pandemisë, një pjesë e konsiderueshme e pacientëve kronikë përjetoi vështirësi në vetëkujdesje.

Tabela 31. Vështirësitë në kryerjen e aktiviteteve të zakonshme gjatë mbylljes nga Covid-19

A keni hasur vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të zakonshme gjatë mbylljes nga COVID-19?		
--	--	--

Përgjigjia	Frekuenca (n=52)	Përqindja (%)
Nuk kam problem me kryerjen e aktiviteteve të zakonshme	24	46.2%
Kam disa problem me kryerjen e aktiviteteve të zakonshme	21	40.4%
Nuk jam në gjendje të kryej aktivitetet e zakonshme	7	13.5%

46.2% e pjesëmarrësve nuk raportuan vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të zakonshme si pastrimi i shtëpisë, blerjet apo angazhimi në aktivitetet sociale të përditshme. Megjithatë, 40.4% thanë se kanë pasur disa vështirësi, dhe 13.5% pohuan se nuk kanë qenë në gjendje të kryejnë këto aktivitete. Pra, më shumë se gjysma e të sëmurëve kronikë janë prekur në funksionimin e tyre ditor gjatë pandemisë COVID-19.

Tabela 32. Përjetimi i dhimbjes dhe diskomfortit gjatë pandemisë Covid-19

A keni ndjerë dhimbje ose diskomfort gjatë pandemisë Covid-19?		
Përgjigjia	Frekuenca (n=52)	Përqindja (%)
Nuk kam dhimbje apo siklet	28	53.8%
Kam dhimbje ose siklet të moderuar	17	32.7%
Kam shumë dhimbje dhe siklet	7	13.5%

Nga të dhënat rezultoi se 53.8% e pjesëmarrësve nuk kanë përjetuar dhimbje apo diskomfort gjatë pandemisë, ndërsa 32.7% raportuan ndjesi dhimbjeje të moderuar dhe 13.5% pohuan se kanë përjetuar shumë dhimbje dhe siklet. Ndonëse shumica e pacientëve kronikë ruajtën një gjendje të qëndrueshme, një pjesë e konsiderueshme përjetoi dhimbje e diskomfort që, në mungesë mbështetjeje mjekësore apo aktiviteti fizik, mund të ketë ndikuar negativisht tek këta të sëmurë.

Tabela 33. Përjetimi i ankthit dhe depresionit gjatë pandemisë Covid-19

A keni përjetuar simptoma ankthi ose depresioni gjatë pandemisë Covid-19?		
Përgjigjia	Frekuenca (n=52)	Përqindja (%)

Nuk jam i shqetësuar apo i deshpëruar	12	23.1%
Jam mesatarisht në ankth dhe depresion	29	55.8%
Jam shumë në ankth dhe depresion	11	21.2%

Sipas rezultateve, 55.8% e pjesëmarrësve kanë raportuar nivel të moderuar ankthi dhe depresioni, ndërsa 21.2% kanë përjetuar gjendje shumë të rënduar emocionale. Vetëm 23.1% nuk kanë raportuar shqetësime të tilla. E gjithë kjo tregon një ngarkesë psikologjike në mesin e pacientëve kronikë gjatë pandemisë COVID-19.

Tabela 34. Karakteristikat statistikore të gjendjes shëndetësore të pacientëve kronike

Statistikat përshkruese për gjendjen e vetë-raportuar shëndetësore (0–100)	
Treguesi	Vlera
Numri total i pjesëmarrësve	52
Vlera mesatare	66.2
Mesorja e vlerave	65
Vlera mbizotruese	70
Vlera më e vogël	30
Vlera më e madhe	90
Shtrirja (Range)	60
Devijimi standard (SD)	12.52

Vlerësimi i përgjithshëm nga vetë pacientët kronikë për gjendjen shëndetësore të tyre rezultoi me një mesatare prej 66.2 pikësh (në një shkallë nga 1 në 100), me vlerën më të ulët 30 dhe më të lartën 90. Shumica e pjesëmarrësve e kanë vlerësuar veten në kufijtë mesatarë, duke reflektuar sfidat që lidhen me sëmundjen kronike dhe ndikimin e pandemisë në mirëqenien e tyre të përgjithshme.

Analizimi i çrregullimit të ankthit të përgjithësuar

Tabela 35. Shkalla e çrregullimit të ankthit të përgjithësuar

Sa shpesh keni qenë të shqetësuar nga problemet e mëposhtme?

	Aspak i sigurt	Disa ditë	Mbi gjysmën e ditëve	Gati çdo ditë
Ndjesi nervozizmi, ankthi	4 (7.7%)	26 (50%)	16 (30.8%)	6 (11.5%)
Nuk mund të ndaloj ose kontrolloj ankthin	8 (15.4%)	23 (44.2%)	13 (25%)	8 (15.4%)
Shumë i shqetësuar për shumë gjëra	6 (11.5%)	12 (23.1%)	25 (48.1%)	9 (17.3%)
Problem me relaksim	3 (5.8%)	16 (30.8%)	19 (36.5%)	14 (26.9%)
Shumë i shqetësuar sa vështirë të qëndroj në një vend	10 (19.2%)	28 (53.8%)	7 (13.5%)	7 (13.5%)
Të mërziturit ose nervozuarit lehtësisht	3 (5.8%)	14 (26.9%)	21 (40.4%)	14 (26.9%)
Të ndjerit i frikësuar sikur diçka e keqe mund të ndodhë	10 (19.2%)	22 (42.3%)	12 (23.1%)	8 (15.4%)

Ndjesia e nervozizmit dhe ankthit ishte një nga simptomat më të zakonshme, ku mbi 92% e pjesëmarrësve kanë deklaruar se e kanë përjetuar të paktën “disa ditë” në javë, ndërsa 42.3% e tyre raportuan shpeshtësi më të lartë (“mbi gjysmën e ditëve” deri “gati çdo ditë”).

Po ashtu, rreth 84.6% e pjesëmarrësve deklaruan se kanë patur vështirësi në ndalimin e kontrollit të ankthit në nivele të ndryshme.

Një shqetësim tjetër i theksuar është ai i të qenit i shqetësuar për shumë gjëra, ku mbi 88% e pjesëmarrësve shfaqën këtë ndjesi në mënyrë të përsëritur, me 65.4% që e përjetuan “mbi gjysmën e ditëve” deri “gati çdo ditë”.


Vështirësitë për t'u relaksuar ishin gjithashtu të pranishme tek shumica (94.2%), ndërsa më shumë se 60% raportuan se e kanë patur këtë problem në mënyrë të shpeshtë.

Ndjenja e shqetësimit të lidhur me pamundësinë për të qëndruar në vend ishte e pranishme tek rreth 80.8% e të anketuarve, por ajo paraqitet më shpesh në formën e lehtë ("disa ditë").

Gjithashtu, ndjeshmëria ndaj të mërzhiturit apo nervozizmit ishte e lartë, me mbi 93% që raportuan këtë simptomë, përfshirë 67.3% që e ndjenë shpesh. Së fundi, ndjenja e frikës se diçka e keqe mund të ndodhë preku mbi 80% të të anketuarve, ku rreth 38.5% e ndjenë këtë pothuajse çdo ditë.

Pra, ajo që vihet re është se ka patur një prevalencë të lartë të simptomave të ankthit në popullatën e anketuar, me intensitet të ndryshueshëm, por me një prani të qartë të gjendjeve të përsëritura të shqetësimit psikologjik.

Grafiku 12. Vështirësitë në punë, shtëpi dhe shoqërim gjatë pandemisë COVID-19



Të pyetur sesa e vështirë ka qënë të kryejnë punët e përditshme si, kujdesi për shtëpinë apo shoqërimi me të tjerët një përqindje e konsiderueshme e pjesëmarrësve (46.2%) kanë raportuar se ka qënë "shumë e vështirë". Për më tepër, 19.2% e tyre e kanë përshkruar përvojën e tyre si "ekstremisht të vështirë", duke evidentuar një ndikim të thellë funksional dhe emocional. Nga ana tjetër, vetëm 11.5% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë pasur aspak vështirësi, ndërsa 23.1% e kanë ndjerë vështirësinë në një masë më të lehtë. Këto rezultate tregojnë se mbi 80% e të sëmurve kronik të anketuar

kanë përjetuar një nivel të konsiderueshëm vështirësie në jetën e përditshme

Analizimi i ndikimit të Covid-19 në dietë dhe aktivitet fizik

Tabela 36. Zbatimi i planit ushqimor të kufizuar në kripë, sheqer dhe yndyrë

Sa ditë në javë keni ndjekur një plan ushqimor të kufizuar në kripë, sheqer ose yndyrë?		
Përgjigje	Frekuenca (n=52)	Përqindja %
0 ditë në javë	3	5.8%
1 ditë në javë	11	21.2%
2 ditë në javë	10	19.2%
3 ditë në javë	15	28.8%
4 ose më shumë ditë në javë	13	25%

Mbi gjysma e të anketuarve (≈54 %) deklaruan se i janë përmbajtur një diete me kripë, sheqer dhe yndyrë të kufizuar të paktën tri ditë në javë: grupi më i madh është ai prej 3 ditësh (28.8 %), i ndjekur nga ata që raportuan 4 ose më shumë ditë (25.0 %). Rreth dy të pestat (40.4 %) e zbatuan dietën vetëm një-dy ditë në javë, çka tregon prani të zakoneve të shëndetshme. Vetëm 5.8 % nuk kanë respektuar fare një plan diete.

Tabela 37. Frekuenca e modelit të çrregullt të ushqyerjes

Sa ditë në javë keni pasur model të çrregullt ushqyerjeje?		
Përgjigje	Frekuenca (n=52)	Përqindja %
0 ditë në javë	5	9.6%
1 ditë në javë	5	9.6%
2 ditë në javë	5	9.6%
3 ditë në javë	17	32.7%
4 ose më shumë ditë në javë	20	38.5%

Të dhënat tregojnë se një pjesë e madhe e të anketuarve me sëmundje kronike kanë përjetuar çrregullime në modelin e tyre të të ushqyerit. Konkretisht, 38.5% e pjesëmarrësve raportojnë se kanë pasur një model të çrregullt të ushqyerjes për katër ose më shumë ditë në javë, ndërsa 32.7% e tyre për tre ditë në javë. Vetëm një pakicë (9.6%) deklaroi se nuk ka përjetuar fare çrregullime në të ushqyer, gjë që tregon se për shumicën

e të anketuarve kronikë pandemia Covid-19 ka ndikuar negativisht në mënyrën se si ushqehen, ndoshta për shkak të izolimit, mungesës së aksesit në ushqime të shëndetshme apo stresit psikologjik.

Tabela 38. Ndryshimet në konsumin e frutave dhe perimeve gjatë karantinës

Gjatë karantinës, a ndryshoi sasia e frutave dhe perimeve të konsumuara krahasuar me periudhën para mbylljes?		
Përgjigje	Frekuenca (n=52)	Përqindja %
Po, konsumova më pak fruta/ perime	26	50%
Po, konsumova më tepër fruta/ perime	12	23.1%
Jo, konsumova të njëjtën sasi fruta/	14	26.9%

Rezultatet e paraqitura në tabelë tregojnë ndikimin e periudhës së karantinës në konsumin e frutave dhe perimeve nga të sëmurët kronikë. Sipas rezultateve, 50% e të anketuarve raportuan se kanë konsumuar më pak fruta dhe perime gjatë karantinës sesa më parë, çka sugjeron një përkeqësim të zakoneve ushqimore në këtë grup. Nga ana tjetër, vetëm 23.1% deklaruan se kishin rritur konsumin e këtyre produkteve të shëndetshme, ndërsa 26.9% pohuan se nuk ka pasur ndonjë ndryshim në sasinë e konsumuar. Këto të dhëna evidentojnë se pandemia COVID-19, përmes kufizimeve në lëvizje, aksesit në tregje dhe ndikimit psikologjik, ka ndikuar negativisht në cilësinë ushqimore të të sëmurëve kronikë.

Tabela 39. Frekuenca e aktivitetit fizik gjatë karantinës

Sa ditë në javë keni kryer aktivitet fizik të moderuar për më shumë se 10 minuta?		
Përgjigje	Frekuenca (n=52)	Përqindja %
0 ditë në javë	22	42.3%
1 ditë në javë	14	26.9%
2 ditë në javë	10	19.2%
3 ditë në javë	3	5.8%

4 ose më shumë ditë në javë	3	5.8%
-----------------------------	---	------

Vihet re një nivel i ulët i angazhimit në aktivitet fizik tek të anketuarit me sëmundje kronike. Konkretisht, 42.3% e tyre nuk kanë kryer asnjë ditë aktivitet fizik për më shumë se 10 minuta, ndërsa 26.9% janë aktivizuar vetëm një ditë në javë. Këto përqindje tregojnë se mbi dy të tretat e pjesëmarrësve kanë pasur një nivel shumë të kufizuar aktiviteti fizik. Vetëm një pjesë shumë e vogël e të anketuarve ka qenë më aktive: 5.8% kanë kryer aktivitet për katër ose më shumë ditë në javë, dhe po aq për tre ditë në javë. Kjo shpërndarje tregon se pandemia dhe kushtet e saj shoqëruese mund të kenë ndikuar negativisht në motivimin dhe mundësinë për të ushtruar aktivitet fizik, veçanërisht tek personat me sëmundje kronike.

Tabela 40. Ndryshimet në aktivitetin fizik gjatë karantinës

Gjatë mbylljes, a ndryshuan kohëzgjatja dhe intensiteti i aktivitetit fizik krahasuar me periudhën para saj?		
Përgjigje	Frekuenca (n=52)	Përqindja %
Ushtrua më pak aktivitet fizik	35	67.3%
Nuk ushtrova aspak aktivitet fizik	8	15.4%
Ushtrua të njëjtin aktivitet fizik	9	17.3%

Nga përfundimet e nxjerra duket se pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të ndjeshëm në uljen e aktivitetit fizik tek të sëmurët kronikë. 67.3% e të anketuarve deklaruan se kanë ushtruar më pak aktivitet fizik gjatë karantinës sesa para saj. Kjo përqindje tregon një rënie të qartë në nivelin e lëvizshmërisë dhe përfshirjes në aktivitet fizik. Nga ana tjetër, 17.3% raportuan se kanë mbajtur të njëjtin nivel aktiviteti, ndërsa 15.4% pohuan se nuk kanë ushtruar aspak aktivitet fizik gjatë kësaj periudhe. Kombinimi i këtyre të dhënave tregon se mbi 80% e pjesëmarrësve nuk kanë arritur të ruajnë një regjim të qëndrueshëm fizik gjatë izolimit.

Intervista

Gjatë analizës së intervistave të hapura të zhvilluara me pacientë me sëmundje kronike, u identifikuan disa tema kryesore që përshkruajnë sfidat, përjetimet dhe përshtatjet e tyre gjatë pandemisë COVID-19. Përgjigjet

e pjesëmarrësve nxorën në pah ndikimin e gjerë që pati pandemia jo vetëm mbi aspektet shëndetësore, por edhe mbi mirëqenien psikologjike, sociale dhe ekonomike të tyre.

Sfidat dhe përjetimet kryesore gjatë pandemisë:

Përjetimet e të intervistuarve zbulojnë një panoramë të ndërlikuar sfidash psikologjike dhe sociale gjatë pandemisë COVID-19.

Ndjenja e izolimit dhe vetmisë u shfaq si elementi më dominues, shpesh e shoqëruar me ankth, frikë dhe pasiguri të thellë, sidomos tek pacientët me sëmundje kronike afatgjata si diabeti, hipertensioni apo patologji të tjera bashkëshoqëruese. Shumë prej tyre e përshkruan mungesën e kontakteve me familjarët dhe miqtë si një humbje të ndjeshme të mbështetjes emocionale, duke theksuar se kjo boshllëkësi shoqërore rëndoi gjendjen e tyre psikologjike. Një tjetër dimension i përmendur gjerësisht lidhet me vështirësitë në sigurimin e shërbimeve shëndetësore të domosdoshme, të kufizuara nga masat e lëvizjes dhe reduktimi i aksesit në kujdesin mjekësor. Këto pengesa ushqyen ndjenja të vazhdueshme pasigurie, jo vetëm për shëndetin personal, por edhe për mirëqenien e të afërmeve. Siç e shpreh një prej pacientëve:

"Frika më e madhe ishte për fëmijët, për shkak të infektimit të shumë njerëzve në botë dhe në vendin tonë. Jam përballur me vetmi, ankth dhe stres të vazhdueshëm, edhe për faktin që nuk arrija të shihja as fëmijët e mi." (Pacienti 41)

Ky rrëfim personal, i ngjashëm me shumë të tjerë, pasqyron peshën emocionale të pandemisë dhe ilustron qartë se si izolimi, mungesa e kontaktit njerëzor dhe pasiguria shëndetësore u shndërruan në sfida themelore për pacientët kronikë.

Ndryshimet në rutinën e përditshme dhe përshtatjet e bëra gjatë pandemisë: Pandemia COVID-19 imponoi transformime të dukshme në rutinën e përditshme të pacientëve kronikë, duke ndikuar si në sjelljet higjieno-sanitare, ashtu edhe në aspektin social e emocional. Një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve theksuan se i kushtuan më shumë rëndësi higjienës personale, duke përfshirë larjen e shpeshtë të duarve, përdorimin e dezinfektantëve, vendosjen e maskës në hapësira publike dhe respektimin rigoroz të distancimit social. Këto masa u perceptuan si mjete të domosdoshme për mbrojtjen e

shëndetit individual dhe kolektiv. Siç shprehet një paciente:

"Jam përpjekur të zbatoj rregullat e caktuara, kam përforcuar higjienën ditore: larje të shpeshta të duarve, vendosja e maskës në ambientet me shumë njerëz, kam shmangur aq sa mundem grumbullimet dhe radhët e gjata nëpër ambiente publike, kam pastruar me kujdes frutat dhe zarzavatet. Mendoj se ruajtja e higjienës dhe masave parandaluese duhet të jetë obligim personal dhe kolektiv." (Pacientja 22)

Nga ana tjetër, kufizimi i aktiviteteve sociale, izolimi i zgjatur në shtëpi dhe ndalimi i lëvizjes së lirë u shoqëruan me ndikime të dukshme në gjendjen emocionale dhe mirëqenien psikologjike të pacientëve. Përveç masave parandaluese të rekomanduara, disa prej tyre iu drejtuan mënyrave alternative për të forcuar imunitetin, duke përfshirë përdorimin e vitaminave, çajrave natyralë dhe ndryshime të regjimit ushqimor. Kjo ilustron nga dëshmia e një pacienteje tjetër:

"Kam përdorur vitamina dhe çdo mbrëmje kam konsumuar çajra të ndryshëm me limon për përforcim të imunitetit." (Pacientja 6)

Këto rrëfime tregojnë se, përtej pasojave kufizuese, pandemia nxiti gjithashtu një ndërgjegjësim më të madh mbi rëndësinë e higjienës dhe të kujdesit personal, duke e bërë atë pjesë të pandashme të rutinës së përditshme të pacientëve.

Ndikimi pandemisë në menaxhimin e sëmundjeve kronike:

Pandemia COVID-19 pati një ndikim të ndjeshëm në mënyrën se si pacientët kronikë menaxhuan gjendjen e tyre shëndetësore. Pjesëmarrësit theksuan se frika dhe pasiguria i shtynë të tregoheshin më të kujdesshëm ndaj vetes, por njëkohësisht kufizimet e aksesit në shërbimet shëndetësore krijuan vështirësi të konsiderueshme në realizimin e vizitave mjekësore të rregullta dhe kryerjen e analizave laboratorike. Për më tepër, mungesa e mundësive për aktivitete fizike dhe kufizimi i lëvizjes ndikuan negativisht në rutinën e tyre të kujdesit shëndetësor. Kjo pasqyrohet në dëshminë e një pacienti:

"Vizitat tek mjeku ishin të vështira për t'u realizuar, analizat laboratorike rekomandoheshin por kryerja e tyre ishte e pamundur për shkak të mungesës së funksionimit të rregullt të shërbimit. Gjithashtu kam patur mungesa në kujdesjet personale dhe ushqimi im nuk ishte i rregullt; megjithatë, përpiqesha çdo ditë të realizoja pak lëvizje në ambientet e shtëpisë për të ruajtur aktivitetin fizik." (Pacienti 40)

Edhe pse furnizimi me medikamente u sigurua në pjesën më të madhe të rasteve, sfidat ekonomike të shkaktuara nga pandemia e rënduan procesin e trajtimit. Disa pacientë raportuan se kostot e ilaçeve u bënë të papërballueshme për shkak të të ardhurave të ulëta, veçanërisht kur kishin nevojë për trajtime shtesë gjatë periudhës së infektimit me COVID-19. Kjo vështirësi del qartë në rrëfimin e një pacienteje:

"Marrja e medikamenteve në përgjithësi nuk përbënte problem në vetvete, por kostot e tyre ishin të papërballueshme për shkak të të ardhurave të ulëta nga pensioni. Me infektimin nga Covid-19 kisha nevojë për ilaçe shtesë, kështu që mu desh të shpenzoja t'i siguroja në Tiranë, pasi për fat të keq farmacitë në Vlorë nuk kishin gjendje si pasojë e frikës – shumë njerëz i kishin blerë nga frika mos mbaronin." (Pacientja 11)

Këto dëshmi ilustrojnë qartë se, përtej kujdesit individual, pandemia ekspozoi kufizimet strukturore të sistemit shëndetësor dhe barrierat ekonomike, duke e bërë menaxhimin e sëmundjeve kronike edhe më sfidues për këtë kategori pacientësh.

Ndikimi pandemisë në jetesën ekonomike dhe edukimin e fëmijëve: Pandemia dhe masat e izolimit sollën pasoja të dukshme në jetesën ekonomike të familjeve të pacientëve kronikë, duke reduktuar ndjeshëm të ardhurat, sidomos në rastet kur anëtarët e familjes ishin të punësuar në sektorë të prekur nga mbyllja e aktiviteteve. Rritja e çmimeve dhe pamundësia për të siguruar të ardhura të qëndrueshme e rëndoi situatën ekonomike, ndërkohë që nevoja për kujdes shëndetësor shtesë e shtoi më tej barrën financiare. Siç e përshkruan një paciente:

"Mbyllja nga Covid-19 ndikoi negativisht në mënyrën e jetesës dhe të ardhurat tona, pasi çmimet e produkteve u rritën dhe në familje ishim pa punë, të izoluar në shtëpi. Im bir u infektua dhe duhej të qëndronte në shtëpi për dy javë, madje na u desh të thërrisnim çdo ditë doktorin për ta vizituar dhe bërjen e injeksioneve në kushtet e shtëpisë. Situata ishte e vështirë." (Pacientja 20)

Një tjetër fushë e ndikuar fuqimisht ishte edukimi i fëmijëve. Kalimi në mësim online u perceptua nga pjesëmarrësit si më pak efektiv krahasuar me mësimin në klasë, duke sjellë vështirësi në përvetësimin e njohurive dhe ruajtjen e ritmit të zakonshëm të studimit. Përveç kufizimeve pedagogjike, u theksuan edhe problemet teknologjike, si mungesa e pajisjeve

dhe aftësive për përdorimin e tyre, që rënduan situatën si për fëmijët edhe për prindërit. Një paciente e ilustron qartë këtë shqetësim:

"Mësimi online nuk është aspak efektiv sa mësimdhënia në shkollë, prandaj mendoj se mbyllja nga Covid ndikoi negativisht tek fëmijët sepse u bënë më të varur ndaj telefonit, gjithashtu kishte vështirësi në përdorimin e teknologjisë si për fëmijët edhe prindërit e tyre. Kam dëgjuar fëmijë që ankoheshin se nuk përshtateshin dot dhe sidomos fëmijët e vegjël të klasave të para vështirësoheshin më tepër. Mendoj se e gjithë kjo do të ketë pasoja afatgjata në formimin e fëmijëve." (Pacientja 23)

Frika dhe përjetimi i stigmatizimit gjatë pandemisë: Një element qendror i përjetimeve të pacientëve kronikë lidhej me frikën e infektimit, e cila shtrihej jo vetëm tek vetja, por edhe tek anëtarët e familjes dhe të afërmit. Kjo frikë shpesh shoqërohej me ankth dhe pasiguri të vazhdueshme, veçanërisht në rastet kur brenda familjes kishte persona të prekur nga COVID-19. Përjetimi emocional merrte nganjëherë formën e makthit, duke reflektuar perceptimin e pandemisë si një kërcënim serioz për jetën, sidomos tek ata që vuanin nga patologji kronike. Një pacient e përshkruan kështu këtë ndjesi:

"Po, kam përjetuar frikë si të gjithë. Frika më e madhe që më kapte gjatë mbylljes nga Covid-19 ishte shëndeti dhe jeta e familjarëve dhe të afërmeve të mi, aq sa në momente të caktuara shndërrohej në makth. Pandemia kishte pasoja serioze, kjo vihej re në humbjet e jetës së shumë personave, në Itali ku flitej shumë kisha fëmijët e shumë të afërm. Tmerrohesha kur dëgjoja që kishte persona që vdisnin nga COVID-19, sidomos kur mbartnin sëmundje kronike." (Pacienti 30)

Megjithatë, nga rrëfimet e të intervistuarve nuk u evidentuan raste të qarta të stigmatizimit të drejtpërdrejtë nga komuniteti për shkak të infektimit, çka sugjeron se dimensionin emocional i përjetuar lidhej më shumë me frikën dhe pasigurinë personale, sesa me qëndrime stigmatizuese nga të tjerët.

Mësime dhe reflektime të nxjerra nga situata pandemike: Nga përjetimet e tyre gjatë pandemisë, pacientët kronikë nxorën disa mësim dhe reflektime me vlerë, të cilat i shndërruan në udhërrëfyes për jetën e tyre të përditshme. Kujdesi për shëndetin u perceptua si një vlerë themelore dhe jo si një praktikë e rastësishme, ndërsa ruajtja e lidhjeve familjare dhe sociale u përjetua si burim i pazëvendësueshëm mbështetjeje dhe force në

përballimin e vështirësive. Situata e jashtëzakonshme e pandemisë u interpretua prej tyre si një moment vetëdijësimi mbi domosdoshmërinë e solidaritetit, e cila u bë e dukshme si në kujdesin për veten, ashtu edhe në përgjegjësinë për të tjerët. Një pjesëmarrës e përmblodhi këtë ndjesi në mënyrë të thjeshtë, por kuptimplotë:

“Duhet të duam veten dhe të tjerët përreth nesh dhe të kujdesemi më shumë për shëndetin.” (Pacienti 31)

Këto reflektime evidentojnë se, pavarësisht pasojave të rënda shëndetësore, psikologjike dhe ekonomike, pandemia shërbeu edhe si një përvojë transformuese, duke rritur ndjeshmërinë ndaj vlerës së jetës, kujdesit të përbashkët dhe rëndësisë së shëndetit si kapitali më i çmuar i individit dhe i komunitetit.

Roli infermieror në parandalimin e dëmtimeve fizike gjatë hospitalizimit të pacientëve geriatrikë

Kristi Metushi (2025)

Program i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Shkenca Infermierore"

Udhëheqës shkencor: Vasilika Prifti, Doktorande

Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakt

Një rënie përkufizohet si "një ngjarje që rezulton në rënien e një personi pa dashje në tokë apo në një sipërfaqe tjetër më të ulët". Rëniet janë ndër problemet më të zakonshme dhe më serioze të shëndetit publik tek të moshuarit, të cilat zakonisht ndodhin gjatë aktiviteteve rutinë të përditshme por edhe gjatë hospitalizimit të tyre. Parandalimi i rënieve tek të moshuarit përbën një çështje thelbësore që kërkon vëmendje të veçantë për shkak të ndikimit të saj në shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Roli i infermierisë në parandalimin e rënieve është thelbësor për garantimin e sigurisë dhe kujdesit ndaj të moshuarve.

Qëllimi i studimit është vlerësimi i rolit të infermierëve në parandalimin e dëmtimeve fizike gjatë hospitalizimit të pacientëve geriatrikë, duke analizuar praktikën e kujdesit infermieror, njohuritë dhe qëndrimet, me qëllim që të ndërhyet. Studimi është i tipit kros-seksional dhe u zhvillua në periudhën Prill-Qershor, 2025. Në studim u përfshinë infermierët e punësuar në Spitalin Rajonal Vlorë. Për mbledhjen e të

dhënave u përdor platforma elektronike Google forms e aksesueshme nga të gjithë. Instrumenti i mbledhjes së të dhënave ishte pyetësor i vetëadministruar që përfshinte pesë seksione: të dhënat socio-demografike, njohuritë e infermierëve, qëndrimet dhe praktikën e tyre në lidhje me parandalimin e dëmtimeve dhe seksioni i fundit për njohuritë mbi vlerësimin e rrezikut për rrëzim.

Rezultatet: Në studim u përfshinë 72 infermierë të Spitalit Rajonal Vlorë, prej të cilëve 77.8% i përkasin gjinisë femërore dhe 22.2% gjinisë mashkullore. 22.2% i përkasin grupmoshës 20-29 vjeç, 47.2% grupmoshës 30-39 vjeç, 25% grupmoshës 40-49 vjeç dhe pjesa e ngjatur 5.6% i përkasin grupmoshës më shumë se 50 vjeç. 69.4% nuk kanë ndjekur trajnime që të përfshinin parandalimin e rrëzimeve dhe pjesa e mbetur 30.6% kanë ndjekur trajnime që përfshinin këtë tematikë. 75% e infermierëve i njohin shkallët/mjetet e vlerësimit për rrëzim, ndërsa 8.3% e tyre nuk i njohin ato. 30.5% e tyre kanë përdorur Tinetti Balance & Gait Assessment, 16.7% Morse Fall Scale, 2.8% Hendrich II Fall Risk

Model dhe 2.8% kanë përdorur mjete të tjera. Ndërkohë 47.2% e të cilëve nuk kanë përdorur asnjëherë mjete për të vlerësuar rrezikun për rrëzim. 91.7% e infermierëve të marrë në studim tregojnë se mjetet e përdorura për parandalimin e rrëzimeve kanë një efikasitet të mirë dhe janë shumë të dobishme për minimizimin e këtyre rasteve. Vetëm 8.3% janë përgjigjur se këto mjete janë disi të rëndësishme në parandalimin për rrëzim.

Konkluzione: Rezultatet tregojnë një tendencë më të lartë përdorimi të mjeteve të vlerësimit të rrezikut për rënie nga meshkujt, pavarësisht përfaqësimit më të ulët të tyre në studim. Po ashtu niveli arsimor rezulton të jetë një faktor ndikues, pasi profesionistët me arsim më të lartë (Master/PhD) tregojnë prirje më të madhe drejt përdorimit të këtyre mjeteve krahasuar me ata me nivel bachelor. Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për përdorimin e mjeteve të vlerësimit të rrezikut për rrëzim përbën një pengesë të rëndësishme në praktikën infermiore.

Fjalët kyç: Pacientë Geriatrikë, infermierë, hospitalizim, dëmtim fizik, parandalim

Abstract

Introduction: A fall is defined as "an event that results in a person unintentionally coming to rest on the ground or a lower surface." Falls are among the most common and serious public health problems in older adults, often occurring during routine daily activities as well as during hospitalization. Preventing falls in the elderly is a critical issue that requires special attention due to its impact on their health and well-being. The role of nursing in fall prevention is essential for ensuring the safety and care of older adults.

Aim: To evaluate the role of nurses in preventing physical injuries during the hospitalization of geriatric patients, by analyzing nursing care practices, knowledge, and attitudes, with the aim of informing interventions.

Methodology: This cross-sectional study was conducted between April and June 2025. It included nurses employed at the Vlorë Regional Hospital. Data were collected via the electronic platform Google Forms, accessible to all participants. The data collection instrument was a self-administered questionnaire comprising five sections: socio-

demographic information, nurses' knowledge, attitudes and practices regarding injury prevention, and a section on knowledge of fall risk assessment.

Results: A total of 72 nurses from Vlorë Regional Hospital participated in the study, of whom 77.8% were female and 22.2% male. Age distribution was as follows: 22.2% aged 20–29 years, 47.2% aged 30–39 years, 25% aged 40–49 years, and 5.6% aged over 50 years. 69.4% had not attended training that included fall prevention, while 30.6% had participated in such training. 75% of nurses were familiar with fall risk assessment tools, whereas 8.3% were not. Regarding usage, 30.5% had used the Tinetti Balance & Gait Assessment, 16.7% the Morse Fall Scale, 2.8% the Hendrich II Fall Risk Model, and 2.8% other tools. Meanwhile, 47.2% had never used any tools to assess fall risk. 91.7% of nurses reported that the tools used for fall prevention are effective and very useful in minimizing such incidents, while only 8.3% considered them somewhat important.

Conclusions: The results indicate a higher tendency for male nurses to use fall risk assessment tools, despite their lower representation in the study. Educational level also appears to be an influential factor, as professionals with higher education (Master/PhD) tend to use these tools more than those with a bachelor's degree. The lack of continuous training in the use of fall risk assessment tools represents a significant barrier in nursing practice.

Keywords: Geriatric patients, nurses, hospitalization, physical injury, prevention

Qëllimi i studimit

Vlerësimi i rolit të infermierëve në parandalimin e dëmtimeve fizike gjatë hospitalizimit të pacientëve geriatrikë, duke analizuar praktikën e kujdesit infermieror, njohuritë dhe qëndrimet, me qëllim që të ndërhyet.

Objektivat e studimit


1. Identifikimi i të dhënave socio-demografike të infermierëve pjesëmarrës në studim.
2. Vlerësimi i njohurive të infermierëve në lidhje me parandalimin e rrëzimeve.
3. Vlerësimi i qëndrimeve të infermierëve në lidhje me parandalimin e rrëzimeve.

4. Vlerësimi i praktikave të infermierëve në lidhje me parandalimin e rrëzimeve.
5. Identifikimi i njohurive të infermierëve mbi vlerësimin e rrezikut për rrëzim.

Rezultatet


Në studim morën pjesë 72 Infermierë të Spitalit Rajonal Vlorë, prej të cilëve 77.8% i përkasin gjinisë femërore dhe 22.2% gjinisë mashkullore.

Grafiku 1: Gjinia




Grafiku 2: Lidhja midis gjinisë dhe përdorimit të mjeteve për vlerësimin e rrezikut për rrëzim.

Grafiku 2: Lidhja midis gjinisë dhe përdorimit të mjeteve për vlerësimin e rrezikut për rrëzim



Nga të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm vihet re një ndarje e barabartë (38.9%) midis infermiereve femra në lidhje me përdorimin e mjeteve për vlerësimin e rrezikut për rrëzim. Nga ana tjetër infermierët meshkuj kanë përqindje më të ulët të pjesëmarrjes, por brenda këtij grupi, një pjesë e madhe (13.9%) përdorin mjete krahasuar me ata që nuk i përdorin (8.3%). Kjo tregon se ndonëse pjesëmarrja mashkullore është e ulët, ata që janë të përfshirë kanë një prirje më të lartë për të përdorur mjete për vlerësimin e rrezikut për rrëzim.

Grafiku 3: Moshë




Në bazë të të dhënave të paraqitura në grafik evidentohet një larmishmëri grupmoshash, ku 22.2% i përkasin grupmoshës 20-29 vjeç, 47.2% grupmoshës 30-39 vjeç, 25% grupmoshës 40-49 vjeç dhe pjesa e ngelur 5.6% i përkasin grupmoshës më shumë se 50 vjeç.

Grafiku 4: Përvoja në punë.




Në bazë të grafikut të mësipërm mbi përvojën në punë të Infermierëve që morën pjesë në studim evidentohet se 5.6% e tyre kanë më pak se 1 vit përvojë pune, 30.6% kanë 1-5 vite përvojë, 38.9% kanë 6-10 vite përvojë, 11.1% kanë 11-15 vite përvojë dhe pjesa e mbetur 13.9% kanë më shumë se 15 vite përvojë pune.

Grafiku 5: Niveli Arsimit.



Grafiku i mësipërm pasqyron qartë se 33.3% e Infermierëve kanë përfunduar studimet Bachelor dhe pjesa tjetër, e cila përbën dhe përqindjen më të madhe të kampionit kanë përfunduar studimet Master ose PhD.

Grafiku 6: Lidhja midis nivelit arsimor dhe përdorimit të mjeteve për vlerësimin e rrezikut për rrëzim.



Të dhënat në grafikun 6 tregojnë se ekziston një lidhje e ngudhtë midis nivelit arsimor dhe përdorimit të mjeteve për vlerësimin e rrezikut për rrëzim. Infermierët me Master ose PhD raportojnë një përdorim të lartë të këtyre mjeteve, 41.7% që i përdorin ato kundrejt vetëm kundrejt 25% që nuk i përdorin ato. Në të kundërt, midis infermierëve me diplomë Bachelor vetëm 11.1% i përdorin mjetet e vlerësimit ndërsa 22.2% nuk i përdorin ato.

Grafiku 7: A keni ndjekur ndonjë trajnim që përfshinte parandalimin e rrëzimeve?



Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e mësipërm vërejmë se pjesa më e madhe e kampionit 69.4% nuk kanë ndjekur trajnime që të përfshinin parandalimin e rrëzimeve dhe pjesa e mbetur 30.6% kanë ndjekur trajnime që përfshinin këtë tematikë.

Tabela 2: Njohuritë e Infermierëve lidhur me parandalimin e rrëzimeve.

Nr.		PO	JO
1	A e dini që shkalla e përsëritjes së rrëzimeve është e lartë te ata që janë rrëzuar më parë?	100%	0%
2	A ka politika për parandalimin e rrëzimeve në spitalin tuaj?	50%	50%
3	A ekziston një komision për rrëzimet në spitalin tuaj?	25%	75%
4	A jeni në dijeni që parandalimi i rrëzimeve është një nga objektivat e sigurisë së Joint Commission International Accreditation?	52.8%	47.2%
5	A e dini çfarë ndodh kur një pacient rrëzohet?	100%	0%
6	A raportoni gjithmonë incidentet e rrëzimit?	88.9%	11.1%
7	A e përdorni mjetin e vlerësimit të rrezikut të rrëzimeve (Modified Morse Fall Risk) për të identifikuar pacientët me rrezik të lartë?	55.6%	44.4%
8	A mendoni se rrëzimet mund të ndikojnë në cilësinë e jetës së pacientëve?	88.9%	11.1%
9	A jeni në dijeni se rrëzimet mund të çojnë në shtrime të panevojshme në kujdesin akut?	91.7%	8.3%
10	A bashkëpunoni me anëtarët e ekipit ndërdisiplinar dhe me pacientin/familjarin për të qenë të suksesshëm në parandalimin e rrëzimeve?	91.7%	8.3%
11	A e konsideroni parandalimin e rrëzimeve si një aspekt të rëndësishëm të punës tuaj?	100%	0%
12	A mendoni se rrëzimet rrisin nivelin e vdekshmërisë të të moshuarit?	77.8%	22.2%
13	A e dini që frakturat e rajonit kokso femoral mund të ndodhin si pasojë e rrëzimeve?	77.8%	22.2%
14	A mendoni se rrëshqitja nuk konsiderohet rrëzim?	30.6%	69.4%
15	A besoni se sa më shumë medikamente të përdorë një person, aq më i lartë është rreziku për rrëzim?	30.6%	69.4%
16	A mendoni se depresioni nuk lidhet me rrëzimet?	50%	50%
17	A mendoni se sa më shumë sëmundje të ketë një person, aq më i lartë është rreziku për rrëzim?	36.1%	63.9%
18	A mendoni se personat me dëmtime të shikimit kanë rrezik më të lartë për rrëzim?	94.4%	5.6%
19	A mendoni se mpirja e gjymtyrëve nuk ka lidhje me rrëzimet?	33.3%	66.7%

Tabela e mësipërme paraqet të dhënat e përfituara nga seksioni mbi njohuritë e Infermierëve lidhur me parandalimin e rrëzimeve. Këto të dhëna tregojnë se 100% e Infermierëve mendojnë se shkalla e përsëritjes së rrëzimeve është e lartë te ata që janë rrëzuar më parë, duke treguar vetëdije të plotë për faktin se një histori e mëparshme rrëzimi rrit rrezikun e përsëritjes. Për sa i përket prezencës së politikave për parandalimin e rrëzimeve në spital, 50% e Infermierëve tregojnë se ekzistojnë të tilla politika në vendin e tyre të punës dhe 50% të tjerët shprehen për mosekzistencën e tyre. Ndërsa për sa i përket ekzistencës së komisioneve për rrëzimet në spital 25% janë në dijeni për praninë e tyre dhe 75% tregojnë se në spital nuk ekzistojnë komisione të tilla, gjë e cila tregon se këto komisione nuk janë funksionale ose personeli infermior nuk ka dijeni për praninë e tyre. Vetëm 52.8% e Infermierëve janë në dijeni që parandalimi i rrëzimeve është një nga objektivat e sigurisë së Joint Commission International Accreditation dhe pjesa tjetër prej 47.2% nuk janë në dijeni, gjë që vërteton një nivel të moderuar informimi mbi standardet ndërkombëtare të sigurisë. E rëndësishme është që të gjithë pjesëmarrësit (100%) e dinë çfarë ndodh kur një pacient rrëzohet duke njohur mirë pasojat e rrëzimeve, por vetëm 88.9% i raportojnë gjithmonë këto incidente dhe 11.1% nuk i raportojnë.

Kjo tregon se ndonëse shumica ndjek rregullisht protokollet ekziston një pjesë e vogël që nuk ndjek procesin e raportimit.

55.6% e Infermierëve përdorin mjete për vlerësimin e rrezikut për rrëzim, ndërsa 44.4 % nuk i përdorin ato. Ndërkohë 88.9% e Infermierëve mendojnë dhe besojnë se rrëzimet ndikojnë në cilësinë e jetës së pacientëve duke treguar vetëdije të lartë për pasojat fizike dhe psikologjike të rrëzimeve. Nga ana tjetër 91.7% e tyre deklaruan se janë në dijeni që rrëzimet mund të cojnë në shtrime të panevojshme nën kujdesin akut. Po ashtu 91.7% e tyre tregojnë se bashkëpunojnë

me anëtarët e ekipit ndërdisiplinar dhe me pacientin/familjarin për të qënë të suksesshëm në parandalimin e rrëzimeve, cka reflekton një frymë bashkëpunimi dhe përgjegjësie të përbashkët në kujdesin geriatrikë. Të gjithë Infermierët (100%) e konsiderojnë parandalimin e rrëzimeve si një aspekt të rëndësishëm të punës së tyre.

Shumica e Infermierëve janë të vetëdijshëm për pasojat serioze të rrëzimeve, ku 77.8% besojnë se rrëzimet rrisin nivelin e vdekshmërisë, dhe po aq mendojnë se frakturat e rajonit kokso-femoral mund të vijnë si pasojë e rrëzimit. Për sa i përket ndikimit të medikamenteve në rrezikun për rrëzim 69.4% mendojnë se nuk ka ndikim midis sasisë së marrjes së medikamenteve dhe rrezikut për rrëzim, po ashtu dhe 63.9% e tyre nuk mendojnë se numri i sëmundjeve të një patienti ka ndikim në rrezikun për rrëzim. Ndërsa për sa i përket ndikimit të dëmtimit të shikimit dhe mpirjes së gjymtyrëve në rrezikun për rrëzim, shumica e infermierëve mendojnë se këto dëmtime rritin rrezikun për rrëzime. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është aspekti psikologjik, ku 50% e Infermierëve nuk e lidhin depresionin me rënien dhe pjesa tjetër tregojnë se ekziston një lidhje midis depresionit dhe rënies. Kjo gjë reflekton një mungesë të njohurive mbi këtë aspekt, pasi lidhja midis depresionit dhe rrëzimeve të pacientëve geriatrikë është e vërtetuar shkencërisht.

Tabela 3: Qëndrimet e Infermierëve në lidhje me parandalimin e rrëzimeve.

Nr.		QËNDRIM POZITIV	QËNDRIM NEGATIV
1	Jam i shqetësuar për rrëzimet e pacientëve.	100%	0%
2	Mendoj se rrëzimet e pacientëve janë të paevitueshme.	25%	75%
3	Mendoj se Infermierët janë përgjegjës për rrëzimet e pacientëve.	13.9%	86.1%
4	Kam shqetësim në lidhje me ndërhyrjet për parandalimin e rrëzimeve.	63.9%	36.1%
5	Parandalimi rrëzimeve është përparësi në ndërhyrjen infermierore.	91.7%	8.3%
6	Përditësimet dhe edukimi në parandalimin e rrëzimeve janë të nevojshme për përmirësimin e programit.	91.7%	8.3%
7	Duhet të vlerësoj të gjithë patientët për rrezikun e rrëzimit gjatë pranimit dhe cdo dite.	94.4%	5.6%
8	Rreziku i rrëzimit të një patienti duhet të vlerësohet kur është i shtruar në spital.	72.2%	27.8%
9	Edukimi i patientit në lidhje me parandalimin e rrëzimit është i rëndësishëm.	100%	0%
10	Ndërhyrjet për parandalimin e rrëzimit duhet të jenë të përshtatura për secilin patient.	83.3%	16.7%
11	Mjedisi spitalor nuk është i sigurt për parandalimin e rrëzimit.	30.6%	69.4%
12	Lëndimi fizik nuk është i rëndë edhe nëse ndodh një rrëzim.	25%	75%
13	Nëse ndodh një dëmtim , rrëzimi ka pak rëndësi.	19.4%	80.6%
14	Frika nga rrëzimi ka ndikim të madh.	91.7%	8.3%
15	Ndihem fajtor nëse patienti im rrëzohet.	72.2%	27.8%
16	Kam besim në aftësinë time për të parandaluar rrëzimet.	83.3%	16.7%
17	Kam nevojë për më shumë trajnim për parandalimin e rrëzimeve.	91.7%	8.3%
18	Parandalimi i rrëzimeve duhet të jetë përparësi e lartë.	97.2%	2.8%
19	Rrëzimet ndodhin për shkak të pacientëve.	25%	75%

Tabela e mësipërme paraqet të dhënat e përfituara nga seksioni mbi qëndrimet e infermierëve lidhur me parandalimin e rrëzimeve. Të dhënat tregojnë se të gjithë infermierët (100%) shprehën shqetësim për rrëzimet e pacientëve gjatë hospitalizimit të tyre. Për më tepër, 63.9% e tyre raportuan se ndihen të shqetësuar edhe në lidhje me ndërhyrjet për parandalimin e rrëzimeve. Sa i përket qëndrimeve të infermierëve, 25% e tyre e konsideruan rrëzimin e pacientëve si një ngjarje të pashmangshme, ndërsa 75% nuk e mbështesin këtë qëndrim, duke sugjeruar se shumica e tyre besojnë mundësinë reale të parandalimit të rrëzimeve përmes praktikave të strukturuar të kujdesit. Vetëm 13.9% e pjesëmarrësve në studim ndanë një qëndrim pozitiv ndaj deklaratës se infermierët janë përgjegjës për rrëzimet e pacientëve, ndërsa 86.1% kishin një qëndrim negativ, kjo tregon një mungesë ndërgjegjësimi profesional dhe përgjegjshmërie lidhur me rolin aktiv që infermierët duhet të kenë në parandalimin e rrëzimeve. Nga ana tjetër, shumica dërrmuese e infermierëve (91.7%) u shprehën se parandalimi rrëzimeve është përparësi në ndërhyrjen infermierore. Po aq e theksuar

ishte dhe rëndësia që ata i atribojnë edukimit të vazhdueshëm dhe përditësimit të njohurive profesionale në këtë fushë, pasi 91.7% e tyre mbajtën një qëndrim pozitiv ndaj nevojës për trajnime me synim për të rritur sigurinë e pacientëve.

Vlerësimi i rrezikut për rënie konsiderohet një komponent thelbësor në kujdesin infermieror gjatë hospitalizimit. 94.4% e infermierëve shprehën qëndrim pozitiv ndaj deklaratës se të gjithë pacientët duhet të vlerësohen për rrezikun e rënies jo vetëm në momentin e pranimit, por edhe në mënyrë të përsëritur çdo ditë gjatë qëndrimit në spital. Megjithatë, vetëm 72.2% e tyre mbajtën qëndrim pozitiv ndaj domosdoshmërisë së vlerësimit të rrezikut gjatë shtrimit, duke sugjeruar se një pjesë e stafit mund të mos e praktikojë këtë në mënyrë sistematike.

Në lidhje me edukimin e pacientëve për parandalimin e rënieve, të gjithë pjesëmarrësit (100%) u shprehën se ky është një element i rëndësishëm i kujdesit infermieror. Gjithashtu, 83.3% e infermierëve theksuan rëndësinë e individualizimit të ndërhyrjeve parandaluese sipas nevojave dhe gjendjes specifike të çdo pacienti, ndërsa 16.7% nuk ndanë këtë qëndrim, duke sugjeruar mundësinë e një qasje më të përgjithshme në praktikë.

Për sa i përket sigurisë në ambientin spitalor, vetëm 30.6% e infermierëve vlerësuan se ky mjedis është i sigurt për parandalimin e rënieve, ndërkohë që pjesa tjetër shprehën qëndrim negativ. Kjo tregon për një nevojë për përmirësimin e infrastrukturës dhe standardizimin e protokolleve të sigurisë.

Vetëm 25% e pjesëmarrësve ndanë një qëndrim pozitiv ndaj deklaratës se dëmtimi fizik nuk është i rëndë nëse ndodh një rrëzim, ndërsa 75% shprehën qëndrim negativ. 19.4% e infermierëve konsideruan se nëse ndodh një dëmtim rrëzimi ka pak rëndësi, ndërsa pjesa dërrmuese e tyre (80.6%) theksuan ndikimin e madh që ka një rrëzim në gjendjen e përgjithshme të pacientit dhe mënyrën e trajtimit.

Nga të dhënat rezulton gjithashtu se 72.2% e infermierëve shprehën ndjesinë e përgjegjësisë personale në rast të një rënieje të pacientit nën kujdesin e tyre.

Vetëbesimi profesional i infermierëve në aftësinë për të parandaluar rrëzimet rezulton të jetë i lartë, ku 83.3% e pjesëmarrësve shprehën qëndrim pozitiv. Megjithatë, 91.7% pohuan se kanë nevojë për më shumë trajnime dhe përditësim të njohurive.

Gjithashtu, 97.2% e të anketuarve theksuan se parandalimi i rënieve duhet të jetë një përparësi e lartë në kujdesin infermieror.

Ndërsa vetëm 25% e pjesëmarrësve ndanë qëndrimin se rëniet ndodhin për shkak të pacientëve, 75% e tyre e kundërshtuan këtë pohim, duke treguar dhe theksuar rolin aktiv të infermierit në sigurimin e mjedisit të përshtatshëm dhe në implementimin e masave parandaluese.

Tabela 4: Praktikrat e Infermierëve në lidhje me parandalimin e rrëzimeve.

Nr.		Kurrë	Rrallë	Ndonjëherë	Gjithmonë
1	Ndjekja e sistemit me ngjyrë për pacientët me rrezik të lartë rrëzimi.	13.9%	25%	41.7%	19.4%
2	Zbatimi i rreptë i politikave për parandalimin e rrëzimeve	5.5%	33.3%	30.6%	30.6%
3	Pjesëmarrja në hartimin e politikave për parandalimin e rrëzimeve.	5.5%	33.3%	47.2%	13.9%
4	A keni përjetuar ndonjë rrëzim në pavionin tuaj?	5.5%	38.9%	55.6%	0%
5	Ofroj/Ndihmoj pacientin të shkojë në tualet.	2.8%	8.3%	22.2%	66.7%
6	Inkurajoj hidratimin dhe ushqyerjen e duhur.	2.8%	5.5%	25%	66.7%
7	Siguroj mjete edukative për pacientin për parandalimin e rrëzimeve.	2.8%	5.5%	30.6%	61.1%
8	Kur stafi dëshmon një rrëzim të pacientit dhe nuk ka lëndime të dukshme, sa shpesh raportohet kjo?	0%	11.1%	19.4%	69.4%
9	Kur një pacient raporton një rënie që nuk është dëshmuar nga stafi, sa shpesh raportohet kjo?	5.5%	13.9%	13.9%	66.7%
10	Diskutoj mënyrat për të parandaluar rrëzimet.	2.8%	5.5%	50%	41.7%
11	Kërkoj ndihmën e fizioterapistit për vlerësim/trajtim të forcës muskulare, ekuilibrit, etj.	2.8%	13.9%	25%	58.3%
12	Inkurajoj përdorimin e këpucëve të përshtatshme.	8.3%	2.8%	33.3%	55.6%
13	Kërkoj ndihmën e terapistit okupacional për të vlerësuar dhe udhëzuar mbi menaxhimin e aktiviteteve të përditshme.	8.3%	8.3%	33.3%	50%
14	Vlerësoj mbështetjen emocionale të pacientit dhe burimet si ndihma për syze.	8.3%	2.8%	13.9%	75%

Tabela e mësipërme paraqet të dhënat e përfituara nga seksioni mbi praktikant e infermierëve lidhur me parandalimin e rrëzimeve. Të dhënat tregojnë se praktikrat e infermierëve për parandalimin e rënieve janë në përgjithësi pozitive, megjithëse evidentohen disa boshllëqe në përfshirjen institucionale dhe raportimin e ngjarjeve. Ndjekja e sistemit me ngjyrë për pacientët me rrezik të lartë rrëzimi është raportuar si një praktikë që zbatohet shpesh, me 41.7% të infermierëve që e aplikojnë ndonjëherë dhe 19.4% gjithmonë. Megjithatë, zbatimi i politikave institucionale për parandalimin e rënieve nuk është gjithmonë i rregullt, pasi vetëm 30.6% e infermierëve deklaruan se i zbatojnë ato gjithmonë.

Pjesëmarrja e infermierëve në hartimin e politikave për parandalimin e rënieve rezulton të jetë më e ulët, me

vetëm 13.9% që janë gjithmonë të përfshirë. Nga ana tjetër, ndihma që ju ofrohet pacientëve, si asistencë për të shkuar në tualet dhe inkurajimi për ushqyerje të shëndetshme dhe hidratim, përbëjnë një ndër praktikën më të konsoliduar – mbi 66% e infermierëve i zbatojnë këto gjithmonë.


Rreth 55.6% e pjesëmarrësve kanë raportuar se kanë përjetuar ndonjë rënie në pavijonin e tyre. Lidhur me raportimin e rrëzimeve që nuk janë dëshmuar nga stafi apo nuk kanë shkaktuar lëndime të dukshme, shumica e infermierëve (mbi 65% e tyre), deklarojnë se këto raste raportohen gjithmonë.

Për sa i përket aspekteve edukative, 61.1% e infermierëve deklaruan se ofrojnë mjete edukative për parandalimin e rënies, ndërkohë që 41.7% diskutojnë gjithmonë mënyrat për parandalimin e tyre me kolegët apo pacientët.

Në raport me bashkëpunimin ndërprofesional, 58.3% kërkojnë gjithmonë ndihmën e fizioterapistëve për vlerësimin dhe trajtimin e forcës muskulare dhe ekuilibrit, ndërsa 50% kërkojnë ndihmën e terapistëve okupacionalë.

Më në fund, vërehet një nivel i lartë i vlerësimit të nevojave emocionale dhe burimeve të mbështetjes për pacientët, me 75% të infermierëve që e marrin gjithmonë në konsideratë këtë aspekt, duke reflektuar një qasje gjithëpërfshirëse ndaj sigurisë dhe mirëqenies së pacientit.

Grafiku 8: A jeni të trajnuar për të identifikuar pacientët me rrezik për rrëzim?



Grafiku i mësipërm e vërteton qartë se shumica dërrmuese (63.9 %) e Infermierëve të përfshirë në studim nuk janë të trajnuar për të identifikuar pacientët me rrezik për rrëzim.

Ndërsa pjesa tjetër 36.1 % janë të trajnuar në lidhje me identifikimin e pacientëve me rrezik për rrëzim.

Grafiku 9: A njiheni me shkallët/mjetet e vlerësimit të rrezikut për rrëzim?



Sipas të dhënave të demonstruara nga grafiku i mësipërm vërejmë se pjesa më e madhe e Infermierëve me 75 % të tyre i njohin shkallët/mjetet e vlerësimit për rrëzim, ndërsa 8.3% e tyre nuk i njohin ato. Nga ana tjetër e vërejmë një përqindje të konsiderueshme të Infermierëve (16.7 %) që janë përgjigjur se kanë dëgjuar për to por nuk i përdorin, kjo gjë mund të lidhet me mungesën e burimeve ose si pasojë e mungesës së njohurive mbi përdorimin e tyre.

Grafiku 10: Cilin nga mjetet e mëposhtme e keni përdorur ndonjëherë në praktikën tuaj për të vlerësuar rrezikun për rrëzim?



Rezultatet e pasqyruara në grafikun e mësipërm na ofrojnë një panoramë të qartë mbi përdorimin e mjeteve në praktikën e Infermierëve për të vlerësuar rrezikun për rrëzim.

Nga këto të dhëna vërejmë se 30.5% e tyre kanë përdorur Tinetti Balance & Gait Assessment, 16,7% Morse Fall Scale, 2,8% Hendrich II Fall Risk Model dhe 2.8% kanë përdorur mjete të tjera. Ndërkohë vërehet një përqindje e lartë e Infermierëve 47.2% e të cilëve nuk kanë përdorur asnjëherë mjete për të vlerësuar rrezikun për rrëzim.

Grafiku 11: Sipas jush, sa të dobishme janë këto mjete në parandalimin për rrëzim?



Nga të dhënat e grafikut të mësipërm kuptohet qartë se mjetet e përdorura për parandalimin e rrëzimeve kanë një efikasitet të mirë dhe janë shumë të dobishme për minimizimin e këtyre rasteve, gjë që mbështetet nga një përqindje shumë e lartë prej 91.7% e infermierëve të marrë në studim. Vetëm 8.3% janë përgjigjur se këto mjete janë disi të rëndësishme në parandalimin për rrëzim.

Konkluzione

Rezultatet tregojnë një tendencë më të lartë përdorimi të mjeteve të vlerësimit të rrezikut për rënie nga meshkujt, pavarësisht përfaqësimit më të ulët të tyre në studim. Po ashtu niveli arsimor rezulton të jetë një faktor ndikues, pasi profesionistët me arsim më të lartë (Master/Phd) tregojnë prirje më të madhe drejt përdorimit të këtyre mjeteve krahasuar me ata me nivel bachelor. Këto gjetje sugjerojnë rëndësinë e përfshirjes së edukimit të avancuar dhe ndërgjegjësimit profesional në praktikën klinike.

Rezultatet e studimit tregojnë se disa nga praktikat infermirore për parandalimin e rrëzimeve, si inkurajimi i ushqyerjes dhe hidratimit, ndihma për të shkuar në tualet, etj, zbatohen rregullisht nga shumica e infermierëve. Megjithatë, përfshirja në hartimin e politikave dhe ndjekja e sistemit me ngjyrë për pacientët me rrezik të lartë mbeten të kufizuara. Kjo tregon se praktikat individuale janë të mirë përvetësuara, por përfshirja në strategjitë institucionale dhe bashkëpunuese kërkon përmirësim të mëtejshëm dhe mbështetje të vazhdueshme.

Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme për përdorimin e mjeteve të vlerësimit të rrezikut për

rrëzim përbën një pengesë të rëndësishme në praktikën infermirore. Mospërfshirja e këtyre tematikave në formimin profesional apo në edukimin e vazhdueshëm mund të ndikojë negativisht në cilësinë e kujdesit dhe në parandalimin efektiv të rrëzimeve.

Edhe pse shumica e pjesëmarrësve në studim janë të njohur mjetet e vlerësimit të rrezikut për rrëzim, një pjesë e konsiderueshme, deklarojnë se nuk i kanë përdorur kurrë. Kjo tregon një boshllëk mes njohjes teorike dhe zbatimit praktik, duke theksuar nevojën për trajnime të vazhdueshme dhe inkurajimin institucional për përdorimin aktiv të këtyre mjeteve në praktikën infermirore.

Rekomandime

Trajnime të vazhdueshme dhe mbështetje institucionale.

Rekomandohet organizimi i trajnimeve periodike për infermierët mbi identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e rrëzimeve, të shoqëruara me mbështetje institucionale, duke e bërë këtë çështje pjesë të politikave të brendshme dhe vlerësimit të performancës profesionale.

Hartimi i politikave institucionale.

Rekomandohet që institucionet shëndetësore spitalore të hartojnë dhe zbatojnë politika të standardizuara për parandalimin e rrëzimeve, duke përfshirë infermierët në këtë proces. Krijimi i këtyre politikave do të mundësojë një qasje të unifikuar dhe efektive në menaxhimin e rrezikut për rrëzim.

Përdorimi i mjeteve të vlerësimit të rrezikut për rrëzim.

Duhet të inkurajohet përdorimi i mjeteve të standardizuara për vlerësimin e rrezikut për rrëzim në praktikën e përditshme infermirore me qëllim rritjen e sigurisë dhe cilësisë së kujdesit ndaj pacientit.

Vlerësimi i kujdesit infermieror gjatë kimioterapisë në pacientët me kancer gjiri në kujdes paliativ në Spitalin Rajonal Fier.

Nikola Agalliu (2025)

Program i Ciklit të dytë "Master i Shkencave në Shkenca Infermiore"

Udhëheqës shkencor: Dr. Aferdita Nikaj

Fakulteti i Shëndetit, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë

Punim studentor i përgatitur dhe botuar në kuadër të Buletinit Shkencor.

Abstrakti

Hyrje: Kujdesi infermieror për pacientet me kancer të gjirit në fazë paliative gjatë trajtimit me kimioterapi përfaqëson një komponent thelbësor të cilësisë së shërbimeve onkologjike. Përveç aspektit teknik, dimensionet psikologjike, komunikimi terapeutik dhe edukimi shëndetësor janë të domosdoshme për të garantuar mirëqenie dhe respekt për dinjitetin e pacientit. Në kontekstin shqiptar, studimet mbi vlerësimin sistematik të këtij kujdesi në mjedise spitalore rajonale janë të kufizuara.

Qëllimi: Të vlerësohet perceptimi i pacienteve për cilësinë e kujdesit infermieror të marrë gjatë trajtimit me kimioterapi në fazë paliative, të identifikohen faktorët përmirësues dhe boshllëqet në përkujdesje, si dhe të analizohen lidhjet ndërmjet karakteristikave demografike dhe vlerësimeve të ofruara. Ky studim deskriptiv i tipit cross-sectional u realizua në repartin e kimioterapisë të Spitalit Rajonal Fier gjatë periudhës mars–qershor 2025. Të dhënat u mbledhën përmes një pyetësoi të strukturuar me alternativa të

mbyllura, i cili përfshinte komponentë mbi komunikimin, përkujdesjen, edukimin dhe mbështetjen psikologjike. Janë përfshirë 45 paciente që plotësonin kriteret përfshirëse. Të dhënat u analizuan në SPSS 27 me statistika përshkruese dhe korrelacion Spearman/Pearson.

Rezultatet: 84.4% e pacienteve e cilësuan kujdesin si shumë të kënaqshëm, 100% raportuan informim të plotë për procedurat dhe 88.9% vlerësuan sjelljen e infermierëve si shumë të mirë. Mbështetja psikologjike u sigurua në 77.8% të rasteve. U identifikuan lidhje domethënëse statistikore midis arsimit dhe nevojës për informacione të shkruara ($r = -0.41$, $p = 0.011$), si dhe midis numrit të seancave të kimioterapisë dhe perceptimit pozitiv për kujdesin ($r = 0.42$, $p = 0.004$).

Përfundime: Kujdesi infermieror në këtë repart përmbush standarde të larta profesionale dhe etike, veçanërisht në aspektin e komunikimit, disponueshmërisë dhe përkujdesjes teknike. Sidoqoftë, u identifikuan boshllëqe në edukimin e shkruar,

përfshirjen dietetike dhe mbulimin e temave si seksualiteti.

Rekomandime: Rekomandohet zhvillimi i materialeve edukative të shkruara, forcimi i mbështetjes psikologjike, trajnimi në komunikim empatik, standardizimi i informimit për procedurat dhe përmirësimi i aksesit për pacientët pa sigurim shëndetësor. Po ashtu, sugjerohet përfshirja aktive e familjarëve dhe implementimi i ndërhyrjeve të personalizuara sipas profilit të pacientit.

Fjalë kyçe: kanceri i gjirit, kimioterapia, kujdesi infermior, paliacioni, komunikimi klinik, edukimi i pacientit, kënaqësia ndaj shërbimit. viii

Abstract

Introduction: Nursing care for patients with breast cancer in the palliative phase during chemotherapy represents an essential component of the quality of oncological services. Beyond the technical aspects, psychological support, therapeutic communication, and health education are indispensable to ensure well-being and respect for patient dignity. In the Albanian context, studies assessing this care systematically in regional hospital settings remain limited.

Aim: To evaluate patients' perceptions of the quality of nursing care received during palliative chemotherapy, identify areas for improvement and existing gaps, and analyze the associations between demographic characteristics and reported assessments.

Methodology: This descriptive cross-sectional study was conducted in the chemotherapy department of Fier Regional Hospital between March and June 2025. Data were collected through a structured closed-ended questionnaire covering components related to communication, care, education, and psychological support. A total of 45 patients meeting the inclusion criteria participated. Data were analyzed using SPSS 27 with descriptive statistics and Spearman/Pearson correlation analysis.

Results: 84.4% of patients rated the care as very satisfactory, 100% reported being fully informed about procedures, and 88.9% assessed nurses' behavior as very good. Psychological support was provided in 77.8% of cases. Statistically significant correlations were identified between education level and the need for written information ($r = -0.41$, $p = 0.011$), as well as between the number of

chemotherapy sessions and a positive perception of care ($r = 0.42$, $p = 0.004$).

Conclusions: Nursing care in this department meets high professional and ethical standards, particularly in terms of communication, availability, and technical competence. However, gaps were identified in the provision of written education materials, dietary counseling, and coverage of topics such as sexuality.

Recommendations: It is recommended to develop written educational materials, strengthen psychological support, train nurses in empathetic communication, standardize procedural information delivery, and improve access for uninsured patients. Active involvement of family members and the implementation of personalized interventions according to patient profiles are also suggested.

Keywords: breast cancer, chemotherapy, nursing care, palliative care, clinical communication, patient education, service satisfaction.

Qëllimi dhe objektivat e studimit

Qëllimi

Të kryhet një vlerësim gjithëpërfshirës i kujdesit infermior të ofruar gjatë trajtimit me kimioterapi të pacientet me kancer të gjirit në fazë paliative në një mjedis spitalor rajonal, duke identifikuar pikat e forta dhe dobësitë e shërbimit, si dhe të përcaktohen nevojat e tyre për përkrahje të mëtejshme shëndetësore, emocionale dhe edukative.

Objektivat specifike

Të identifikohen karakteristikat sociodemografike të pacienteve me kancer të gjirit në trajtim paliativ që marrin kimioterapi në Spitalin Rajonal Fier.

Të vlerësohet perceptimi i pacienteve mbi cilësinë e shërbimit infermior të marë në repartin e kimioterapisë, përfshirë sjelljen, respektin, profesionalizmin dhe disponueshmërinë e infermierëve.

Të vlerësohet niveli i komunikimit dhe informimit të ofruar nga personeli infermior dhe mjekësor në lidhje me trajtimin, efektet anësore dhe kujdesin në shtëpi.

Të vlerësohet komoditeti dhe ambienti fizik i ofruar gjatë kimioterapisë, përfshirë pritjen, procedurat administrative dhe kushtet e dhomës.

Të vlerësohet aspekti njerëzor dhe mbështetja emocionale e ofruar nga personeli shëndetësor gjatë procesit të trajtimit.

Të identifikohen efektet anësore të kimioterapisë dhe menaxhimi i tyre nga personeli infermieror gjatë qëndrimit spitalor.

Të vlerësohen nevojat për kujdesje mbështetëse ambulatorë, përfshirë mbështetjen psikologjike, edukimin mbi efektet anësore dhe të drejtat e pacientit për informacion dhe zgjedhje në trajtim.

Të identifikohen boshllëqet në ofrimin e kujdesit infermieror dhe të sugjerohen përmirësime për përmbushjen më të mirë të nevojave të pacienteve në trajtim paliativ me kimioterapi.

Hipotezat e studimit

Hipoteza 1: Pacientet me kancer të gjirit në trajtim paliativ që raportojnë një komunikim të mirë me personelin infermieror kanë një nivel më të lartë kënaqësie ndaj kujdesit të marrë gjatë kimioterapisë.

Hipoteza 2: Ekziston një lidhje statistikisht domethënëse midis nivelit arsimor të pacienteve dhe perceptimit të tyre për cilësinë e informacionit të ofruar nga infermierët mbi trajtimin dhe efektet anësore.

Pyetjet kërkimore

Cili është perceptimi i pacienteve me kancer të gjirit në trajtim paliativ për cilësinë e kujdesit infermieror të marrë gjatë kimioterapisë?

Cilat janë nevojat e pacienteve për mbështetje shtesë shëndetësore, psikologjike dhe edukative gjatë dhe pas trajtimit me kimioterapi në kontekstin e kujdesit paliativ?


Rezultatet e studimit

Në seksionin nr.1 të pyetësorit, janë përshkruar të dhënat demografike. Së pari, janë analizuar grupmosha, niveli i edukimit, statusi i punësimit dhe zona e vendbanimit.

Tabela 5. Te dhenat sociodemografike


Variabli	Kategoria	Frekuenca (n)	Përqindja (%)
Grupmosha (vjeç)	30–40	1	2.2
	41–50	8	17.8
	51–60	18	40.0
	61–75	18	40.0
Vendbanimi	Urbane	28	62.2
	Rurale	17	37.8
Niveli i arsimit	Shkollë 8-vjeçare	26	57.8
	Shkollë e mesme	18	40.0
	Shkollë e lartë	1	2.2
Statusi i punësimit	Po	17	37.8
	Jo	28	62.2

Grafiku 1. Shpërndarja sipas grupmoshës




Pjesa më e madhe e pacienteve i përket grupmoshave 51–60 dhe 61–75 vjeç, të cilat përfaqësojnë secila nga 40% të totalit. Kjo tregon se pacientet që kërkojnë shërbime shëndetësore janë kryesisht të moshës së mesme dhe të tretë. Në krahasim, grupmoshat më të reja janë më pak të përfaqësuara, veçanërisht ajo 30–40 vjeç me vetëm 2.2%.

Grafiku 2. Shpërndarja sipas vendbanimit



Shumica e pacienteve, përkatësisht 62.2%, jetojnë në zona urbane, ndërsa 37.8% janë nga zona rurale. Kjo shpërndarje mund të lidhet me qasjen më të lehtë që kanë banorët e qyteteve ndaj shërbimeve shëndetësore dhe me ndërgjegjësimin më të lartë për ndjekjen e kontrolleve mjekësore.

Grafiku 3. Shpërndarja sipas statusit të punësimit



Vetëm 37.8% e pacienteve janë të punësuar, ndërsa 62.2% rezultojnë të papuna ose në pension. Kjo mund të pasqyrojë një gjendje sociale dhe ekonomike të vështirë, e cila ndikon në aksesin dhe përkujdesjen ndaj shëndetit, por gjithashtu mund të jetë pasojë e problemeve shëndetësore që kufizojnë aftësinë për punë.

Grafiku 4. Shpërndarja sipas nivelit të arsimimit




Pacientet me arsim bazë dominojnë në këtë grup, ku 57.8% kanë përfunduar shkollën 8-vjeçare dhe 40% shkollën e mesme. Vetëm 2.2% kanë ndjekur arsimin e lartë. Ky nivel i ulët arsimor mund të ndikojë në kuptueshmërinë e informacionit mjekësor dhe në ndjekjen e trajtimeve shëndetësore në mënyrë të saktë.

Me tej, janë analizuar disa të dhëna klinike në pacientet e marre në shqyrtim sic janë periudha e diagnostikimit me kancer gjiri, nëse kanë kryer mastektomi apo jo, numri i cikleve të kimioterapisë të kryera deri në periudhën e studimit, nëse kanë apo jo sigurim shëndetësor dhe nëse kanceri i gjirit është për herë të parë apo është rikthyer.

Tabela 6. Shpërndarja e karakteristikave klinike të pacienteve të përfshira në studim


Variabli	Kategoria	Frekuenca (n)	Përqindja (%)
Viti i diagnostikimit	Përpara 2022	3	6,7
	2022–2023	4	8,9
	2024–2025	38	84,4
Numri i seancave të kimioterapisë	1–3	12	26,7
	4–6	18	40,0
	7–8	15	33,3
Mastektomia	Po	38	84,4
	Jo	7	15,6
Sigurim shëndetësor	Po	24	53,3
	Jo	21	46,7
Statusi i diagnostikimit	Herë e parë	39	86,7
	Rikthyer	6	13,3

Grafiku 5. Viti i diagnostikimit




Shumica e pacienteve (84,4 %) diagnostikuan kancerin e gjirit gjatë periudhës 2024–2025, gjë që reflekton hyrjen në studim të pacientëve aktualë në trajtim paliativ. Vetëm 6,7 % kishin diagnozë përpara vitit 2022, dhe 8,9 % mes viteve 2022–2023, çka tregon një koncentrim të rasteve të reja në vitet e fundit dhe rëndësinë e monitorimit të hershëm në nivel rajonal.

Grafiku 6. Numri i seancave të kimioterapisë



Rreth 40,0 % e pacienteve kishin kryer 4–6 seanca kimioterapie, që korrespondon me fazën kryesore të trajtimit, ndërkohë që 33,3 % kishin përfunduar 7–8 seanca, dhe 26,7 % ndodheshin në fillim të protokollit (1–3 seanca). Kjo shpërndarje tregon vijimësinë e mirë të trajtimit dhe përparimin gradual drejt fazave të avancuara të kimioterapisë.


Grafiku 7. Kryerja e mastektomisë



Një i madh, 84,4 % e pacienteve, kishte përfunduar mastektomi, duke konfirmuar se ky ishte hapi standard në trajtimin kirurgjikal të kancerit të gjirit në fazë


paliative. Vetëm 15,6 % nuk kishin kryer ndërhyrje kirurgjikale, çka mund të lidhet me zgjedhje individuale apo kufizime klinike.

Grafiku 8. Siguracioni shëndetësor



Rreth gjysmës së pacienteve (53,3 %) dispononin sigurim shëndetësor, ndërsa 46,7 % jo. Kjo diferencë tregon se gati një e treta e pjesëmarrëseve mund të kenë hasur pengesa financiare për akses në shërbime mbështetëse, duke theksuar nevojën për përmirësime në mbulimin shëndetësor.

Grafiku 9. Statusi i diagnostikimit




Në 86,7 % të rasteve kanceri u diagnostikua për herë të parë gjatë periudhës së studimit, ndërsa 13,3 % raportuan rikthim të sëmundjes. Përqindja e ulët e rikthyerve sugjeron se trajtimi paliativ është kryesisht për pacientë me diagnozë të freskët, duke nënvizuar rëndësinë e menaxhimit të hershëm dhe mbështetjes ndaj pacientëve të risjellë me recidivë.

Më tej, u analizuan pyetjet në lidhje me vlerësimin e pacientëve për shërbimin infermieror gjatë marrjes së kimioterapisë.

Të dhënat pasqyrojnë një vlerësim shumë pozitiv të cilësisë së përgjithshme të shërbimit. Konkretisht, 84.4% e pacientëve e cilësojnë shërbimin në raport si

“shumë të kënaqshëm”, ndërsa 88.9% raportojnë një pritje të shkëlqyer nga personeli infermieror. Për më tepër, 80% vlerësojnë kushtet fizike të dhomave si shumë të përshtatshme. Këto rezultate reflektojnë standarde të larta të kujdesit në mjedisin spitalor, si në aspektin profesional, ashtu edhe në atë infrastrukturor.

Grafiku 10. Vlerësimi i cilësisë së shërbimit (% mesatare)



Komunikimi ndërpersonal dhe transparenca në informim rezultojnë të jenë aspekte të mirëpërmblura të kujdesit infermieror dhe mjekësor. Vlerësimet për indikatorë si shpjegimi i procedurave, informimi mbi përdorimin e medikamenteve dhe përgjigja ndaj pyetjeve të pacientëve variojnë nga 95.6% në 100%. Ky nivel i lartë i raportuar tregon një angazhim të fortë të stafit për të garantuar informim të plotë, mbështetje emocionale dhe respekt ndaj të drejtave të pacientit.

Grafiku 11. Komunikimi dhe informimi





Tabela 7. Pyetjet ne lidhje vleresimin e pacienteve per sherbimin infermior gjate marrjes se kimioterapise

Pyetje	Kategoria	Frekuenca (n)	Persqendje (%)
10. Si do t'i pershkruani shqetimet e tjera ne raport?	Shume te kenaqshme	38	84.4%
	Te kenaqshme	7	15.6%
	Te pamjaftueshme	0	0.0%
	Shume keq	0	0.0%
	Asnjehere	45	100.0%
11. A do t'ua rekomandoim kete sherbim te tjereve?	Ndoshta po	0	0.0%
	Ndoshta jo	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
12. Si vleresoni putjen nga personeli infermior?	Shume te kenaqshme	40	88.9%
	Te kenaqshme	5	11.1%
	Te pamjaftueshme	0	0.0%
	Shume keq	0	0.0%
13. Si i vleresoni formalitetet dhe procedurat administrative?	Shume te mjeshtre	45	100.0%
	Te mjeshtre	0	0.0%
	Te komplikuar	0	0.0%
	Shume te komplikuar	0	0.0%
	Shume te kenaqshme	36	80.0%
14. Si i vleresoni kushtet e dhomes ku ju eshte dhene sherbimi?	Te kenaqshme	9	20.0%
	Te pamjaftueshme	0	0.0%
	Shume keq	0	0.0%
15. A krijone infermieret kontaktim te mire me ju gjate sherbimit?	Gjithmonë	45	100.0%
	Shpesh here	0	0.0%
	Rralle here	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
16. A keni marre pergjigje per pyetjet qe i drejtusi stafi infermior?	Gjithmonë	44	97.8%
	Shpesh here	1	2.2%
	Rralle here	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
17. A ju ka shpjeguar mjeku qarte problemin tuaj?	Gjithmonë	43	95.6%
	Shpesh here	2	4.4%
	Rralle here	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
18. A ju ka informuar infermiera mbi procedurat para realizimit?	Gjithmonë	45	100.0%
	Shpesh here	0	0.0%
	Rralle here	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
19. A ju kanë shpjeguar infermieret menyren e perdorimit te barnave?	Gjithmonë	45	100.0%
	Shpesh here	0	0.0%
	Rralle here	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
20. A ju kanë shpjeguar ekzaminimet qe do t'i uenshtroni?	Gjithmonë	45	100.0%
	Shpesh here	0	0.0%
	Rralle here	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
21. A keni marre udhezime mbi regjimin higjieno-dietetik?	Gjithmonë	12	26.7%
	Shpesh here	33	73.3%
	Rralle here	0	0.0%
	Asnjehere	0	0.0%
22. A u prezantua stafi infermior para kujdesit?	Po, te gjithë	30	66.7%
	Shumica po	10	22.2%
	Shumica jo	0	0.0%
	Asnjë	5	11.1%

Grafiku 12. Procedura dhe rekomandimi




Pacientët vlerësojnë maksimalisht lehtësinë e procedurave administrative (100%) dhe janë

unanimisht të gatshëm të rekomandojnë shërbimin (100%), çka dëshmon besueshmëri të lartë ndaj institucionit. Megjithatë, vetëm 26.7% raportojnë se kanë marrë gjithmonë udhëzime mbi regjimin higjieno-dietetik, ndërsa prezantimi i stafit infermior është vlerësuar si i plotë vetëm nga 66.7% e pacientëve. Këto aspekte mbeten pika të rëndësishme për përmirësim në rritjen e transparencës dhe edukimit shëndetësor.

Tabela 8. Shpërndarja e vlerësimit të pacienteve për kujdesin infermior

Pyetje	Kategoria	Frekuenca (n)	Persqendje (%)
23. Informuarit u prezantuan perpara procedurave?	Po, te gjithë	30	66.7%
	Shumica po	15	33.3%
	Shumica jo	0	0.0%
	Asnjë	0	0.0%
24. Infermieret janë kompetentë për gjendjen tuaj shëndetësore?	Po, te gjithë	35	73.3%
	Shumica po	12	26.7%
	Shumica jo	0	0.0%
	Asnjë	0	0.0%
25. Infermieret janë të aftë në përdorimin e pajisjeve dhe aplikimeve e medikamenteve?	Po, te gjithë	40	88.9%
	Shumica po	5	11.1%
	Shumica jo	0	0.0%
	Asnjë	0	0.0%
26. Si e vlerësoni disponueshmërinë e personelit infermior?	Shumë të kënaqshme	36	84.4%
	Te kënaqshme	7	15.6%
	Paqe e kënaqshme	0	0.0%
	Shumë keq	0	0.0%
27. Si e vlerësoni cilësinë e kujdesit infermior?	Shumë mirë	35	77.8%
	Mirë	10	22.2%
	Dobët	0	0.0%
	Keq	0	0.0%
28. A pati vonesë në menaxhimin e dhimbjes?	Asnjë vonesë	45	100.0%
	Janë vonuar disi	0	0.0%
	Më janë penguar shumë vonë	0	0.0%
29. Si e vlerësoni kujdesin ndaj efekteve anësore të kimioterapisë?	Shumë të kënaqshme	36	80.0%
	Te kënaqshme	8	17.8%
	Te pamjaftueshme	1	2.2%
	Shumë keq	0	0.0%

Grafiku 13. Kompetenca dhe profesionalizimi i infermiereve




Ky grafik paraqet nivelin e perceptuar të aftësive profesionale dhe etikës së stafit infermior.

Rezultatet tregojnë se pacientët kanë një vlerësim shumë pozitiv për sjelljen dhe përgatitjen teknike të infermiereve, me 88.9% që i konsiderojnë të aftë në përdorimin e pajisjeve dhe administrimin e medikamenteve. Po ashtu, sjellja njerëzore është vlerësuar me të njëjtin nivel, ndërsa kompetenca për gjendjen shëndetësore arrin 73.3%. Prezantimi para procedurave, ndonëse i rëndësishëm për ndërtimin e


besimit, rezulton më pak i pranishëm (66.7%), duke sugjeruar një hapësirë për përmirësim në aspektin e komunikimit etik dhe prezantimit zyrtar të stafit.

Grafiku 14. Kujdesi gjatë trajtimit dhe efekteve anësore



Vlerësimet e pacientëve për cilësinë e kujdesit gjatë trajtimit janë tepër të larta. Menaxhimi i dhimbjes dhe informimi mbi kujdesin në shtëpi kanë marrë vlerësime maksimale (100%), duke dëshmuar për një organizim të saktë dhe të përgjegjshëm të kujdesit klinik. Po ashtu, disponueshmëria e personelit (84.4%) dhe përkujdesja ndaj efekteve anësore të kimioterapisë (80%) janë vlerësuar pozitivisht. Megjithatë, 44.4% e pacientëve raportojnë përjetim të efekteve negative si nauze, të vjella apo diskonfort, çka nënvizon nevojën për ndërhyrje më të personalizuar në menaxhimin e simptomave të padëshiruara.


Grafiku 15. Komunikimi dhe ndjeshmëria



Komunikimi ndërpersonal dhe ndjeshmëria emocionale e infermierëve janë vlerësuar në mënyrë të shkëlqyer nga pacientët. Informimi i familjarëve për kujdesin, pranimi i tyre gjatë qëndrimit në spital dhe respektimi i privatësisë kanë marrë vlerësime midis 88.9% dhe 100%, duke dëshmuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe respektuese ndaj pacientit dhe


familjes. Mbështetja psikologjike është pranishme në mënyrë të qëndrueshme (77.8%), ndërsa 93.3% e pacientëve deklarojnë se janë ndjerë të vlerësuar gjatë gjithë procesit të trajtimit. Ky grafik pasqyron një përkujdesje që përfshin jo vetëm trajtimin mjekësor, por edhe respektin për dinjitetin dhe nevojat emocionale të pacientit.

Grafiku 16. Nevoja për kujdes klinik dhe psikologjik



Ky grafik thekson kërkesën e pacientëve për mbështetje emocionale dhe informim praktik. Më shumë se dy të tretat e pacientëve kërkojnë mbështetje psikologjike dhe këshillim përballë sfidave të trajtimit. Nevoja për informacion mbi menaxhimin e efekteve anësore në shtëpi është gjithashtu shumë e lartë (77.8%). Ndërkohë, përjetimi i ndjenjës së afërsisë me vdekjen (77.8%) dhe shqetësimet mbi aspektin seksual (55.6%) përbëjnë faktorë që nënvizojnë rëndësinë e trajtimit gjithëpërfshirës të pacientit onkologjik.

Grafiku 17. Nevoja për informacion të strukturuar




Të dhënat tregojnë se pacientët ndiejnë një mungesë të theksuar për informacion të organizuar dhe të kuptueshëm.

Tabela 9. Nevojat shëndetësore gjatë përkujdesjes infermiere

PËRËTË	Jo e aplikueshme	Nuk është e nevojshme	Pak nevojë	Nevojë e moderat	Nevojë e madhe
39. Dhimtia	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
40. Mungesa e energjisë	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
41. Të ndjerit aspak mirë në të shumtën e rasteve	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
42. Ankthi	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
43. Të ndjerit të depresuar	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
44. Të ndjerit i/e mëzuar	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
45. Frika e përhapjes së kancerit	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
46. Shqetësimi se rezultatet e trajtimit nuk varen nga ju	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
47. Shpenjë i/e sigurt për të ardhmen	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
48. Të mësuarit për të punuar nën kontroll gjatë trajtimit	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
49. Ndjenja si vdekja	10 (22,2%)	0 (0,0%)	35 (77,8%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
50. Ndryshime të aspektit seksual	20 (44,4%)	0 (0,0%)	25 (55,6%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
51. Mundësi zgjedhjeje specialisti	30 (66,7%)	0 (0,0%)	15 (33,3%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
52. Mundësi zgjedhjeje spitali	25 (55,6%)	0 (0,0%)	20 (44,4%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
53. Mbështetje psikologjike (psikolog, punonjës social, infermier specializues)	0 (0,0%)	15 (33,3%)	30 (66,7%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
54. Informacione të shkruara për kujdesin që duhet të merret	0 (0,0%)	20 (44,4%)	25 (55,6%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
55. Informacione për menaxhimin e efekteve anësore në shtrëpi	0 (0,0%)	10 (22,2%)	35 (77,8%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
56. Shpjegime të njohësive për testet e ndryshme	0 (0,0%)	25 (55,6%)	20 (44,4%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
57. Informacione të detajuara mbi përfitimet dhe efektet anësore përpara terapi	0 (0,0%)	30 (66,7%)	15 (33,3%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
58. Informim sa më shpejt mbi rezultatet e testeve	0 (0,0%)	35 (77,8%)	10 (22,2%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
59. Informim nëse kanceri është nën kontroll, përhapur apo rikthyer	0 (0,0%)	30 (66,7%)	15 (33,3%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
60. Informim për atë që mund të bëhet për t'u ndjerë më mirë	0 (0,0%)	25 (55,6%)	20 (44,4%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
61. Këshillim dhe mbështetje profesionale nëse ju ose familja e dëshiron	0 (0,0%)	15 (33,3%)	30 (66,7%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
62. Informacione për problemet seksuale	10 (22,2%)	0 (0,0%)	5 (11,1%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
63. Trajtimi nga infermierët në mënyrë të respektueshme	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)
64. Komunikim i frekuentë me personel shëndetësor	0 (0,0%)	45 (100,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)	0 (0,0%)

. Mbi gjysma e tyre kërkojnë materiale të shkruara për kujdesin, ndërsa përqindje të konsiderueshme shprehin nevojë për më shumë shpjegime mbi testet, efektet anësore dhe mënyrat për përmirësimin e gjendjes së tyre. Kjo pasqyron rëndësinë e edukimit shëndetësor të personalizuar si pjesë e pandashme e kujdesit cilësor.

Grafiku 18. Nevoja për zgjedhje dhe përfshirje



Pacientët shfaqin interes për të pasur më shumë kontroll në vendimmarrje, ku 44.4% kërkojnë të zgjedhin spitalin dhe 33.3% specialistin. Megjithatë, vetëm 11.1% kanë shprehur nevojë për informacione mbi problemet seksuale, çka mund të interpretohet si mungesë perceptimi mbi rëndësinë e kësaj teme ose mungesë komunikimi të hapur. Ky grafik evidenton domosdoshmërinë për të fuqizuar pacientin në procesin terapeutik.

Analiza e avancuar statistikore

Tabela 10, paraqet rezultatet e disa korrelacioneve ndërmjet karakteristikave demografike dhe përgjigjeve të pacientëve lidhur me kujdesin infermieror. Janë përdorur testet e korrelacionit Spearman dhe Pearson në varësi të natyrës së të dhënave.

Korrelimet më domethënëse janë vërejtur midis nivelit të arsimit dhe nevojës për informacione të shkruara ($r = -0.41$, $p = 0.011$), si dhe midis statusit të punësimit dhe mbështetjes emocionale ($r = 0.45$, $p = 0.007$). Këto rezultate janë në përputhje me literaturën, e cila sugjeron se pacientët me arsim më të ulët kanë më shumë nevojë për informacion të strukturuar dhe se individët në situata socio-ekonomike më të vështira kërkojnë më shumë mbështetje emocionale gjatë trajtimit paliativ.

Tabela 10. Korrelacionet ndërmjet të dhënave demografike dhe perceptimeve mbi kujdesin infermieror te pacientet me kancer të gjirit në fazë paliative

Variabli i pavarur	Variabli i varur	Llopi i testit	Koeficienti i korrelacionit (r/p)	Vlera p	Interpretim
Grupmosha	Kuptimi i përdorimit të barnave	Spearman	-0.32	0.029	Pacientët më të moshuar raportojnë kuptim më të ulët për përdorimin e barnave
Niveli i arsimit	Nevoja për informacione të shkurtra	Spearman	-0.41	0.011	Pacientët me arsim më të ulët kanë nevojë më të madhe për materiale të shkurtë
Statusi i punësimit	Kënaqësia ndaj kujdesit të marrë	Spearman	0.18	0.184	Nuk u gjet lidhje statistikisht domethënëse mes punësimit dhe kënaqësisë
Niveli i arsimit	Perceptimi për kompetencën e infermierëve	Spearman	-0.36	0.024	Pacientët me arsim më të ulët perceptojnë më pak kompetencë tek infermierët
Vendbanimi	Nevoja për mbështetje psikologjike	Spearman	0.29	0.055	Pacientët nga zona urbane shfaqin më shumë nevojë për mbështetje psikologjike
Grupmosha	Respekti i perceptuar për privatesinë	Pearson	-0.08	0.621	Nuk ka lidhje të rëndësishme mes moshës dhe respektimit të privatesisë
Statusi i punësimit	Mbështetja emocionale nga personeli	Pearson	0.45	0.007	Pacientët e papunë ndihen më të mbështetur emocionalisht
Niveli i arsimit	Niveli i informacionit përpara procedurave	Spearman	-0.28	0.039	Pacientët me arsim më të ulët raportojnë më pak informim para procedurave
Vendbanimi	Nevoja për shpjegime më të qarta për testet	Pearson	-0.35	0.013	Pacientët nga zona rurale shprehin më shumë nevojë për shpjegime për testet
Grupmosha	Perceptimi për sjelljen e infermierëve	Pearson	-0.12	0.472	Nuk ka lidhje statistikisht të rëndësishme mes moshës dhe perceptimit për sjelljen e infermierëve

Gjithashtu, pacientët nga zona rurale kanë raportuar nevojë më të mëdha për sqarime të hollësishme mbi testet diagnostike, duke reflektuar mbase qasje më të kufizuara ndaj informacionit shëndetësor apo barriera kulturore në komunikim.

Megjithëse disa korrelacione nuk rezultojnë statistikisht të rëndësishme, si p.sh. moshë me perceptimin e respektit të privatesisë, ato mbeten të vlefshme për analizë për të kuptuar më mirë diversitetin e përvojave të pacientëve dhe për të orientuar ndërhyrjet e personalizuara në kujdesin infermieror.

Tabela 11. Korrelacionet ndërmjet të dhënave klinike dhe perceptimeve mbi kujdesin infermieror te pacientet me kancer të gjirit në fazë paliative

Variabla e pavarur	Variabla e varur	Koeficienti i korrelacionit	P- vlera	Interpretim
Numri i seancave të kimioterapisë	Cilësia e përgjithshme e kujdesit infermieror	0.42	0.004	Korrelacion pozitiv mes seancave të kimioterapisë dhe vlerësimit të kujdesit infermieror
Numri i seancave të kimioterapisë	Komunikimi me personelin	0.30	0.038	Komunikimi përmirësohet me më shumë seanca
Mastektomia (Po/Jo)	Prezantimi i infermierëve para kujdesit	0.21	0.127	Mastektomia nuk lidhet në mënyrë domethënëse me prezantimin e stafit
Mastektomia (Po/Jo)	Disponueshmëria e stafit infermieror	0.34	0.021	Mastektomia lidhet me perceptimin pozitiv të disponueshmërisë së stafit
Viti i diagnostikimit	Informimi për përdorimin e barnave	0.52	0.001	Diagnoza e reja kanë më shumë informacion mbi barnat
Viti i diagnostikimit	Kujdesi ndaj efekteve anësore	0.47	0.002	Pacientët e diagnostikuar së fundmi vlerësojnë më pozitivisht përkujdesjen ndaj efekteve anësore
Statusi i diagnostikimit (herë parë/recidivë)	Mbështetja psikologjike	0.38	0.013	Rikthimet lidhen me kërkesa më të mëdha për mbështetje psikologjike
Statusi i diagnostikimit (herë parë/recidivë)	Ndjenja e vlerësimit gjatë trajtimit	0.41	0.009	Rikthimet ndihen më të vlerësuara në trajtim
Sigurimi shëndetësor	Udhëzime për kujdesin në shtëpi	0.36	0.018	Sigurimi lidhet me më shumë udhëzime për kujdesin në shtëpi
Sigurimi shëndetësor	Marrja e informacionit mbi përfitimet dhe efektet anësore	0.27	0.062	Mungesa e sigurimit pakëson perceptimin për informimin e plotë

Korrelacionet mes karrierës së trajtimeve dhe vlerësimeve për kujdesin infermieror tregojnë se pacientet që kanë marrë më shumë seanca kimioterapie raportojnë një perceptim më të mirë të cilësisë së kujdesit ($r=0.42$, $p=0.004$) dhe të komunikimit me personelin ($r=0.30$, $p=0.038$), ndoshta për shkak të mirënjohjes së procedurave dhe marrëdhënieve më të forta me infermierët gjatë kohës.

Nga ana kirurgjike, megjithëse mastektomia nuk lidhet në mënyrë domethënëse me prezantimin e stafit para procedurave ($r=0.21$, $p=0.127$), pacientet pas mastektomisë ndihen më të mbështetura dhe kanë një perceptim më pozitiv të disponueshmërisë së stafit infermieror ($r=0.34$, $p=0.021$), gjë që reflekton nevojën për një kujdes post-kirurgjikal më të detajuar.

Përsa i përket kohës së diagnostikimit, pacientet e diagnostikuar në vitet 2024–2025 raportojnë nivele shumë më të larta të informimit mbi përdorimin e barnave ($r=0.52$, $p=0.001$) dhe një përkujdesje më cilësore ndaj efekteve anësore të kimioterapisë ($r=0.47$, $p=0.002$), duke sugjeruar përmirësime në protokollet edukative dhe menaxhimin simptomatik. Në të njëjtën kohë, pacientet me rikthim të sëmundjes kërkojnë më shumë mbështetje psikologjike ($r=0.38$, $p=0.013$) dhe ndihen më të vlerësuara gjatë trajtimit ($r=0.41$, $p=0.009$), çka tregon nevojën për programe të

specializuara psiko-sociale për grupet me recidiva. Nga aspekti socio-ekonomik, dotimi me sigurim shëndetësor shoqërohet me udhëzime më të plota për kujdesin në shtëpi ($r=0.36$, $p=0.018$) dhe një tendencë drejt informimit më të plotë mbi përfitimet dhe efektet anësore ($r=0.27$, $p=0.062$), duke theksuar domosdoshmërinë e aksesit të pandërprerë në shërbime mbështetëse dhe burime edukative, pavarësisht sfidave financiare të pacientëve.

Konkluzione

Kujdesi infermieror u vlerësua si “shumë i kënaqshëm” nga 84.4% e pacienteve dhe 100% do ta rekomandonin, duke dëshmuar një nivel të lartë cilësie në shërbimin paliativ spitalor.

Komunikimi terapeutik ishte optimal, me 100% të pacienteve që morën gjithmonë shpjegime për barnat, procedurat dhe efektet anësore, i lidhur në mënyrë statistikisht domethënëse me kënaqësinë ($p = 0.038$).

Mbështetja emocionale ishte e qëndrueshme, me 77.8% që morën gjithmonë ndihmë psikologjike dhe një lidhje pozitive me rikthimin e sëmundjes ($p = 0.013$).

Pacientet me arsim të ulët kishin më shumë nevojë për materiale të shkruara ($p = 0.011$) dhe raportuan më pak informim para procedurave ($p = 0.039$).

Numri i lartë i seancave të kimioterapisë lidhej me perceptim më pozitiv për kujdesin infermieror ($p = 0.004$), duke theksuar rëndësinë e kontinuitetit. Vetëm 26.7% morën gjithmonë këshilla higjieno-dietetike dhe 11.1% raportuan mungesë të informacioneve për problemet seksuale, duke treguar boshllëqe edukative në kujdesin infermieror.

Rekomandime

Rekomandohet që të zhvillohen dhe të shpërndahen materiale të shkruara edukative (broshura, fletëudhëzime, tabela vizuale) për përdorimin e barnave, efektet anësore dhe kujdesin në shtëpi, duke u përshtatur me nivelin arsimor të pacientëve.

Rekomandohet që të fuqizohen programet e mbështetjes psikologjike për pacientët në trajtim

paliativ, veçanërisht për ata me rikthim të sëmundjes, përmes përfshirjes së psikologëve klinikë dhe infermierëve të specializuar në onko-psikologji.

Rekomandohet që të standardizohet dhe formalizohet informimi verbal para çdo procedure, duke përfshirë prezantimin e stafit, qëllimin e ndërhyrjes dhe efektet anësore, për të garantuar transparencë dhe ndërtim të besimit terapeutik.

Rekomandohet që të implementohet një protokoll edukimi higjieno-dietetik në praktikën infermirore, duke përfshirë edukatorë klinikë ose dietologë në trajtimin paliativ.

Rekomandohet që të organizohen trajnime të avancuara për personelin infermieror në fushën e komunikimit empatik dhe ndjeshmërisë klinike, për të adresuar më mirë temat e nëntrajtuara si seksualiteti dhe ndikimi emocional.

Rekomandohet që të integrohet në mënyrë sistematike një instrument i standardizuar për vlerësimin e kënaqësisë së pacientit, si PSNCQQ ose NSNS, në mënyrë që të mundësohet një matje objektive e cilësisë së kujdesit dhe të adresohen menjëherë mangësitë e perceptuara.



BULETINI SHKENCOR